



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Raport vjetor 2014

Raport vjetor 2014



Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave gjatë vitit 2014

Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave gjatë vitit 2014

PËRMBAJTJA

PERMBAJTJA.....	3
0.SHKURTESAT.....	5
1.PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	6
2. KORNIZA LIGJORE.....	12
2.1. Baza ekzistuese ligjore.....	12
2.2. Përmirësimi i bazës ligjore.....	12
2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet.....	13
3. PERSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	14
3.1. Misioni/Vizioni.....	15
3.2. Kompetencat e ARH-së sipas Ligjit.....	15
4. FUSHEVEPRIMI QE MBULON ARH.....	16
4.1. Struktura organizative e ARH-së.....	16
4.2. Bordi mbikëqyrës i ARH-së.....	18
4.2.1. Mandati.....	18
4.2.2. Kompetencat.....	18
4.2.3. Funksionalizimi.....	18
4.3. Ekzekutivi.....	19
4.3.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.....	19
4.3.2. Menaxhmenti i mesëm.....	19
4.3.3. Burimet njerëzore.....	19
4.3.3.1. Numri i punëtoreve dhe nevojat për punëtor të rinj.....	19
4.3.3.2. Trajnimet.....	20
4.4. Asetet.....	21
4.4.1. Lokacioni i ARH-së.....	21
5. AKTIVITETET PËR PERIUDDHËN RAPORTUESE.....	22
5.1. DEPARTAMENTI I LICENCIMI.....	22
5.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	22
5.1.2. Aktivitetet e Departamentit të Licencimit.....	22
5.1.2.1. Licencimi i Makinistëve.....	22
5.1.2.2. Regjistri i Licencave.....	23
5.1.2.3. Pranimi dhe Shqyrtimi i aplikacionit për Licencë.....	23
5.1.2.4 .Monitorimi i Licencave.....	24
5.2. DEPARTAMENTI I SIGURISË.....	25
5.2.1.Detyrat dhe përgjegjësitë.....	25
5.2.2.Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë.....	26
5.2.2.1.Autorizimet për futje në shërbim.....	27
5.2.2.2.Përgatitja e Rregullores së Sinjalizimit.....	29
5.2.2.3. Përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë 2013.....	29
5.2.2.3.1.Raporti vjetor i Sigurisë 2013.....	31
5.2.2.4. Inspektimet e mjeteve lëvizëse hekurudhore dhe raporti me rekomandime.....	69
5.2.2.5. Inspektimi i linjave hekurudhore dhe raporti me rekomandime.....	93
5.2.2.5.1. LINJA HEKURUDHORE DRENAS-PEJË.....	93
5.2.2.5.2. LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË - MAGURË.....	97
5.2.2.5.3. LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-DRENAS.....	102
5.2.2.5.4. LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË – MITROVICË.....	106
5.2.2.5.5. LINJA HEKURUDHORE KLINË-XËRXË-PRIZREN.....	111
5.2.2.5.6. LINJA HEKURUDHORE PRISHTINË-PODUJEVË.....	116
5.2.2.5.7. LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-HANI I ELEZIT.....	121
5.2.2.5.8. LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-PRISHTINË.....	129
5.2.2.5.9. TERMINALI DOGANORË NË MIRADL.....	133
5.3. DEPARTAMENTI PËR INTEROPERABILITETI.....	136

5.3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	136
5.3.2. Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit.....	137
5.3.2.1. Miratimi i Rregullores 01/2014 Modeli i Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të mjetit hekurudhore.....	137
5.3.2.2. Autorizimet për futje në shërbim për nënsistemet strukturale konform kërkesave për Interoperabilitet.....	138
5.3.2.3. Regjistrimi i mjeteve lëvizëse.....	138
5.3.2.4. Marrëveshjet kontraktuale.....	142
5.3.2.5. Plani i Implementimit për STI.....	143
5.3.2.6. Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet.....	144
5.3.2.7. Hartimi i draft-Rregullores Nënsistemet Hekurudhore dhe Kërkesat Esenciale.....	148
5.3.2.8. Inspektimi i Regjistrimit të mjeteve lëvizëse	149
5.3.2.9. Mjetet hekurudhore me pronësi të pa definuar.....	151
5.3.3. Bashkëpunimi Ndërinstitucional.....	152
5.3.4. Synimet për Interoperabilitetin Hekurudhorë.....	152
5.4. DEPARTAMENTI I RREGULLIMI TË TREGUT	153
5.4.1. Detyrat dhe Përgjegjësitë.....	153
5.4.2. Aktivitetet e Departamentit të Rregullimit Tregut.....	154
5.4.2.1. Shqyrtimi i ankesës nga TRAINKOS.....	154
5.4.2.2. Procesi i konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit 2015.....	155
5.4.2.3. Shqyrtimet e ARH-së në komentet e TRAINKOS-it lidhur me draft-Ekspozeun e Rrjetit 2015....	155
5.4.2.4. Shqyrtimet e ARH-së në komentet për Ministrinë e Infrastrukturës lidhur me “Ekspozeun e Rrjetit 2015.....	157
5.4.2.3. Përgatitja e raportit të Monitorimit të Tregut 2013.....	158
5.4.2.3.1. Raporti i Monitorimit të Tregut 2013.....	159
5.5. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	176
5.5.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	176
5.5.2. Aktivitetet e Departamentit të Administratës.....	176
5.6. DEPARTAMENTI I FINANCËS.....	178
5.6.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	178
5.6.2. Aktivitetet e Departamentit të Financave.....	179
5.6.2.1. Ndarjet buxhetore në Total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasset.....	179
5.6.2.2. Detajet e Shpenzimeve nga Pagat, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunalet dhe Shpenzime Kapitale për vitin 2014 (Janar- Dhjetor 2014).....	183
5.7. ZYRA E PROKURIMIT.....	186
5.7.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	186
5.7.2. Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit.....	187
5.7.3. Kërkesat për Qasje në Dokumente Publike.....	189
5.8. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2015.....	190
5.9. PUNA GJATË VITIT PARAPRAK.....	192
5.10. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE AKTIVITETE E ARH-SË NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR.....	194
6. REKOMANDIMET NGA ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	201
7. SHTOJCAT.....	202
7.1. SHTOJCË A.....	202
7.1.1. Përshkrimi mbi Hekurudhat e Kosovës.....	202
7.1.2. Harta e Hekurudhave të Kosovës.....	203
7.2. SHTOJCË B.....	204
7.2.1. Direktivat e BE për Sektorin Hekurudhor.....	204

SHKURTESAT

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
INFRAKOS	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
TRAINKOS	Operimi me Trena të Hekurudhave të Kosovës
SH.A	Shoqëria Aksionare
IRG-RAIL	Indenpedent Regulatorys Group-Rail
BE	Bashkimi Evropian
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
OB	Organizatrat Buxhetore
SEETO	South-East Europe Transport Observatory (Observatori i Transportit të Evropës Juglindore)
ERA	European Railway Agency (Agjensioni Evropian i Hekurudhave)
OTIF	Organisation intergouvernementale pour les Transports Internationaux Ferroviaires (Organizimi Qeveritar për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore)
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
SMS	Safety Managment Sistem (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
UIC	International Union of Railway (Unioni Nderkombëtar i Hekurudhave)
ECM	Entity in Charge of Maintenance (Entiteti Përgjegjës për Mirembajtje)
CSM	Common Safety Method (Metodat e Përbashkëta të Sigurisë)
EC	European Comision (Komisioni Evropian)
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange instrument (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)
TCDD	Türkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryolları (Hekurudhat Shtetërore të Turqisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet Türkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryolları
CSI	Common Safety Indicator (Indikatorët e Përbashkëta të Sigurisë)
NSA NETWORK	Nacional Safety Authority Network

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Kam kënaqësinë e veçantë që përmes këtij raporti të ju prezantoj aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), të realizuara gjatë vitit 2014. Me këtë rast mund të konstatoj se gjatë vitit 2014 ARH në mënyrë të suksesshme ka përballuar sfidat që ka pasur para veti dhe rrjedhimisht i ka përmbushur me sukses synimet e përcaktuara.

ARH është institucion i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës, i cili vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH ofron shërbime cilësore të

sigurta, transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të ligjit të Hekurudhave Nr. 04/L-063 të Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të BE-së si dhe në pajtim me direktivat BE-së.

ARH ka përmbyllur vitin e pestë të aktivitetit duke iu përgjigjur me profesionalizëm dhe ritëm të lartë pune për përparimin e sektorit të transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës. Në këtë rrafsh, viti 2014 shënon një hap para në drejtim të fuqizimit të ARH dhe sektorit të transportit hekurudhor në përgjegjësi në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2014, ARH ka vazhduar të përforcojë funksionet e veta rregullative në katër fusha kryesore:

Licencimi këtë vit ka filluar me përgatitjen e procedurave për lëshimin e licencave për makinistët e ndërmarrjes hekurudhore të cilat janë të domosdoshme për operimet në shërbimet hekurudhore konform dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës dhe atë të BE-së. Po ashtu është rishikuar validiteti i licencave dhe është azhurnuar regjistri i ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës të licencuara në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2014 ARH ka monitoruar licencat e lëshuara që policat vjetore të sigurimit për palët e treta të ripërtërihen, duke u siguruar kështu se ndërmarrja hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës i plotësojnë obligimet e përcaktuara me ligjin e hekurudhave.

Siguria me qëllim të ngritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve në transportin hekurudhor vazhdon të jetë prioritet për të gjithë ne. Performanca është në përmirësim, siç tregohet në raportin e sigurisë që ne e publikojmë së bashku me këtë raport. Por ne nuk mund të

jemi të kënaqur edhe pse ndërmarrja hekurudhore dhe menaxheri infrastrukturës janë përgjegjës për të ofruar sigurinë e vazhdueshme. Gjatë vitit 2014 janë lëshuar autorizimet për futjen në shërbim për mjetet lëvizëse, autorizimi për futjen në shërbim të pajisjes për mirëmbajtjen e binareve si dhe nënsistemeve strukturale. Janë monitoruar Certifikatat dhe

Autorizimet e Sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës. Gjatë kësaj periudhe kohore janë inspektuar linjat hekurudhore të cilat janë në shfrytëzim si dhe ato që nuk janë në shfrytëzim, inspektimet e të gjitha mjeteve lëvizëse të cilat janë të regjistruara në regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse e që janë në pronësi të TRAINKOS-it. Përgatitja e raportit me rekomandime të sigurisë për linjat e inspektuara dhe për mjetet lëvizëse të inspektuara.

Interoperabiliteti ka siguruar që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës përputhet dhe do të përputhet në të ardhmen me kërkesat për interoperabilitet siç janë definuar nga direktivat dhe rregulloret e BE-së, e në veçanti me rregulloren e Agjencionit Evropian Hekurudhor, që nxit harmonizimin teknik dhe standardizimin e hekurudhave të Evropës.

Është përgatitur plani i implementimit të Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet (STI). ARH gjatë vitit 2014 ka realizuar regjistrimet dhe ri-regjistrimet e mjeteve lëvizëse nga Menaxheri i Infrastrukturës dhe Ndërmarrja Hekurudhore. Gjithashtu është realizuar inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë të regjistruara që nga 2012 deri në 01 dhjetor të 2014. Gjatë këtij viti ARH ka identifikuar mjetet lëvizëse hekurudhore me pronësi të pa definuar të cilat gjinden në territorin e Republikës së Kosovës. Nga TRAINKOS dhe INFRAKOS kemi mbledhur informacion në lidhje me pronësinë, përgjegjësinë, administrimin dhe gjendjen numerike të mjeteve me pronësi të padefinuar, prandaj në lidhje me këtë kemi informuar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Infrastrukturës, INFRAKOS-in dhe TRAINKOS-in. Ne kemi kërkuar që të formohet një grup punues dhe të qartësohen përgjegjësitë për këto mjete dhe pastaj të fillohet me regjistrimin e këtyre mjeteve. ARH gjatë vitit 2015 do të filloi me regjistrimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore me pronësi të pa definuar.

Rregullimi i Tregut ka ndihmuar dhe siguruar që kompanitë të plotësojnë nevojat e transportit të udhëtarëve dhe mallrave dhe për kryerjen e shërbimeve të sigurta, efikase, transparente dhe jo diskriminuese për zhvillimin e sektorit hekurudhor. Puna e rregullimit të tregut ka demonstruar gatishmërinë që të marrin masa kur është e nevojshme për të arritur këtë. Është analizuar dhe monitoruar konkurrenca dhe kualiteti i shërbimeve në tregun hekurudhorë.

Është siguruar që Ekspozeu i Rrjetit të mos përmbaj klauzola diskriminuese apo që krijon kompetenca diskriminuese për menaxherin e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për ta diskriminuar ndërmarrjen hekurudhore.

Mbikëqyrja e negocimeve ndërmjet ndërmarrjes hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Rregullimi Tregut ka bashkëpunuar me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-s dhe IRG -Rail në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor me vendet e ndryshme.

Aktivitetet e ARH gjatë vitit 2014 u përqendruan kryesisht në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike të përcaktuara. Për rregullimin e tregut në nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në nivel të ofrimit të shërbimeve si një nga parakushtet thelbësore për investime në sektorin hekurudhor, sigurimin e cilësisë së duhur të shërbimeve më konkurruese dhe të volitshme për përdoruesit, si dhe për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes të të drejtave të shfrytëzuesve të konsumatorit dhe të sigurisë në sektorin e transportit hekurudhor.

Raporti ofron dhe siguron informacione përmbajtëse mbi statusin dhe progresin e angazhimeve të Autoritetit në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike si të tilla të përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave dhe me aktet nënligjore përkatëse.

Raporti gjithashtu përmbledh dhe paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e sektorit hekurudhor.

- angazhimin e lartë dhe punën voluminoze dhe profesionale të Autoritetit në mbikëqyrjen e zbatimit të masave rregullative ndaj ndërmarrjes hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës.
- angazhimin e menaxhmentit dhe zyrtarëve profesional të Autoritetit në thjeshtësimin e procedurave dhe shkurtimin e afateve për shqyrtimin e aplikacioneve dhe rasteve të paraqitura për shqyrtim nga Autoriteti.

Ky raport është një dokument i cili paraqet gjendjen aktuale dhe perspektivën e zhvillimit të transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës, duke përfshirë analizën e detajuar të dukurive më të rëndësishme në sektorin hekurudhor.

Vlerësimi përbëhet prej informatave dhe të dhënave duke sjellë më afër problemin e funksionimit të sektorit hekurudhor, duke përfshirë ndër të tjera informacionet dhe të dhënat të cilat bëjnë të mundur marrjen e veprimeve qëllimi i të cilave është për të eliminuar rënien e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Ky dokument paraqet një shqyrtim të hollësishëm të çështjeve më të rëndësishme në lidhje me sektorin e transportit hekurudhor dhe qasjes në infrastrukturë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë në veçanti:

- Ndërmarrjen Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës
- Sigurinë në hekurudha
- Tregun hekurudhor
- Struktura e mjeteve lëvizëse të ndërmarrjes hekurudhore
- Licencimin e transportit hekurudhor.

Ky vlerësim është përpunuar duke u bazuar në rezultatet e analizave dhe hulumtimeve të bëra në bazë të të dhënave dhe informacionit nga ARH që u mbledhën në kuadër të monitorimit të sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Faktor i rëndësishëm do të jetë gjithashtu rritja e ritmit të investimeve infrastrukturore me përdorimin e shpejtë dhe efektiv të fondeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian.

Në planin institucional ARH në vitin 2014 e ka avancuar më tutje çështjen e pavarësisë së vet operative dhe në këtë plan ARH ka vazhduar me plotësimin e legjislacionit sekondar si dhe kompletimin e politikave dhe procedurave të brendshme administrative, po ashtu ka qartësuar kompetencat për nxjerrjen e akteve nënligjore në mes ARH dhe MI.

ARH, si institucion i pavarur punën vjetore të tij e ka zhvilluar duke u mbështetur në kompetencat ligjore, duke ofruar asistencë dhe shërbime profesionale si rregullator për transportin hekurudhor në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministrin e Infrastrukturës, Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Ministrin e Integritimit Evropian, Menaxherin e Infrastrukturës (INFRAKOS), Operatorin me trena (TRAINKOS), Komisionin Evropian, IRG-Rail dhe akteret e tjerë vendor dhe ndërkombëtar.

ARH ka vazhduar bashkëpunimin me autoritetet hekurudhore homologe në rajon dhe më gjerë si me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Kroacinë, Slloveninë, Turqinë, si dhe shkëmbim të përvojave të stafit me autoritet e këtyre shteteve si dhe shteteve anëtare të IRG – Rail. Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet homologe, ARH ka nënshkruar edhe Memorandume Bashkëpunimi.

ARH gjatë vitit 2014 ka përfituar tri projekte nga programet e asistencës teknike të përkrahura nga Komisioni Evropian përmes instrumentit TAIEK. Projekti i parë në kohëzgjatje prej 10 ditë pune me gjithsej dy ekspert të ardhur nga rregullatorët e shteteve të Bashkimit Evropian, qëllimi i misionit të eksperteve ka qenë përgatitja e legjislacionit sekondar dhe ngritja e kapaciteteve për stafin e ARH-së. Prandaj një përvojë të tillë e vlerësojmë si një aktivitet të dobishëm për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave në të cilin u dha mundësia që nga afër me leksionet e përgatitura nga ekspertet dhe përfaqësuesit e tjerë të diskutoheshin problemet që hasen gjatë rrugëtimit të implementimit të legjislacionit në sektorin e hekurudhave.

Projekti i dytë në kohëzgjatje prej pesë ditë pune po ashtu me dy ekspert ndërkombëtar misioni i të cilëve ka qenë implikimet teknike dhe ligjore të Direktivave të BE-së në sektorin hekurudhor. Pjesëmarrës kanë qenë zyrtarë nga ARH-ja, MI, TRAINKOS dhe INFRAKOS, kjo ka qenë një eksperiencë e mirë për të gjithë pjesëmarrësit dhe një metodë tjetër e qasjes ndaj problemeve në sektorin hekurudhor, në fushën e Sigurisë, Interoperabilitetit, Licencimit dhe Rregulimit të Tregut.

Projekti i tretë në kohëzgjatje prej dy ditë pune me katër ekspert ndërkombëtarë, (një nga rregullatori i Finlandës, një nga rregullatori i Lituanisë dhe dy nga Agjencia Evropiane e

Hekurudhave - ERA). Punëtorja lidhur me Rregullat Nacionale të Sigurisë ku pjesëmarrës kanë qenë: ARH, Komisioni Evropian, ERA, Drejtoria e Inspektoratit Hekurudhor dhe Ministria e Transportit - Shqipëri, Ministria e Transportit dhe Komunikimit - Maqedonisë, Drejtoria e Hekurudhave dhe Ministria e Transportit e Malit të Zi, Drejtoria e Hekurudhave të Serbisë, Drejtoria e Hekurudhave të Bosnje dhe Hercegovinës, Ministria e Infrastrukturës së Kosovës, INFRAKOS dhe TRAINKOS. Kjo punëtorja me karakter rajonal u mbajt nën organizimin e ARH-së dhe Komisionit Evropian në Prishtinë.

Nga pjesëmarrësit në këtë punëtorja ishte një vlerësim i përgjithshëm se ideja e organizimit të kësaj punëtore ishte shumë e qëlluar pasi që të gjitha shtetet e rajonit janë në proces të përgatitjes së Rregullave Nacionale të Sigurisë dhe problemet me të cilat ballafaqohen janë afërsisht të njëjta. Përfaqësuesit nga ERA kërkuan nga secili shtet të dërgojë në ERA rregulloret të cilat janë duke u përdorur në mënyrë që ato mandej të mund të harmonizohen në takimet e ardhshme punuese ndërmjet shteteve të IPA-së.

ARH, si një nga aktet e rëndësishme të sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës është tejet e interesuar dhe aktive të sigurojë mbështetje maksimale në zhvillimet e reja dhe sfidat në sektorin e transportit hekurudhor dhe jo më pak rëndësi është edhe vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve të stafit në fusha të ndryshme të mbështetur nga Komisioni Evropian.

Unë do të doja të përfitoj nga rasti për të falënderuar pjesëmarrësit e tregut hekurudhor për bashkëpunimin e tyre me ARH-në, për zhvillimin e Hekurudhës Kosovare në rritjen e konkurrueshmërisë, si dhe përmirësimin e sigurisë në transportin hekurudhor.

Ky raport përshkruan situatën e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në krahasim me periudhat e mëparshme.

Unë shpresoj se raporti i vitit 2014 që ne po paraqesim, pasqyron një dokument të vlefshëm për vendimet mbështetëse të cilat do të shërbejnë në zhvillimin e gjithë sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

ARH edhe në vitin 2015 do të vazhdon të angazhohet me intensitet të shtuar në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe në ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për sigurinë hekurudhore përmes aktiviteteve që do të ndërmarrë ARH. Po ashtu gjatë vitit 2015 do të fillojmë procedurat për ngritjen e Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë sipas standardit ISO 9001:2008, me ç'rast do të lehtësohen dhe përmirësohen procedurat e përgjithshme të menaxhimit dhe kontrollit.

Unë jam thellësisht i bindur se në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta, për vitin e ardhshëm do të kemi rezultate më të mira në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës. ARH do të vazhdojë të jetë një rregullator aktiv në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend, duke siguruar vazhdimësinë e angazhimeve.

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë stafin e ARH-së për përpjekjet dhe zotimin e tyre të palëkundur për kryerjen me sukses të përgjegjësi dhe obligimeve të tyre. Falënderoj Kuvendin e Republikës së Kosovës për rolin e tij mbështetës. Po ashtu falënderoj Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, për mbështetjen e madhe përmes projekteve të realizuara

me asistencë teknike. Njëkohësisht, unë do të doja të falënderoj të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë në përmbushjen e shumë prej objektivave të përbashkëta në dobi të sektorit të transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Me respekt,
Mr. sc. Enis Berisha
Drejtore i Përgjithshëm

2. KORNIZA LIGJORE

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave dhe fushëveprimin e tij është:

- Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore
- Rregulloren Nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë
- Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë
- Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore, dhe
- Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës.
- Rregulloren Nr. 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit
- Rregulloren Nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve.
- Rregullore Nr. 01/2014 për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor.

2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Gjatë vitit 2014 ARH ka nxjerre Rregulloren Nr. 01/2014 për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor,,si dhe ka draftuar këto Rregullore:

- Draft- Rregullorja për Nën sistemet dhe Kërkesat Esenciale
- Draft- Rregullorja për Sinjalizim
- Draft- Rregullorja për Metodatat e Përbashkëta të Sigurisë

Draft-Regulloret e mësipërme në mungese të bordit të ARH nuk janë miratuar gjatë vitit 2014.

2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 ka ekzistuar një mospajtim mes ARH-së dhe Ministrisë së Infrastrukturës rreth të drejtës dhe obligimit për nxjerrjen e akteve nënligjore, të kërkuara nga ligji i hekurudhave. Palët janë thirrur në ligjin e njëjtë por në dispozita të veçanta të atij ligji, përkatësisht Autoriteti është thirrur në nenin 38 pika 2, ndërsa Ministria neni 8 pika 2 e ligjit. Dy institucione kanë pasur disa takime të përbashkëta në mënyrë që të gjejnë një rrugëdalje rreth kësaj çështje, gjithherë duke u bazuar në ligj. Mirëpo, fatkeqësisht nuk ka mundur të arrihet dhe të gjendet një zgjidhje ligjore e pranueshme për të dyja palët. Si rezultat, çështja në vitin 2014 është adresuar në Zyrën Ligjore të Kryeministrit për interpretim. Në këtë drejtim, me datë 19.09.2014 Zyra Ligjore e Kryeministrit ka ftuar në takim ARH-ë dhe Ministrinë për të dëgjuar qëndrimet e palëve lidhur me këtë çështje. Në përfundim të këtij takim është marrë obligim nga ana e ZLK që të bëjë interpretim lidhur me kompetencën për nxjerrjen e akteve nënligjore. Mirëpo, Zyra Ligjore e Kryeministrit nuk ka mundur të dal me një interpretim konkret për arsye të dy neneve kundërtëse të lartcekura. Dhe si rezultat ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që të formoj një grup punues lidhur me këtë çështje.

Ministria e Infrastrukturës me Vendim Nr. 4367 të datës 30/09/2014, sipas rekomandimit të Zyrës Ligjore të Kryeministrit për përcaktimin e nxjerrjes së akteve nënligjore për implementimin e Ligjit të Hekurudhave nxjerr vendim për themelimin e grupit punues për këtë çështje. Grupi punues përbëhej nga përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës, Zyrës Ligjore të Kryeministrit, Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Grupi punues ka mbajtur takime të përbashkëta me datë 03/10/2014 dhe 27.10.2014 dhe pas këtyre takimeve dhe diskutimeve ka nxjerrë këto rekomandime:

1. Ministria e Infrastrukturës në përputhje me nenin 8.2 Ligjit Nr.04/2014 për Hekurudhat e Kosovës të nxjerrë të gjitha aktet nënligjore për implementimin e politikave të përcaktuara për sektorin hekurudhor
2. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave në përputhje me neni 38 paragrafi 2 dhe neni 39 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës të nxjerr të gjitha aktet nënligjore për fushat të cilat i mbulon, siç janë: Licencimi, Siguria, Rregullimi i Tregut dhe Interaporabiliteti .

3. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave gjatë hartimit të draftit të parë të aktit normativ të bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës, para dërgimit në konsultime paraprake dhe publike të aktit normativ në përputhje me legjislacionin në fuqi
4. Aktet nënligjore në fuqi të nxjerra deri më tani nga Ministria e Infrastrukturës dhe Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave për implementimin e Ligjit Nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës do të mbesin në fuqi.

ARH propozon amandamentimin e Ligjit të Hekurudhave Nr. 04/L-063 në së paku këto pika: nxjerrja e akteve nënligjore dhe miratimi i tarifave për infrastrukturën hekurudhore të kalojnë në kompetencë të ARH. Në këtë mënyrë Autoriteti do të kishte pavarësinë e plotë në ushtrimin dhe përmbushjen e kompetencave të veta ligjore si dhe Ligji i Hekurudhave do të përafrohej me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa tani ARH funksionon sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës. ARH -ja është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky Ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

3.1. Misioni/Vizioni

	VIZIONI Vizioni i ARH-së është që të ofroj shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.
	MISIONI Misioni i ARH-së është rregullimi, mbikëqyrja dhe organizimi i sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit

Sipas Ligjit për Hekurudha, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyrë këto fusha:

- ❖ Licencimin
- ❖ Sigurinë
- ❖ Interoperabilitetin dhe
- ❖ Rregullimin e Tregut

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON ARH


4.1.Struktura organizative e ARH-së

Më 12 nëntor 2013 ARH ka nxjerr Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës.

Struktura organizative e ARH-së përbëhet nga:

- a) Bordi Mbikëqyrës
- b) Drejtori i Përgjithshëm
- c) Departamenti i Ligjor/Licencim
- d) Departamenti i Sigurisë
- e) Departamenti i Interoperabilitetit
- f) Departamenti i Rregullimit Tregut
- g) Departamenti i Administratës
- h) Departamenti i Financave
- i) Zyra e Prokurimit

Në vazhdim është paraqitur skema organizative e ARH-së, në përputhje me Rregulloren e brendshme.

SKEMA ORGANIZATIVE E ARH-SË

4.2. Bordi mbikëqyrës i ARH-së

Veprimtaria e ARH-së mbikëqyret nga Bordi mbikëqyrës i cili është Bord jo ekzekutiv. Bordi ARH-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe njëri prej tyre zgjidhet kryesues, anëtari i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Bordi vepron me orar jo të plotë, takimet e Bordit do të drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në çdo muaj. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk janë të pranishëm tre (3) prej anëtarëve të tij, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm që duhet të jetë gjithmonë i pranishëm në mbledhjet e Bordit.

Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.

Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së i dorëzon Bordit mbikëqyrës raportin gjithëpërfshirës të punës çdo muaj dhe raportin vjetor në fund të çdo viti kalendarik.

4.2.1. Mandati

Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet kryesuesi i Bordit të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë. Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohen më se shumti edhe për një (1) mandat. Me 31.03.2014 Bordit Mbikëqyrës ju ka skaduar mandati, prandaj prej 01/04/2014 ARH-ja është pa Bord mbikëqyrës.

4.2.2. Kompetencat

Bordi mbikëqyrës nuk ka kompetenca ekzekutive, por është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e aktiviteteve dhe vendimeve të ARH-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore dhe të licencimit dhe aspekteve të menaxhimit financiar, të hyrave dhe shpenzimeve të ARH-së.

4.2.3. Funksionalizimi

Gjatë vitit 2014, Bordi Mbikëqyrës ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar dhe miratuar raportin vjetor të ARH-së për vitin 2013. Për shkak të skadimit të mandatit, Bordi mbikëqyrës i ARH-së nuk është funksional që nga muaji prill i vitit 2014.

4.3. Ekzekutivi

ARH, ka Drejtorin e përgjithshëm i cili është Kryeshef Ekzekutiv i Autoritetit dhe si organi më i lartë i drejtimit ekzekutiv dhe administrativ. Ai ushtron detyrat dhe funksionet të përcaktuara nga Ligji i Hekurudhave dhe në përputhje me ligjet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike, përfshirë këtu menaxhimin dhe raportimin e rregullt financiar të Bordi Mbikëqyrës dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me përputhshmërinë e ARH-së me politikat e autoritetit si dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

4.3.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së

Drejtori i Përgjithshëm është zyrtar i ARH-së cili është përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e punëve të përditshme dhe vendimmarrjen e ARH-së, në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga ARH.

Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga Bordi Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord nuk do të ketë të drejtë të emërohet as Drejtor i Përgjithshëm.

4.3.2. Menaxhmenti i mesëm

Menaxhmenti i mesëm i ARH-së, përbëhet nga Kryesuesit e Departamenteve dhe menaxherët e zyrave, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre të përshkruara në përshkrimet e punës. Drejtori i Përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara sipas rregullores së brendshme, Drejtori i Përgjithshëm mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e ARH-së një strukture apo punonjësi jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture, nëse ai e sheh të nevojshme. Zyrtaret që përbëjnë strukturën të ARH-së mbajnë Akte Emërimi me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

4.3.3. Burimet njerëzore

4.3.3.1. Numri i punëtorëve dhe nevojat për punëtorë të rinj

ARH-ja ka 17 punëtorë shërbyes civil të gjithë me Akte Emërimi të karrierës. Për shkak të mungesës të pozitës si zyrtar i teknologjisë informative, po mbulohet përkohësisht nga Drejtori i Përgjithshëm. ARH nuk ka nevojë për punëtorë të rinj.

4.3.3.2. Trajnimet

Zyrtaret e ARH –së gjatë vitit 2014 kanë ndjekur trajnime të financuara nga donatorët si dhe trajnime të financuara nga buxheti i ARH-së. ARH-ja investon në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të personelit të vet, në përputhje me standardet dhe praktikat e rekomanduara ndërkombëtare. Zyrtarët janë trajnuar kryesisht në qendrën trajnuese të Autoriteteve të Përbashkëta të Hekurudhave si dhe në trajnimet që janë ofruar edhe në kuadër të projekteve të Komisionit Evropian përmes instrumentit TAIEK.

KONFERENCAT, TRAJNIMET, PUNËTORITË DHE VIZITAT STUDIMORE	
1	IRG –Rail, Grupi Punues për Zhvillime Legjislative
2	Eurasia Rail 2014 Stamboll,Turqi
3	InnoTrans Berlin
4	Trajnimi RAMS LCC for Railway Infrastructure (MERTCe) Istanbul – Turkey
5	Takim bilateral në mes ARH-së dhe Rregullatoreve të Sigurisë dhe Rregulimit tregut të Sllovenisë dhe Kroacisë
6	Takim ndërmjet ARH-së dhe Drejtorisë të Inspektimit Hekurudhor Republika e Shqipërisë
7	Trajnim për Inspektim të sigurisë në Drejtorinë e Inspektoratit të hekurudhave të Shqipërisë
8	Trajnimi për Auditim të Brendshëm
9	Trajnimi Misioni i Eksperteve për përgatitjen e legjislacionit sekondar dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin hekurudhore, Prishtinë
10	Trajnimi Misioni i Ekspertëve mbi rolin e Organeve Rregullatore, Prishtinë
11	SEETO Working Group Railway and Intermodality (Regulatory and competition aspects, Skopje, Maqedonia)
12	SEETO Working Group Railway and Intermodality (Regulatory and competition aspects, Podgorica, Montenegro)
13	SEETO Working Group Railway and Intermodality (Regulatory and competition aspects, Belgrade, Serbia)
14	IRG –Rail, Takime Plenare, Luxembourg
15	Punëtorja rajonale lidhur Rregullat Nacionale të Sigurisë ,Prishtinë
16	Trajnimi hartimi i legjislacionit primar e sekondar në institucione publike dhe harmonizimi i tyre me acquis communautaire, Shqipëri KMI
17	Trajnim kontratat publike, zbatueshmëria dhe monitorimi i zbatimit të tyre sipas standarteve ndërkombetare dhe legjislacionit të prokurimit publik, Stamboll, KMI

4.4. Asetet

ARH-ja ka ne përdorim 286 asete me vlere në blerje prej 106.572.95 €. Këto asete janë kryesisht orendi zyrash dhe pajisje teknologjike. Zhvlerësimi dhe vlerësimi i aseteve behet çdo fund vit sipas dispozitave të Rregullores MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe sipas Udhëzimit Nr. 01/2012 për Menaxhimin e Pasurisë së ARH-se. Sipas raportit të komisionit te inventarizimit dhe vlerësimit vlera e aseteve në ARH për vitin 2014 sipas rregullave të parapara me rregulloren e lartcekur më larte është 81.155.74 €. Zhvlerësimi i aseteve në ARH është kryer vetëm për asetet mbi 1000 € kurse për asetet me vlere nën 1000 € nuk është kryer për shkak të mosfunksionimit të zhvlerësimit në mënyre automatike nga E-Pasuria. ARH-ja për vitin 2015 nuk ka planifikuar shpenzime për asete të reja.

4.4.1. Lokacioni i ARH

Zyra e ARH-së është në Prishtinë në Rr. "Rrustem Statovci". nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 250 m². ARH-ja në vazhdimësi bënë kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike për t'iu siguruar një objekt qeveritar, meqë objekti i tanishëm është pronë private dhe paguhet me qira nga ARH-ja.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

5.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 Departamenti i Licencimit është përgjegjës për:

- ✚ Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- ✚ Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- ✚ Licencimin e Makinistëve, dhe
- ✚ Amandamentimin, Suspendimin dhe Revokimin e Licencave të lëshuara.

5.1.2. Aktivitetet e Departamentit të Licencimit

5.1.2.1. Licencimi i Makinistëve

Gjatë vitit 2014 Departamenti i Licencimit pranë Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, duke u bazuar në Ligjin e Hekurudhave dhe planin vjetor të punës, ka pas disa prioritete. Këto prioritete kanë qenë: përgatitja e kornizës rregullative përcjellëse në pajtim me Ligjin e Hekurudhave, Direktivën e BE-së 2007/59 si dhe Rregulloren e BE-së 2010/36 për Licencimin e Makinistëve, monitorimin e Licencave të lëshuara për INFRAKOS-in dhe TRAINKOS-in.

Për t'i përmbushur këto objektiva dhe jo vetëm, ka punuar një agjendë konkrete për realizimin tyre gjatë vitit 2014. Si rezultat, gjatë vitit 2014 janë ndërmarrë të gjitha

hapat e nevojshme nga Departamenti i Licencimit që konform dispozitave ligjore në fuqi për këtë proces të bëhen të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe të domosdoshme. Pas hartimit të Rregullores për Licencimin e Makinistëve në harmoni të plotë me Direktivën e BE-së 2007/59 dhe Rregulloren e BE-së 2010/36, në mënyrë që kjo Rregullore së bashku me Ligjin e Hekurudhave të gjejnë zbatim, janë përfunduar edhe obligimet tjera për realizimin e këtij obligimi ligjor, siç janë: përgatitja e formës së licencës për makinistë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi në Kosovë dhe BE, publikimi i dokumenteve të nevojshme dhe procedurave të aplikimit në ueb faqen e ARH-së dhe bashkëpunimi me palët e interesit TRAINKOS dhe INFRAKOS në këtë proces.

5.1.2.2. Regjistri i Licencave

Departamenti i Licencimit ka vazhduar punën dhe hapat konkret në zbatimin e kësaj kornize rregullative ligjore, në mënyrë që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës të jetë i rregulluar konform dispozitave ligjore në fuqi në Kosovë dhe atë të BE-së, kur janë të përshtatshme për këtë sektor.

Ligji për Hekurudhat e Kosovës, neni 10.3, 23.4 dhe 92.23 e obligon Departamentin e Licencimit që të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e Ndërmarrjeve Hekurudhore dhe Menaxherëve të Infrastrukturës të licencuar në Republikën e Kosovës dhe që ky regjistër të jetë i publikuar në ueb faqen e ARH-së. Departamenti i Licencimit ka krijuar dhe azhurnuar regjistrin e Ndërmarrjeve Hekurudhore dhe Menaxherëve të Infrastrukturës të licencuara. Në këtë mënyrë është respektuar Ligji për Hekurudhat e Kosovës dhe gjithashtu çdo person fizik apo juridik i cili ka nevojë dhe interes të ketë informacione për sektorin hekurudhore në Kosovë, një gjë të tillë mund ta bëjë në mënyrë shumë të lehtë dhe praktike në ueb faqe të ARH-së. Po ashtu është bërë kujdes i shtuar gjatë krijimit të regjistrit në fjalë. Fillimisht ky regjistër nuk përmban të dhëna konfidenciale të subjekteve të licencuara, të cilat mund të keqpërdoren nga rivalët biznesor dhe është konform standardeve ndërkombëtare të përdorura për llojin e këtyre regjistrave.

5.1.2.3. Pranimi dhe shqyrtimi i aplikacionit për Licencë

Gjatë vitit 2014 ARH ka shqyrtuar aplikacionin për licencë për transport hekurudhor të mallrave nga kompania RAILTRANS dhe pas shqyrtimit të aplikacionit është marrë vendim për licencim me datë 10/03/2014. Mirëpo, ARH pas lëshimit të licencës ka pranuar ankesë nga TRAINKOS me datë 19/03/2014 me pretendime se kjo kompani nuk i plotëson kushtet e licencimit.

Ne si ARH bazuar në Rregulloren e Licencimit 01/2012 neni 30, kemi hulumtuar këto shqetësime dhe ankesa dhe kemi kërkuar prova materiale nga ana e TRAINKOS-it lidhur me pretendimet e tyre. ARH me datë 20.03.2014 ka pranuar nga TRAINKOS disa fakte në formë të shkruar rreth këtyre pretendimeve të cilat i janë drejtuar Bordit Mbikëqyrës të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, si organi më i lartë brenda institucionit. Bordi i ARH-së në mbledhje e mbajtur me datë 20/03/2014 nxjerr konkluzione se në bazë të fakteve dhe dokumentacionit që posedon kompania RAILTRANS dhe që ka ofruar dokumentacionin në aplikacion për Licencë, ka fshehur faktet që kanë të bëjnë me reputacion jo të mirë dhe kompetencën profesionale dhe si rezultat rekomandon nxjerrjen e një vendimi të ri. ARH pas shqyrtimit të fakteve të reja të cilat janë paraqitur pas dhënies së licencës dhe bazuar në konstatimet e Bordit Mbikëqyrës, me datë 31/03/2014 merr vendim për revokim të licencës.

ARH mbetet fuqishëm e përkushtuar që të bëhet hapja dhe liberalizimi i tregut hekurudhor në Republikën e Kosovës, qoftë me operator vendor apo ndërkombëtar, të cilët i plotësojnë kushtet e parapara për licencim, konform Ligjit për Hekurudhat e Kosovës dhe legjislacionit sekondar në këtë fushë.

5.1.2.4. Monitorimi i Licencave

Departamenti i Licencimit ka për detyrë që të rishikoj validitetin e licencave të lëshuara në baza të rregullta së paku në çdo pesë (5) vite, duke u siguruar kështu se Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës të licencuara i plotësojnë obligimet e përcaktuara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

Gjatë vitit 2014 kemi monitoruar licencat e lëshuara në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi. Kryesisht monitorimi i licencave për vitin 2014 ngjashëm sikurse vitet paraprake është fokusuar në sigurimin adekuat ndaj palëve të treta të subjekteve të licencuara. Në këtë mënyrë ne kemi kërkuar nga TRAINKOS dhe INFRAKOS që policat e tyre të siguri të ripërtërihen, sepse ato janë me afat një (1) vjeçarë. Kjo kërkesë e jona dhe njëkohësisht obligim ligjor është përmbushur nga ana e INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it. Ne këtë mënyrë Departamenti i Licencimit është i përkushtuar që Ligji për Hekurudhat e Kosovës të zbatohet me përpikëri dhe në rast të ndonjë aksidenti, ndërmarrja hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës të jenë të mbuluara me polisë siguri adekuate.

5.2. DEPARTAMENTI I SIGURISË

Raporti i punës i paraqitur më poshtë është raporti i tretë me radhë i punuar, i cili paraqet të arriturat kryesore të Departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2014.



Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 neni 20, Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore, respektivisht Departamenti i Sigurisë në kuadër të ARH-së, përpilon një raport vjetor në lidhje me sigurinë, ku përshkruhen të arriturat kryesore gjatë vitit paraprak.

5.2.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Sipas Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-06, Departamenti i Sigurisë është përgjegjës për:



- Autorizimin për futjen në shërbim të nën sistemeve strukturale,
- Mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për Interoperabilitet,
- Autorizimin e futjes në shërbim të mjeteve të reja lëvizëse,
- Lëshimin, përtëritjen, amendamentimin dhe revokimin e Certifikatave/ Autorizimeve të Sigurisë,
- Monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me Ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut,
- Mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar,
- Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore,
- Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës

5.2.2. Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë

Gjatë vitit 2014 të arriturat kryesore të Departamentit të Sigurisë kanë qenë:

- ❖ Përfundimin e procesit të vlerësimit të aplikimit për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim të mjetit për mirëmbajtjen e binarëve Plasser&Theurer tipi 08-16-SH, në pronësi të Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore INFRAKOS,
- ❖ Përfundimin e procesit të vlerësimit të aplikimit për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për 9 vagonë për transportin e udhëtarëve në pronësi të Ndërmarrjes Hekurudhore TRAINKOS,
- ❖ Përgatitjen e draft Rregullores së Sinjalizimit,
- ❖ Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë për vitin 2013 të Departamentit të Sigurisë, pas pranimit të raportit vjetor të sigurisë nga INFRAKOS dhe TRAINKOS,
- ❖ Pjesëmarrja në takime plenare të organizuara nga IRG-Rail Group për sektorin e hekurudhave,
- ❖ Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar në Inspektoratin Hekurudhor të Shqipërisë prej datë: (09-13).06.2014,
- ❖ Pjesëmarrja në takimet bilaterale ndërmjet ARH-së dhe agjensioneve hekurudhore në Slloveni, Kroaci dhe Shqipëri.
- ❖ Pjesëmarrja në trajnimin (14-16).10.2014, për RAMS&LCC për Infrastrukturën hekurudhore, organizuar nga UIC, MERTCe, TCDD dhe SESRIC në Stamboll-Turqi,
- ❖ Inspektimin e linjave hekurudhore të cilat janë në shfrytëzim,
- ❖ Inspektimin e linjave hekurudhore të cilat nuk janë në shfrytëzim,
- ❖ Inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse të cilat janë të regjistruara në regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse e që janë në pronësi të TRAINKOS.

5.2.2.1. Autorizimet për futje në shërbim

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063, për Hekurudhat e Kosovës, neni 18, paragrafi 3.1, 3.2, dhe 3.3, neni 109 dhe 110:

Neni 18 paragrafët:

3.1 autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe të kontrollimi që ato kanë operuar dhe janë mirëmbajtur në përputhje me kërkesat esenciale;

3.2. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitet të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;

3.3. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;

Neni 109: Për futjen në shërbim të secilit nënsistem të hekurudhave, menaxheri i infrastrukturës apo ndërmarrja hekurudhore duhet të marrin një autorizim nga organi përgjegjës mbi sigurinë.

Neni 110: Para se të përdoret në rrjet, mjeti i transportit duhet të autorizohet që të futet në shërbim.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës INFRAKOS më datë 13/01/2014 ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për pajisjen "Plasser & Theurer tipi 08-16-SH" me numër serik 5994 viti i prodhimit 2013 i cili është i kalibruar sipas standardit EN 15273-2 GIC2 (A. 3. 3. 2), në ARH.

Në mbështetje të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063, neni 18, neni 109, neni 110, si dhe Direktivës: 2004/49/EU, 2008/57/EU për këtë fushë, Departamenti i Sigurisë pas analizimit të aplikacionit konform dispozitave ligjore në fuqi, ka vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe me datë: 30/01/2014 ka lëshuar Autorizimin për futjen në shërbim për pajisjen "Plasser & Theurer tipi 08-16-SH".



Me dt: 31/01/2014, Departamenti i Sigurisë ka lëshuar Autorizimin për vendosjen në shërbim të njetit të mirëmbajtjes së binarëve Plasser & Theurer, sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Direktivës: 2004/49/EU dhe 2008/57/EU për këtë fushë.

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoriteti Železnica
Railway Regulatory Authority

Numeri Evropian i Identifikimit (EIN): KS/54/2014/0001
Nr. Protokolli: 41
Referenca jostë: AFSH 01/2014
Data e autorizimit: 31/01/2014
Data e skadimit: Pakufizuar

AUTORIZIMI PËR FUTJEN NË SHËRBIM

Duke iu referuar kërkesës suaj për Autorizim të datës 13 janar 2014. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, ne konfirmojmë se ARH respektivisht Departamenti i Sigurisë e jep Autorizimin për vendosjen në shërbim të njetit të mirëmbajtjes së binarëve Plasser&Theurer tipi 08-16-SH, me numër serik 5994 viti i prodhimit 2013 i cili është i kalibruar sipas standardit EN 15273-2 GR2 (A.3.3.2), sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, direktivës: 2004/49/EU dhe 2008/57/EU për këtë fushë.

Nën-Sistemi i autorizuar me këtë letër duhet të mirëmbahet në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, si dhe Rregulloret dhe direktivat e BE për Siguri dhe Interoperabilitet; kjo përfshin përditësimin e dosjes teknike dhe regjistrit e duhura. Çdo ndryshim në të ardhmen i Nën-Sistemit mund të konsiderohet se është një rinovim ose një përmirësim. Pas çdo rinovimi të madh apo përmirësimi të punës, njetit lëvizës duhet të autorizohet nga ARH para se të vihet në shërbim.

Në përputhje me rregullat e sigurisë për hekurudhë dhe llojet e tjera të transportit, menaxheri i infrastrukturës do të duhet të bëjë aranzhimet e duhura brenda sistemit të tyre për menaxhimin e sigurisë (SMS) për të kontrolluar reziqet që lidhen me përdorimin e këtij Nën-Sistemi.

ARSYETIM

Subjekti juridik Infrakos SH.A si promar i njetit të mirëmbajtjes së binarëve Plasser&Theurer, ka bërë një kërkesë për Autorizim të njetit lëvizës me Nr. Protokolli 11, në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës dhe si bashkë me kërkesë ka dorëzuar këto dokumentacione përçelëse:

ISO certifikatë 9001 : 2008, raportin mbi peshën, determinimin e kualitetit të përdorimit, distancën e ndalojës, raportin për montimin e shumës, testet e motorit, deklarimin konformitetit 20 (të pamaturatorin hidrolik Nr. 11D620019), deklarimin konformitetit 32 (të pamaturatorin hidrolik Nr. 11D095024), deklarimin e konformitetit për valvulat e sigurisë Nr. 23/128706, 23/128712, deklarimin e konformitetit 57 Kurore-recorruari i ajrit Nr. 26587, deklarimin e konformitetit 100 Kurore-recorruari i ajrit Nr. 219856, 248760, testin e valvulave, incizimet për testin e rrotave, certifikimin e aksëve, certifikimin e rezistencës së rrotave, listën e shtesave etj. Të gjitha këto certifikata, teste dhe deklarata të konformitetit tregojnë se pajisja i përmbahet të gjitha normat e BE-së.

Me këtë konkludojmë se kompania Infrakos Sh.A si promar i njetit të mirëmbajtjes së binarëve Plasser&Theurer tipi 08-16-SH, i ka plotësuar kushtet për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për këtë njet lëvizës për mirëmbajtjen e binarëve dhe është përgjigjues për dëmtimet e ardhmen.

Nënshkrimi:
Vula A. Arsyetimi
Kryetar i Komitetit
Regulativni Autoriteti
Railway Regulatory Authority
Authority of Kosovo

Dr. Besmirë Bektashaj et 20
Presidenti Komiteti
Data: 31.01.2014
Grafiku: 11/2014
www.arh-ks.org

Operatori për Operim me Trena të Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS me datë 19/11/2013 ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për 9 vagonë të udhëtarëve në ARH. Në mbështetje të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063, neni 18, neni 109, neni 110, si dhe Direktivës: 2004/49/EU, 2008/57/EU për këtë fushë, Departamenti i Sigurisë pas analizimit të aplikacionit konform dispozitave ligjore në fuqi ka vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe me datë: 25/02/2014 ka dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për 9 vagonët e udhëtarëve të cekur me lartë.

Më datë: 25/02/2014 Departamenti i Sigurisë ka lëshuar Autorizimin për vendosjen në shërbim për nëntë 9 vagonë për transportin e udhëtarëve, sipas ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Direktivës 2004/49/EC dhe 2008/57/EC për këtë fushë.

5.2.2.2. Përgatitja e Rregullores së Sinjalizimit

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, respektivisht Departamenti i Sigurisë bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063, neni 102, për Hekurudhat në Republikën e Kosovës në muajin janar 2014 ka filluar punën për përgatitjen e Rregullave Nacionale të Sigurisë ashtu siç kërkohet me këtë ligj si dhe me Direktivën 2004/49/EC.

Duke pasur parasysh kompetencën nga Ligji për Hekurudhat, si dhe me qëllim që kjo rregullore të ketë një përmbajtje kualitative, Departamenti i Sigurisë ka propozuar që të dy kompanitë tona hekurudhore INFRAKOS dhe TRAINKOS të propozojnë nga një grup punues të përbërë nga ekspertë të cilët e njohin këtë fushë, propozim

Më dt: 14/08/2014 kemi përgatitur draft Rregulloren e Sinjalizimit e cila është dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës për aprovim.

ky i pranuar nga menaxhmenti i të dy kompanive. Pas një pune shtatë mujore ne në bashkëpunim të ngushtë me INFRAKOS dhe TRAINKOS kemi arritur që me dt:14/08/2014 ta finalizojmë Rregulloren e Sinjalizimit si njëra nga rregulloret me të rëndësishme në kuadër të Rregullave Nacionale të Sigurisë. Kjo rregullore përfshin praktikën me të mira të përdorura si nga shtetet e rajonit po ashtu edhe nga ato të vendeve anëtare të BE. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave e ka proceduar tutje këtë rregullore të Sinjalizimit të Ministria e Infrastrukturës për aprovim ashtu siç parashihet në Ligjin Nr. 04/L-063 neni 102 paragrafi 1 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës.

5.2.2.3. Përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë 2013

Raporti Vjetor i Sigurisë për vitin 2013 mbulon aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), respektivisht aktivitetet e Departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2013. Ky raport është i dyti me radhë të cilin e kemi përgatitur ashtu siç kërkohet nga Ligji 04/L-063 neni 20 për Hekurudhat e Kosovës si dhe Direktiva 2004/49/EC neni 18. Objektivat dhe përmbajtja e raportit janë të përcaktuara në Ligji në të cilin përshkruhen aktivitetet e vitit paraprak me informacionin si ne vijim:

- a. Zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS);

- b. Ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregulloret në lidhje me sigurinë hekurudhore;
- c. Zhvillimin e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimit të Sigurisë në Kosovë;
- d. Rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore;
- e. Përfshirjet të cilat nëse vendoset të bëhen nga Departamenti përgjegjës për Sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

ARH ka pranuar nga Menaxheri i Infrastrukturës INFRAKOS raportin vjetor me datë: 26/06/2014 si dhe raportin vjetor nga Ndërmarrja Hekurudhore TRAINKOS me datë: 11/07/2014.



Më datën: 26/06/2014 INFRAKOS ka dorëzuar Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2013.



Më datën: 11/07/2014 TRAINKOS ka dorëzuar Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2013

Bazuar në këto dy raporte si dhe nga aktivitetet dhe informatat tona, më datë: 30/09/2014 brenda afatit ligjor Departamenti i Sigurisë ka dorëzuar raportin vjetor të sigurisë te Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.




Më datën: 30/09/2013 Departamenti i Sigurisë ka përgatitur Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2013

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Agjencia Hekurudhore Evropiane (ERA), dhe përmban të gjitha çështjet e treguara në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Më poshtë është bashkangjitur Raporti i plotë Sigurisë për vitin 2013, përgatitur nga Departamenti i Sigurisë.

5.2.2.3.1. Raporti Vjetor i Sigurisë 2013

RAPORTI VJETOR I SIGURISË 2013



SHTATOR 2014

1. QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti Vjetor i Sigurisë për vitin 2013 mbulon aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), respektivisht aktivitetet e Departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2013. Ky është raporti i dytë me radhë të cilin e paraqesim te Drejtori i Përgjithshëm dhe te Bordi i ARH-së. Ky Raport i Sigurisë për vitin 2013 është punuar ashtu siç kërkohet nga Ligji 04/L-063, neni 20 për Hekurudhat e Kosovës si dhe Direktiva 2004/49/EC neni 18.

Objektivat dhe përmbajtja e raportit janë të përcaktuara në nenin 20 Ligji 04/L-063 mbi sigurinë hekurudhore.

Ky raport i përshkruan aktivitetet e vitit paraprak të ARH-së respektivisht Departamentit të Sigurisë, menaxherit të infrastrukturës (INFRAKOS) dhe Operatorit me Trena (TRAINKOS), ku duhet të përmbajë informacionet për së paku mbi:

- a. zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS);
- b. ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativ në lidhje me sigurinë hekurudhore;
- c. zhvillimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë;
- d. rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore;
- e. përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga departamenti përgjegjës për Sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Agjensioni Evropian Hekurudhorë (European Railway Agency- ERA), dhe përmban të gjitha çështjet të cilat janë paraqitur në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.



1. PJESA HYRËSE

2.1. Hyrje në raport

Raporti vjetor i Sigurisë për vitin 2013 i dyti me radhë, është raport i cili është përgatitur nga Departamenti i Sigurisë në kuadër të ARH-së, në përputhje me ligjin 04/L-063, neni 20 për Hekurudhat e Kosovës si dhe neni 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) të Agjensionit Evropian Hekurudhor (ERA).

Ky Raport i Sigurisë është përgatitur në radhë të parë nga informacioni i siguruar nga aktivitetet e Departamentit të Sigurisë si dhe nga informatat e raporteve vjetore të Ndërmarrjes Hekurudhore (TRAINKOS) dhe Menaxherit të Infrastrukturës (INFRAKOS). TRAINKOS ka marrë një certifikatë të vlefshme të sigurisë në Kosovë në vitin 2013, gjithashtu edhe INFRAKOS ka marrë një autorizim të vlefshëm të sigurisë në Kosovë në vitin 2013 nga ARH.

Struktura e Informacioneve Hekurudhore (Aneksi A)

2.2.1. Harta e rrjetit (Aneksi A. 1.)

Hartat e bashkangjitura (Aneksi A. 1.) tregojnë të gjithë rrjetin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Rrjeti hekurudhor në Republikën e Kosovës është i ndarë në këto linja:

- **Linja Veri - Jug** që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. (Linjë funksionale).
- **Linja Verilindje deri në Perëndim** që përbëhet nga tri degë:
 - **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me 45 km gjatësi.
 - Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale)
 - Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo -funksionale)

- **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me 81 km gjatësi (Linjë funksionale),
- **Linja Jug-Perëndim** nga Klina deri në Prizren me 58 km gjatësi.
 - Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale)
 - Xërxe – Prizren 32.5 (Linjë jo-funksionale)

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës më 01/09/2011 është bërë ndarja e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani të reja:

- Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës **INFRAKOS**, dhe
- Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës **TRAINKOS**

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,451 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,4 km. Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Vijat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Nga kjo që u tha me lartë shihet se nga totali prej 333.451 km rreth 131.70 km linjë hekurudhore nuk shfrytëzohet apo 39.49 %.

Linjat hekurudhore të cilat nuk janë në funksion janë:

1. Fushë Kosovë - Leshak (kufiri me Serbinë - 76.5 km),
2. Prishtinë – Podujevë -Merdare (kufiri me Serbinë -32.2 km),
3. Xërxe – Prizren (23 km).

Lista e Menaxherëve të Infrastrukturës dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore (Aneksi A. 2.)

Ky aneks tregon se Menaxheri i Infrastrukturës ka një Autorizim të vlefshëm të Sigurisë pjesa A dhe B, si dhe Ndërmarrja Hekurudhore e cila gjithashtu ka një Certifikatë të vlefshme të Sigurisë Pjesa A dhe B që nga 24 janar 2013.

Nr.	Emërtimi i kompanisë	Autorizim i Sigurisë pjesa A dhe B		Certifikatë e Sigurisë pjesa A dhe B	
1.	Menaxheri i Infrastrukturës (INFRAKOS)	24.01.2013	24.01.2013		
2.	Ndërmarrja Hekurudhore (TRAINKOS)			24.01.2013	24.01.2013

2.3. Përmbledhje- Analiza e Përgjithshme Trendi (p.sh. trendët në zhvillimin e sigurisë hekurudhore, autorizimi, certifikimi, autorizimi i futjes në shërbim etj)

- Në vitin 2013 numri i aksidenteve dhe incidenteve ishte 17, 32 % më pak në krahasim me vitin 2012 që ishte 25.
- Numri i vetëvrasjeve 1 në vitin 2012 dhe 0 në vitin 2013.
- Numri i personave të cilët ishin të plagosur rëndë ka mbetur në nivelin e vitit 2012 (6 persona).
- Në vitin 2013 numri i përgjithshëm i viktimave është 2 (dy), pra kemi një zbritje në krahasim me vitin 2012 që është 3, pra 33.33 % më pak viktimë në vitin 2013.

2.3.1. Autorizimi i Sigurisë dhe Certifikata e Sigurisë

Në përputhje me Ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloren e Komisionit 1169/2010, Rregulloren 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për menaxheret e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore.

Secila ndërmarrje hekurudhore që mban licencë, duhet të marrë Certifikatën e Sigurisë para se t'i jepet e drejta për qasje në një infrastrukturë hekurudhore. Qëllimi i Certifikatës së Sigurisë është të ofrojë dëshmi se ndërmarrja hekurudhore ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mund të plotësojë kërkesat e paraqitura në STI-të dhe në legjislacionin relevant të BE-së, si dhe në rregullat nacionale të sigurisë në ofrimin e shërbimeve të transportit të sigurt në rrjet.

Secili Menaxher i Infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të merr Autorizimin e Sigurisë, i cili konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të infrastrukturës dhe konfirmon pranimin e dispozitave të menaxherit të infrastrukturës për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn, mirëmbajtje dhe operim të sigurt të infrastrukturës hekurudhore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit, kur është e përshtatshme.

2.3.2. Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, neni 18 paragrafi 3.1, 3.3 neni 109, 110 dhe 111 secili mjet lëvizës para se të futet në shërbim duhet të autorizohet nga Departamenti i Sigurisë.

ARH më datën: 26/07/2013 ka pranuar nga TRAINKOS kërkesën për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për një lokomotivë dhe dy trena motorikë, kurse më datën: 11/10/2013 kemi pranuar kërkesën për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim edhe për njëmbëdhjetë lokomotiva dhe dy trena motorikë.

Më datën: 26/07/2013 dhe 11/10/2013 TRAINKOS ka dorëzuar kërkesën për marrjen e Autorizimit për Futjen në Shërbim për 12 Lokomotiva dhe 4 Trena Motorikë

Më datën: 12/08/2013 dhe 05/12/2013 ARH ka lëshuar Autorizimin për Futjen në Shërbim për 12 Lokomotiva dhe 4 Trena Motorikë

Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të ofruar nga TRAINKOS, si dhe pas plotësimit të dokumentacionit, më datën: 12/08/2013 kemi lëshuar Autorizimin për futjen në shërbim për një lokomotivë dhe dy trena motorikë, kurse më datën: 05/12/2013 kemi lëshuar autorizimin për futjen në shërbim edhe për njëmbëdhjetë lokomotiva dhe dy trena motorikë.

ARH më datën: 19/11/2013 ka pranuar nga TRAINKOS kërkesën për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për nëntë vagonë të udhëtarëve, kjo procedurë parashihet të përfundohet në fillim të vitit 2014.

Formati dhe modeli i Autorizimit për futjen në shërbim është i njëjtë me atë i cili përdoret nga vendet anëtare të BE.

Republika e Kosovës-Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

Numri Evropian i Identifikimit (EIN): **KS/51/2013/0001**
Nr. Protokolli: 271
Referenca jonë: AFSH 01/2013
Data e autorizimit: 12/08/2013
Data e skadimit: Pakufizuar

AUTORIZIMI PËR FUTJEN NË SHËRBIM

Duke iu referuar kërkesës suaj për Autorizim të datës 26 korrik 2013. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, ne konfirmojmë se ARH respektivisht Departamenti i Sigurisë e jep Autorizimin për vendosjen në shërbim të mjetit tërheqës për udhëtarë i regjistruar në regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse me këtë numër: 92 00 2640 007-6, sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, direktivave 2004/49/EU; 2008/57/EU për këtë fushë.

Nën-Sistemi i autorizuar me këtë letër duhet të mirëmbahet në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, si dhe Rregulloret dhe direktivave të BE për Siguri dhe Interoperabilitet; kjo përfshinë përditësimin e dosjes teknike dhe regjistrat e duhura. Çdo ndryshim në të ardhmen i Nën-Sistemit mund të konsiderohet se është një rinovim ose një përmirësim. Pas çdo rinovimi të madh apo përmirësim të punës, mjeti lëvizës duhet të autorizohet nga ARH para se të vihet në shërbim.

Në përputhje me rregullat e sigurisë për hekurudhë dhe llojet e tjera të transportit, operatori me trena do të duhet të bëjë aranzhimet e duhura brenda sistemit të tyre për menaxhimin e sigurisë (SMS) për të kontrolluar rreziqet që lidhen me përdorimin e këtij Nën-Sistemi.

ARSYETIM

Subjekti juridik Trainkos SH.A, si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 92 00 2640 007-6, ka bërë një kërkesë për Autorizim të mjetit lëvizës me Nr. Protokolli 694, në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës dhe së bashku me kërkesë ka dorëzuar këto dokumentacione përcjellëse:

-Listën e punëve të kryera (pjesët e riparuar, pjesët e ndërruara); Testet e kryera; Standardet sipas së cilave secili test është kryer; Rezultatet e testeve; Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë; Deklaratën e Konformitetit; Raporti i komisionit pranues teknik; Ndikimi i ndryshimeve (modifikimeve) në sigurinë kundër zjarrit/parandalimin e zjarrit; Ndikimi i ndryshimeve në statikën e mjetit lëvizës; Certifikata të tjera lidhur me performancën e kompanisë; Kontrata në mes Trainkos-it dhe CR-Com.

Me këtë konkludojmë se kompania Trainkos Sh.A si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 92 00 2640 007-6, i ka plotësuar kushtet për marrjen e Autorizimit të sigurisë për këtë mjet lëvizës por duke pasur parasysh se kjo kompani është përgjegjëse për riparinim që është kryer dhe për dëmtimet eventuale në të ardhmen.

Nënshkrimi: Enis Berisha
Drejtor i Përgjithshëm
Vula e Autoritetit

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Dr. Ibrahim Stanić
Präsident Kosovo
Predsednik Kosova
President of Kosovo
www.arh-ks.org

Republika e Kosovës-Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

Numri Evropian i Identifikimit (EIN): **KS/52/2013/0001**
Nr. Protokolli: 272
Referenca jonë: AFSH 02/2013
Data e autorizimit: 12/08/2013
Data e skadimit: Pakufizuar

AUTORIZIMI PËR FUTJEN NË SHËRBIM

Duke iu referuar kërkesës suaj për Autorizim të datës 26 korrik 2013. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, ne konfirmojmë se ARH respektivisht Departamenti i Sigurisë e jep Autorizimin për vendosjen në shërbim të mjetit tërheqës për udhëtarë i regjistruar në regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse me këtë numër: 95 00 5800 003-1, sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, direktivave 2004/49/EU; 2008/57/EU për këtë fushë.

Nën-Sistemi i autorizuar me këtë letër duhet të mirëmbahet në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, si dhe Rregulloret dhe direktivave të BE për Siguri dhe Interoperabilitet; kjo përfshinë përditësimin e dosjes teknike dhe regjistrat e duhura. Çdo ndryshim në të ardhmen i Nën-Sistemit mund të konsiderohet se është një rinovim ose një përmirësim. Pas çdo rinovimi të madh apo përmirësim të punës, mjeti lëvizës duhet të autorizohet nga ARH para se të vihet në shërbim.

Në përputhje me rregullat e sigurisë për hekurudhë dhe llojet e tjera të transportit, operatori me trena do të duhet të bëjë aranzhimet e duhura brenda sistemit të tyre për menaxhimin e sigurisë (SMS) për të kontrolluar rreziqet që lidhen me përdorimin e këtij Nën-Sistemi.

ARSYETIM

Subjekti juridik Trainkos SH.A, si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 95 00 5800 003-1, ka bërë një kërkesë për Autorizim të mjetit lëvizës me Nr. Protokolli 694, në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës dhe së bashku me kërkesë ka dorëzuar këto dokumentacione përcjellëse:

-Listën e punëve të kryera (pjesët e riparuar, pjesët e ndërruara); Testet e kryera; Standardet sipas së cilave secili test është kryer; Rezultatet e testeve; Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë; Deklaratën e Konformitetit; Raporti i komisionit pranues teknik; Ndikimi i ndryshimeve (modifikimeve) në sigurinë kundër zjarrit/parandalimin e zjarrit; Ndikimi i ndryshimeve në statikën e mjetit lëvizës; Certifikata të tjera lidhur me performancën e kompanisë; Kontrata në mes Trainkos-it dhe Quantum-it.

Me këtë konkludojmë se kompania Trainkos Sh.A si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 95 00 5800 003-1, i ka plotësuar kushtet për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për këtë mjet lëvizës por duke pasur parasysh se kjo kompani është përgjegjëse për riparinim që është kryer dhe për dëmtimet eventuale në të ardhmen.

Nënshkrimi: Enis Berisha
Drejtor i Përgjithshëm
Vula e Autoritetit

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Dr. Ibrahim Stanić
Präsident Kosovo
Predsednik Kosova
President of Kosovo
www.arh-ks.org

Modeli i Autorizimit për futje në shërbim

2. ORGANIZIMI

3.1. Prezantimi i organizimit

Bazuar në Ligjin 04/L-063, nenit 3 paragrafi 1.42. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është institucion i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrje, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ licencues, organi përgjegjës për çështjet e Interoperabilitetit dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe departamentin për sigurinë hekurudhore dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji. ARH është themeluar në vitin 2010, në vitin 2013 kishte 16 të punësuar prej tyre 3 ishin përgjegjës për sektorin e sigurisë hekurudhore.

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria hekurudhore mbahet dhe përmirësohet në sistemin hekurudhor të Kosovës.

Ky Departament duhet të jetë i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendim marrjen nga ndonjë Ndërmarrje Hekurudhore, Menaxher i Infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit.

Bazuar në Ligjin 04/L-063 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës Departamentit përgjegjës për Sigurinë hekurudhore i janë besuar detyrat në vazhdim:

1. autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe kontrollimin që ato operojnë dhe mirëmbahen në përputhje me kërkesat esenciale;
2. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;
3. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;
4. lëshimi, përtëritja, amendamenti dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat e paraqitura në to, dhe se menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore janë duke operuar sipas kërkesave të ligjit në Kosovë;
5. monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë;
6. mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;

7. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;
8. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës (RINF).

ARH në rolin e autoritetit të sigurisë është gjithashtu një pjesëmarrës i rregullt në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Agjensioni Evropian i Hekurudhave (ERA- European Railway Agency), si dhe në shumë aktivitete tjera të organizuara si nga SEETO po ashtu edhe nga vendet e tjera.

Kryesuesi i departamentit të sigurisë në kuadër të ARH-së ka qenë në një trajnim tre mujor në ERA- European Railway Agency, prej 15 prill deri me 15 korrik 2013, trajnimi është kryer në sektorin për siguri hekurudhore në kuadër të ERA.

3.2. Struktura Organizative e ARH është paraqitur në Aneksin B

4. ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE

4.1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë

ARH duhet të siguroj që siguria hekurudhore përgjithësisht të mirëmbahet, atëherë kur është e arsyeshme dhe praktike përmirësohet vazhdimisht duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së, ndryshimet, përparimet teknike dhe shkencore dhe prioritetin që i jepet parandalimit të aksidenteve serioze.

Për të arritur një regjim më efikas të mbikëqyrjes, ARH- Departamenti i Sigurisë ka përdorur metodën për qasje ndaj rrezikut. Në planifikimin e aktiviteteve mbikëqyrëse jemi bazuar nga përvoja me raportimet e aksidenteve, incidenteve si dhe përvoja nga proceset tjera janë përdorur në mënyrë aktive që prioritetet tona të përqendrohen në aktivitetet që përfaqësojnë rreziqet më të larta.

Prandaj, niveli i sigurisë në hekurudhë është varur nga mirë-funksionimi ndërmjet ARH, Menaxherit të Infrastrukturës dhe operatorit të transportit. Për këtë arsye, niveli i sigurisë në hekurudha është përshkruar në formën e objektivave për përmirësimin e sigurisë që janë zbatuar nga të gjitha palët ARH, Menaxheri i Infrastrukturës dhe operatorit të transportit.

Bazuar në informatat e më sipërme, vëmendja do të përqendrohet si në vijim:

- Rrezikun individual i cili ndërlidhet me udhëtarët, stafin (përfshirë edhe stafin e kontraktuesve),
- Rrezikun individual të shfrytëzuesve të vendkalimeve (kryqëzimeve hekurudhërrugë) dhe të tjerëve,
- Rrezikun individual duke mos paragjykuar rregullat e detyrueshme ekzistuese nacionale dhe rajonale ,
- Rrezikun individual lidhur me personat e pa autorizuar në objektet hekurudhore,
- Riskun social,
- Përfshirja aktive nga menaxhmenti i lartë në siguri (duke përfshirë vlerësimet e menaxhmentit),
- udhëzime të brendshme për vendkalimet dhe pajisjet e sigorisë,
- përdorimi aktiv i analizës së rrezikut (CSM RA).

Menaxheri i Infrastrukturë dhe Ndërmarrja Hekurudhore janë përgjegjës për sigurinë në rrjetin hekurudhor të Kosovës, ata duhet të implementojnë Sistemin e tyre për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) në mënyrë që të parandalohen aksidentet dhe incidentet.

ARH- Departamenti i Sigurisë i merr parasysh të gjitha rekomandimet në raportet nga organi për hetimin e aksidenteve dhe siguron që NH dhe MI i zbatojnë masat adekuate.

4.2. Analizimi i detajuar i trendit të të dhënave

Në mënyrë që të lehtësohet vlerësimi i arritjes së Qëllimeve të Përbashkëta të Sigurisë (QPS) të zhvilluara në BE dhe të ofrohet monitorim i zhvillimit të përgjithshëm të sigurisë hekurudhore, Organi përgjegjës për sigurinë duhet të mbledhë informacion për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS) nga raportet vjetore të Menaxherit të Infrastrukturës dhe Ndërmarrjes Hekurudhore siç është përcaktuar me ligjin për hekurudhat e Kosovës 04/L-063 dhe Direktivës së Sigurisë 2004/49/EC, ku si referencë i kemi paraqitur të dhënat nga viti 2009 e tutje.

Numri i aksidenteve:

2009	2010	2011	2012	2013
25	24	22	25	17

Numri i përgjithshëm i ngjarjeve të jashtëzakonshme të ndodhura në vitin 2013 ishte 17, pra kemi një zvogëlim në krahasim me vitin 2012 që ishte 25 ose (zvogëlim për 32%).

Numri i të vdekurve:

2009	2010	2011	2012	2013
4	2	3	3	2

Për periudhën 2012 kemi të raportuar tre (3) të vdekur si pasojë e aksidenteve, kurse për vitin 2013 kemi dy (2) të vdekur si pasojë e aksidenteve ose zvogëlim prej 33.33% .

Numri i të lënduarve:

2009	2010	2011	2012	2013
15	35	6	6	6

Pra siç shihet edhe nga tabela numri i të lënduarve të raportuar si pasojë e aksidenteve për vitin 2012 është gjashtë (6) persona dhe ky numër është i njëjtë me numrin e të lënduarve në vitin 2013 që është gjashtë (6) persona të raportuar.

Gjatë 2013 nuk ka pasur viktime të pasagjerëve apo të fuqisë punëtore në aksidentet e trenave.

- Shtatëmbëdhjetë (17)- numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme
- Dy (2)- qytetarë kanë vdekur si pasojë e aksidenteve.
- Zero (0)-të vdekur si pasojë e vetëvrasjes.
- Gjashtë (6)- qytetarë kanë pësuar lëndime.
- Zero (0)- tentime për vetëvrasje.

Viti	Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Të vdekur si pasojë aksidenti	Të vetëvrasurë	Të lënduar	Tentim vetëvrasje
2013	17	2	0	6	0

Në Aneksin C janë paraqitur të dhëna me të detajuara mbi zhvillimet kryesore dhe trendin e të dhënave për pesë vitet e fundit.

Në vitin 2013 ka pasur zvogëlim të tren/km të udhëtarëve 281931 km (14.13 % zvogëlim në krahasim me vitin paraprak 2012) dhe 109183 tren/ km për transportin e mallrave (17.64 % zvogëlim në krahasim me vitin paraprak 2012).

Viti	Numri i kilometrave të kaluar të trenave të udhëtarëve	Numri i kilometrave të kaluar të trenave të mallrave
2009	328410	115049
2010	328305	132562
2011	313902	122008
2012	328305	132562
2013	281931	109183

Shënime të përgjithshme për vitin 2013:

1	Km. për tren të udhëtarëve	281,931.60
2	Numri i udhëtarëve	369,777.00
3	Tren/km për udhëtarë	14.791,080.00
4	Net/ Ton të transportuar	1.002,457.84
5	Neto ton/km	45.826,419.00
6	Tren/km për mallra	109,183.00
7	Km. Total të shfrytëzuar	391,114.60

4.3. Rezultatet e rekomandimeve të sigurisë

Departamenti i sigurisë edhe gjatë vitit 2013 nuk ka pranuar asnjë rekomandim i cili ka të bëjë me sigurinë nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Rekomandimet e sigurisë hekurudhore duhet të përgatitën nga KHAIA dhe dërgohen te organet përgjegjëse për siguri.

Zhvillimet në sigurinë hekurudhore janë paraqitur në Aneksin C



Figura 1

5. NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Në mënyrë që të harmonizohet kuadri ligjor në Kosovë me ato të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian, Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 04/L-063 i datës 14.11.2011 hekurudhat e Kosovës (ka hyrë në fuqi me 01.01.2012), i cili ligj është i harmonizuar në masë të madhe me dispozitat e Direktivës 2004/49/EC. Ky ligj siguron zhvillimin dhe përmirësimin e sigurisë hekurudhore në Kosovë dhe përmirëson qasjen në shërbimet e tregut hekurudhorë.

Struktura e ARH-së, përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Çdo departament ka funksione të përcaktuara për t'iu përgjigjur nevojave të mobilitetit të shoqërisë, transportit dhe ekonomisë, siç rregullohen në këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nevojshme që nxjerrin vete ato dhe menaxhmenti i ARH-së.

Departamente në kuadër të ARH-së janë:

- Departamenti i Sigurisë,
- Departamenti i Tregut Hekurudhor,
- Departamenti i Interoperabilitetit,
- Departamenti i Licencimit.

Gjatë vitit raportues 2013, ARH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës ka hartuar disa udhëzime administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për Vendosjen, Përcaktimin dhe Arkëtimin e Pagesave të Qasjes në Infrastrukturën Hekurudhore.

ARH respektivisht departamentet përkatëse gjatë kësaj periudhe raportuese kanë përgatitur rregulloret të cilat janë miratuar nga ana e Bordit Mbikëqyrës të ARH-së.

Rregulloret e miratuara nga ARH gjatë vitit 2013 janë:

- Rregullore 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit,
- Rregullore 02/2013 për Licencimin e Makinistëve,
- Rregullore 03/2013 për Metodën e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrjen nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas Lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë.

Këto rregullore janë përgatitur me qëllim të përmirësimit të procedurave për: miratimin e Ekspozeut të Rrjetit, licencimin e makinistëve, mbikëqyrjen e NH dhe MI pas lëshimit të një certificate apo autorizimi të sigurisë.

Të gjitha të dhënat lidhur me ndryshimet në legjislacion, rregullore dhe dispozita administrative mund të gjeni në ueb faqen e ARH: www.arh-ks.org

6. ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË

6.1. Legjislacioni nacional - data e aplikimit - disponueshmëria

Lëshimi i certifikatës dhe autorizimit të sigurisë bëhet në pajtim me nenin 94, nenin 104 të Ligjit 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, nenit 10 dhe 11 të Direktivës 2004/49/EC.

Pas përgatitjes së të gjitha akteve nënligjore të domosdoshme për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë siç janë:

- Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2012 për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë,
- Rregullore Nr. 02/2012, për Dhënien e Certifikatës së Sigurisë,
- Rregullore Nr. 03/2012, për Dhënien e Autorizimit të Sigurisë,
- Rregullore Nr. 06/2012, për Regjistrimin e Infrastrukturës

Departamenti i Sigurisë me datë: 26/11/2012, nga NH (TRAINKOS) ka pranuar aplikacionin për marrjen e certifikatës së sigurisë, kurse me datë: 12/12/2012, nga MI (INFRAKOS) ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit të sigurisë.

Në përputhje me Ligjin 04/L-063 neni 104, për Hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloret e Komisionit 1169/2010 dhe 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për Menaxheret e Infrastrukturës dhe Ndërmarrjet Hekurudhore.

ARH me datë 24 janar 2013 ka lëshuar:

INFRAKOS- Autorizimin e Sigurisë, pjesa A dhe B

TRAINKOS- Certifikatën e sigurisë, pjesa A dhe B.

Departamenti i Sigurisë pas vlerësimit të detajuar të aplikacioneve nga të dy kompanitë TRAINKOS (Certifikatë të Sigurisë) dhe INFRAKOS (Autorizim të Sigurisë), kemi arritur që me datë 24 janar 2013 të lëshojmë Certifikatën e Sigurisë pjesa A dhe B për TRAINKOS, si dhe Autorizimin e Sigurisë pjesa A dhe B për INFRAKOS.

ARH - Departamenti i Sigurisë bën lëshimin e certifikatave dhe autorizimeve të sigurisë



Foto nga Ceremonia e dhënies së Autorizimit dhe Certifikatës së Sigurisë

pjesa A dhe B. Bazuar në Udhëzimin administrative Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimit të Sigurisë për NH dhe MI, neni 11 paragrafi 1 certifikimi dhe autorizimi i sigurisë është pa pagesë për tre vite prej datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Në një ceremoni zyrtare ARH ka dhënë Autorizimin e Sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës INFRAKOS dhe Certifikatën e Sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore TRAINKOS.

Ceremonia është mbajtur në Zyrën për Informim të Bashkimit Evropian në Prishtinë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të BE-së, Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, INFRAKOS, TRAINKOS dhe përfaqësuesve të ARH-së.

Departamenti i Sigurisë më datë: 24/01/2013 i ka përfunduar të gjitha procedurat për dhënien e Autorizimit të Sigurisë, kurse më datën: 30/01/2013 është pranuar Autorizimi



Dhënia e Autorizimit të Sigurisë për INFRAKOS



Dhënia e Certifikatës së Sigurisë për TRAINKOS

i Sigurisë nga Drejtori i Përgjithshëm i Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore. Autorizimi i Sigurisë është lëshuar me kusht që Menaxheri i Infrastrukturës brenda afatit 120 ditësh ta punojë në mënyrë të detajuar Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë (SMS).

Departamenti i Sigurisë më datë: 24/01/2013 ka përfunduar të gjitha procedurat për dhënien e Certifikatës së Sigurisë, kurse më datën: 30/01/2013 është pranuar Certifikata e Sigurisë nga përfaqësuesi i Bordit të Ndërmarrjes Hekurudhore. Certifikata e Sigurisë është lëshuar me kusht që Ndërmarrja Hekurudhore brenda afatit 120 ditësh të punojë në mënyrë të detajuar SMS-in. Bazuar në kushtin për dhënien e Autorizimit dhe Certifikatës së Sigurisë që brenda afatit 120 ditësh MI dhe NH të punojnë në mënyrë të detajuar Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë (SMS), të dy kompanitë brenda afatit ligjorë kanë përmbushur këtë kërkesë.

	Republika e Kosovës-Republika Kosovo-Republic of Kosovo Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave Regulatorniti Autoriteti Železnica Railway Regulatory Authority	
AUTORIZIMI I SIGURISË-PJESA A		
Autorizimi i Sigurisë e konfirmon pranimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 05/2012, në përputhje me Direktivën 2004/49/EK.		
Nr. Identifikues KS 22 2013 00001		
1. MENAXHERI I AUTORIZIMIT I INFRASTRUKTURËS		
Emendimi i Llogarit: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-“InfraSh” SH.A Emri i Menaxherit të Infrastruktura: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-“InfraSh” SH.A Nr. i Biletës: 20025327	Shikohet: InfraSh SH.A Nr. i Fsh. X00051081	
2. INSTITUCIONI PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT		
Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave		
Shteti: Republika e Kosovës		
3. INFORMATAT E AUTORIZIMIT		
Ky biletë rrit: -Autorizimin e ri -Autorizimin e rinovuar -Autorizimin e shtyrtuar	☒ 1 ☐ 2 ☐ 3 Numri i identifikimit të Autorizimit të rregulluar:	
E vlefshësi nga: 24.01.2013 Këtu: 23.01.2016		
Lloji i shërbimit: 1. Përvoja minimale e qytetit 2. Qasja në biletë për qytetin e detyrueshëm të funksionit të shërbimit 3. Shërbimet shërbues 4. Shërbimet ndihmuese 5. Shërbimet tjera		
Numri i Menaxhimit të Infrastruktura: I. Nji Madhësia e administrimit: Hekurudhat: I. anëtar		
4. LEGJISLATIVIA NACIONALE NË FUQI		
Legjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 05/2012		
5. INFORMATAT SHITES		
Menaxhimi i Infrastruktura-“InfraSh” SH.A, obligohet që në afat prej 120 ditë, nga data e marrësisë së kësaj Autorizimi të përcaktë dhe shpallë në ARIH, Sistemin e detyrueshëm për Menaxhimin e Sigurisë (SMS)		
Data e Biletës 24.01.2013	Newshkrimi: Imz. Beshika	
Numri i biletës dhe i referencës AUT 05/2013	Vula e Autoritetit:	
Dr. Besimta Rexhepi Drejtuese Menaxhimi (Shënim: Nëse qyteti është i ri) 04/2012-05/2012 www.arih.kg Komiteti i Konfirimit Hekurudhat Komiteti Assembly of Kosovo		

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

AUTORIZIMET I SIGURISË-PJESA B

Autorizimi i Sigurisë për konfidenca Dëpërtim e miratuar nga menaxheri i infrastrukturës për të përbërësuar kërkesat e nevojshme për projektin të sigurt, miratohet dhe operim të përhapje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzime përkatëse administrative 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, të përhapje me Direktivën 2004/49/EK:

Nr. Identifikues: KS 22 2013 0001

1. MENAXHERI I AUTORIZUAR I INFRASTRUKTURËS

Emri i Ligjit: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-"InfraShk" Sh.A.

Emri i Menaxherit të Infrastrukturës: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-

Shkurtori: InfraShk Sh.A

"InfraShk" Sh.A.

Nr. i Biletës: 76323327

Nr. i Tërës: 330011681

2. INSTITUCIONI PËR Lëshimin E AUTORIZIMIT

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Shteti: Republika e Kosovës

3. INFORMATË E AUTORIZIMIT

Ky është një: - Autorizim i ri

☒

- Autorizim i rinovuar

☐

Nuhat i identifikimi të

- Autorizim i ndryshuar

☐

Autorizimi të rregulluesit:

E vlefshme nga: 24.01.2013

Deri: 23.01.2018

Llogi i shërbimit:

3. AUTORIZIMET I SIGURISË-PJESA A (Prandaj e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë)

Nuhat i Identifikues: KS 21 2013 0001

4. INFRASTRUKTURA E OPERUAR

Të gjitha llogit ekraneve në territorin e Kosovës

5. KUSHTET E VEÇANTA DHE DETYRIMET

Nuk ka

6. LEGJISLACIONI NACIONAL I APLIKUESHËM

Legjislatimi në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzime Administrative Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 03/2012

Data e Shërbimit

24.01.2013

Ndërkohë: Etnë Bërbetë

Nuhat i bërthamës i referencës

AUT 01/2013

Vala e Autorizimit

Sh. Nivani Shërbimi Nr.20
Prishtinë, Kosovo
Tel: 030 46 20 40
Fax: 030 46 20 40
E-mail: info@rra.gov.kg

Kuvendi i Kosovës
Shërbimi Ekzter
Assembly of Kosovo

Autorizimet e Sigurisë (pjesa A dhe B)

	Republika e Kosovës-Republika Kosovo-Republic of Kosovo Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave Regulatory Authority of Railways Railway Regulatory Authority													
CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A														
Certifikata e Sigurisë që konfirmon prezencën e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në përputhje me Ligjin Nr. 04/12-063 për Hekurudhat e Kosovës, ndërfuturën përkatëse administrativë 04/012 dhe rregulloren 03/012, në përputhje me Dekretin 2004/49/KC.														
Nr. Identifikues: KS 11 203 0001														
1. NËDMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE														
Emri i Ligjit: Opetim me trenë i Hekurudhave të Kosovës "Trenikë" SH.A Emri i operacionit hekurudhor: Opetim me trenë i Hekurudhave të Kosovës "Trenikë" SH.A Nr. i licencës: 709773128	Shkurtimi: Trenikë SH.A Nr. i Tred: 33014383													
2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI														
Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave Shteti: Republika e Kosovës														
3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS														
<table border="0"> <tr> <td>Kjo tabelë tregon:</td> <td>Certifikatën e re:</td> <td>☒</td> <td>Numeri i identifikimit të:</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Certifikatës së rinovuar:</td> <td>☐</td> <td>Certifikatës së më parshme:</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Certifikatën e ndryshuar:</td> <td>☐</td> <td></td> </tr> </table>			Kjo tabelë tregon:	Certifikatën e re:	☒	Numeri i identifikimit të:		Certifikatës së rinovuar:	☐	Certifikatës së më parshme:		Certifikatën e ndryshuar:	☐	
Kjo tabelë tregon:	Certifikatën e re:	☒	Numeri i identifikimit të:											
	Certifikatës së rinovuar:	☐	Certifikatës së më parshme:											
	Certifikatën e ndryshuar:	☐												
E vlefshme nga: 24.05.2013 Deri: 23.01.2018														
Lloji i shërbimit: Transport i pasagjerëve: Duke përfshirur shërbimet e dhequrisë të lartë (L.7) Transport i mallve: Transport i mallve: Duke përfshirur shërbimet për mallëra të rregullshme (L.8b)														
Vlera / transporti: Më pak se 200 milionë euro për vitin (L.8) Më pak se 500 milionë euro për vitin (L.12)														
Shërbimet e ndërmarrjes hekurudhore: Ndërmarrjet e pasazhe (L.18)														
4. LEGJISLACIONI NACIONAL NË FUQI														
Legjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/12-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/012 dhe Rregulloren Nr. 03/012														
5. INFORMATAT SHITESË														
Operacioni hekurudhor "Trenikë" SH.A obligohet që në afat prej 120 ditë, nga data e merrjes së kësaj Certifikate të përgjithësi dhe qëllat në ARR, Sistemin e dhequrisë për Menaxhimin e Sigurisë (SMS).														
Data e Shërbimit 24.01.2013	Ndoshtori: Edin Berisha													
Numeri i Identifikimit të referencës CR-02/2013	Vlera e Autoritetit:													
<table border="0"> <tr> <td> Pr. Rrethetë Kosovës Nr. 27 Prishtinë, Kosovë Telefoni: 06 39 10 10 Faks: 06 39 10 11 www.rrh.kosovo </td> <td> Komiteti i Kosovës Shkallë Komiteti Assembly of Kosovo </td> </tr> </table>			Pr. Rrethetë Kosovës Nr. 27 Prishtinë, Kosovë Telefoni: 06 39 10 10 Faks: 06 39 10 11 www.rrh.kosovo	Komiteti i Kosovës Shkallë Komiteti Assembly of Kosovo										
Pr. Rrethetë Kosovës Nr. 27 Prishtinë, Kosovë Telefoni: 06 39 10 10 Faks: 06 39 10 11 www.rrh.kosovo	Komiteti i Kosovës Shkallë Komiteti Assembly of Kosovo													

Republika e Kosovës-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhëve
Regulatorni Autoriteti Železnice
Railway Regulatory Authority

CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA B

Certifikati e Sigurisë që konfirmon prezencën e dispozitivës që monitoron për ndërrim të hekurudhës me aplikim përvarësishëm e kërkimesh specifike për operim të regjistruar përkatës në përputhje me Ligjin Nr. 045/061 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimet përkatës administrative 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Dekretin 2006/04/02.

[Nr. Identifikues: KS 12 2013 0001]

1. NËDRIMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi i Lajmër Operativ në vetën e Hekurudhës në Kosovën "Tranzit" S.H.A	
Emri i kompanisë teknike/ Lajmër në vetën e Hekurudhës në Kosovën "Tranzit" S.H.A	Shënimet: Tranzit S.H.A
Nr. i Dokument: 3407/13/26	Nr. i Flet: 33041413/3

2. CERTIFIKATA E Lëshuar nga Institucione

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhës
Shirr: Republika e Kosovës

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një: ☒ Certificate e re ☐ Certificate e rinovuar ☐ Certificate e rishikuar	Numri i identifikimit të Certificate të re parash: _____ Numri i identifikimit të Certificate të re parash: _____
E vlefshme nga: 24.03.2013	Nr.: 23.01.2018
Lloji i shërbimit: - Transporti i udhëtarëve: Duket përjashtues shërbimet e shërbimit të lartë (S.T) - Transporti i mallve: Duket përjashtues shërbimet për mallin të rrezikshëm (S.HH)	

4. CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A (Përshkrim i Sistemit që Monitorohet në Siguri)

Numri i Identifikimit: KS 11 3613 0001

5. LËNJAT E OPERIMIT

Ed gjithë ligjet ekzistuese që ndërrim të hekurudhës

Shk. ka

7. LEGJISLACIONI NACIONAL I APLIKUESHËM

Ligjvënës në flet: Ligji Nr. 045/061,
Udhëzimet Administrative Nr. 04/2012 dhe
Rregulloren Nr. 03/2012

Data e Validimit
[24.03.2013]

Niveli i Dokumentit: Flet Shërbimi

Numri i Identifikimit të certifikatës
[CER 02/2013]

Vlera e Dokumentit

No. Dokumenti i Sistemit të Sigurisë
Sistemi i Sigurisë
012-012-012-012
www.rrk.co.k

Kosovo e Kosovës
Monitorimi Rregullativ
Railway Regulatory
Authority of Kosovo

Certifikata e Sigurisë (pjesa A dhe B)

6.2. Të dhënat numerike

Aneksi D përmban një përmbledhje të të dhënave të ndryshme numerike për certifikatat dhe autorizimet e sigurisë.

Në vitin 2013 ARH nuk ka pranuar asnjë nga aplikimet e më poshtme:

- aplikacion për autorizim të sigurisë pjesa A,
- aplikacion për autorizim të sigurisë pjesa B,
- aplikacion për certifikatë të sigurisë pjesa A,
- aplikacion për certifikatë të sigurisë pjesa B,

7. MBIKËQYRJA E NDËRMARRJEVE HEKURUDHORE DHE MENAXHERVE TË INFRASTRUKTURËS

7.1. Përshkrimi i mbikëqyrjes së Ndërmarrjes Hekurudhore dhe Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore

Në kuadër të Departamentit të Sigurisë të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e NH dhe MI janë tre të punësuar, ne kryesisht jemi fokusuar në plotësimin e legjislacionit sekondar ku në fillim të vitit 2013 kemi përgatitur rregulloren Nr. 03/2013 Metodat e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas Lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë.

Duke pasur parasysh se ka qenë hera e parë që MI është pajisur me Autorizim të Sigurisë, ndërsa (NH) me Certifikatë të Sigurisë, ne gjatë vitit 2013 nuk e kemi planifikuar inspektimin e Autorizimit dhe Certifikatës së sigurisë me qëllim që të dy kompanive të ju jepet kohë që të familjarizohen me kushtet që parashihen për mbajtjen e autorizimit dhe certifikatës së sigurisë.

Gjatë vitit 2013 ne kemi kryer inspektimin e linjave hekurudhore të cilat janë në shfrytëzim siç janë:

- Fushë Kosovë – Medvec - Magure,
- Prishtinë - Fushë Kosovë,
- Fushë Kosovë – Hani i Elezit,
- Fushë Kosovë – Pejë.

7.2. Përshkrimi i trajtimit të aspekteve ligjore në raportet vjetore të Menaxherëve të Infrastrukturës dhe Ndërmarrjet Hekurudhore - Disponueshmeria e raporteve vjetore para 30 qershorit, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063, neni 103 (6) për Hekurudhat e Kosovës si dhe nenin 9 (4) të Direktivës për Siguri Hekurudhore

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës ka pranuar nga INFRAKOS raportin vjetor me datë 26/06/2014 si dhe raportin vjetor nga TRAINKOS më datë: 11/07/2014.



- ❖ INFRAKOS- Menaxheri i Infrastrukturës hekurudhore (26/06/2014),
- ❖ TRAINKOS- Ndërmarrja Hekurudhore (11/07/2014).

7.3. Ankesat nga MI dhe NH ndaj Departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2013

Ne si Departament i Sigurisë nuk kemi pranuar asnjë ankesë nga MI dhe NH apo nga ndonjë palë tjetër, për punën të cilën e kemi kryer gjatë vitit 2013.

7.4. Numri i inspektimeve të NH dhe MI gjatë vitit 2013

Inspektimet e linjave hekurudhore		Fushë Kosovë Medvec Magure	Prishtinë Fushë Kosovë	Fushë Kosovë Hani i Elezit	Fushë Kosovë Pejë
Numri i Inspektimeve	Planifikuara	1	1	1	1
	Pa Planifikuara	/	/	/	/
	Realizuara	1	1	1	1

7.5. Numri i auditimeve të NH dhe MI gjatë vitit 2013

Auditimet		Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa A	Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa B	Autorizimet e lëshuara të sigurisë pjesa A&B	Aktivitete tjera
Numri i Auditimeve	Planifikuara	/	/	/	/
	Pa Planifikuara	/	/	/	/
	Realizuara	/	/	/	/

8. RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E METODAVE TË PËRBASHKËTA TË SIGURISË (MPS) PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT

Rregullorja Nr. 352/2009/EC të Komisionit të datës 24 prill 2009 mbi adoptimin e një metode të përbashkët të sigurisë (MPS) për vlerësimin e rrezikut duhet të aplikohet nga 1 korriku 2012 edhe pse kjo metodë ka filluar të aplikohet nga shtetet anëtare të BE-së që nga vitit 2010.

- Te të gjitha modifikimet e rëndësishme teknike të mjeteve lëvizëse, siç janë të përcaktuara në nenin 2 (c) të Direktivës 2008/57/EC.
- Të gjitha modifikimet strukturore të rëndësishme për nën-sistemet, ku neni 15 (1) i Direktivës 2008/57/CE, ose një TSI e kërkon atë.

Bazuar në Ligjin 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, metodat e përbashkëta të sigurisë (MPS) – duhet të zhvillohen dhe të përshkruajnë se sa janë vlerësuar dhe arritur caqet e sigurisë dhe përputhshmëria e tyre me kërkesat tjera të sigurisë.

Për vitin 2013 nuk kemi një raportim për atë se sa janë aplikuar MPS.

Si rezultat i kësaj MPS (CSM) janë të përfshira në një fushë me fokus të veçantë në planin tonë të mbikëqyrjes për vitin 2014.

Aktivitetet apo Informacionet lidhur me zbatimin e MPS gjithashtu do ti kemi në vitin 2014.

9. MASAT ALTERNATIVE PËRMES PËRJASHTIMEVE LIDHUR ME ENTITETIN PËRGJEGJËS PËR MIRËMBAJTJEN (EPM-ECMD SKEMA E CERTIFIKIMIT

Gjatë vitit 2013 nuk kemi ndonjë Entitet Përgjegjës të Mirëmbajtjes të certifikuar. Në planin e punës për vitin 2014 kemi paraparë që të përgatitet baza ligjore- rregullore apo udhëzim për certifikimin e Entitetit Përgjegjës të Mirëmbajtjes.

10. DEPARTAMENTI I SIGURISË KONKLuzionET PËR VITIN E RAPORTIMIT - PRIORITETET

Departamenti i sigurisë gjatë vitit 2013 ka vazhduar me përgatitjen e legjislacionit sekondar për nevojat e funksionimit të këtij departamenti dhe si rezultat kemi përgatitur Rregulloren Nr. 03/2013 Metodën e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas Lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë. Ne po planifikojmë një mbikëqyrje e cila bazohet në prioritetet për vlerësimin e rrezikut të bazuar.

Fushat specifike të fokusuara:

- përdorimi aktiv i analizës së rrezikut dhe njohja e MPS (CSM),
- autorizimin e Menaxherit të Infrastrukturës,
- certifikimin e Ndërmarrjes Hekurudhore,
- përfshirja aktive e menaxhmentit në rritjen e sigurisë,
Në këto fotografi shihet gjendja ekzistuese në stacionin hekurudhor të Pejës stacioni në fjalë ka 7 binarë dhe 18 ndërruese mekanike të gjitha funksionale platforma e stacionit nuk është e shenjëzuar stacioni nuk posedon shenjë për ndalimin e trenit ndriçimi në stacion funksionon pjesërisht sistemi i sinjalizimit nuk është funksional.



Në këto fotografi shihen dy vendkalime legale ne fotografimin e parë shihet vendkalimi i cili gjendet ne kilometrin (63+390) i cili është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut ne të dy anët e rrugës ne vendkalimin e dytë i cili gjendet afërsisht ne kilometrin (63+700) nuk ka shenja të rrezikut në asnjërën anë te rrugës. Me qëllim të rritjes së sigurisë ne komunikacion këto dy vendkalime duhet te pajisen me shenja të rrezikut.

5.2.2.5.2. INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-MAGURE

Datë: 03.09.2014

Gjatë inspektimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Magure janë inspektuar:

- | | |
|--------------------------|---------------------------------------|
| ✚ Sinjalizimi | ✚ Ndërrueset |
| ✚ Traversat | ✚ Bulonat |
| ✚ Rampat mbrojtëse | ✚ Binarët |
| ✚ Kalimet në nivel | ✚ Dukshmëria |
| ✚ Platforma e stacioneve | ✚ Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore |
| ✚ Balasti | |



Në këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet rrugës për aeroport, vendkalimi është i pajisur me shenjat e rrezikut STOP dhe kryqi i Andret që janë te vendosura në te dy anët e rrugës, dukshmëria afër vendkalimit është e kufizuar për shkak te shkurreve vendkalimi nuk ka sistem te sinjalizimit apo rampë mbrojtëse. Krahasuar me vitin paraprak gjendja në vendkalim është e njëjtë sa i përket sigurisë. Më qenë se në këtë vendkalim frekuentojnë një numër i madhe i automjeteve dhe paraqet rrezik për të gjithë pjesëmarrësit e komunikacionit, ky vendkalim duhet të sigurohet me sistem të sinjalizimit apo rampë mbrojtëse(barriere).



Në këto fotografi shihet vendkalimi i cili ndodhet në hyrje të rrugës së vjetër për ne Aeroport, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës, gjendja e mirëmbajtjes në afërsi të binareve nuk është e mirë për shkak te shkurreve të cilat e vështirësojnë dukshmërinë gjatë lëvizjes së trenit. Krahasuar me vitin paraprak vendkalimi është në gjendje të njëjtë sa i përket sigurisë hekurudhore. Më qellim te rritjes së sigurisë gjatë lëvizjes pranë vendkalimit dhe zvogëlimit të aksidenteve ne komunikacionin hekurudhor ky vendkalim duhet te sigurohet me shenja të sinjalizimit apo me rampe mbrojtëse (barriere) si dhe te pastrohet zona në afërsi të binarëve. Për sigurimin e komunikacionit hekurudhë - Rrugë, rekomandojmë që Menaxheri i Infrastrukturës në

bashkëpunim me Aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës të bëjnë marrëveshje për vendosjen e sinjalizimit me dritë dhe barrierat mbrojtëse në rrugën e re dhe në hyrje të rrugës së vjetër për në Aeroport.



Në këto fotografi shihet vendkalimi cili gjendet 500m nga hyrja e vjetër e aeroportit, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, gjendja për rreth binarëve jo e mirë për shkak të shkurreve, shenja e kryqit të Andreut në gjendje jo të mirë, sinjali në afërsi të vendkalimit jashtë funksionit. Krahasuar me vitin paraprak gjendja në këtë vendkalim është e njëjtë nuk ka përmirësime sa i përket sigurisë hekurudhore. Me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacionin hekurudhor këtë vendkalim duhet të vendosen shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës të pastrohet zona në afërsi të binarëve me qëllim të rritjes së dukshmërisë, sinjali në afërsi të vendkalimit duhet të rregullohet dhe të hynë në funksion.



Në këto fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet 300m nga hyrja e vjetër e Aeroportit, është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, gjendja për rreth binarëve jo e mirë për shkak të rritjes së shkurreve, shenja treguese e cila tregon vijën hekurudhore në ngritje, në gjendje jo të mirë për shkak se numrat që tregojnë gjatësinë e pjerrtësisë dhe madhësinë e pjerrtësisë janë fshirë. Krahasuar me vitin paraprak vendkalimi në fjalë është në gjendje të njëjte sa i përket sigurisë hekurudhore. Në këtë vendkalim duhet të vendosen shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës të pastrohet zona në afërsi të binarëve me qëllim të rritjes së dukshmërisë si dhe shenja treguese e cila ndodhet afër vendkalimit duhet të zëvendësohet me shenjën me të njëjtën domethënie.




Në këto fotografi shihet vendkalimi cili gjendet 500m nga hyrja e vjetër e aeroportit, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës, gjendja për rreth binareve jo e mirë për shkak të shkurreve, shenja e kryqit të Andreut në gjendje jo të mirë, sinjali në afërsi të vendkalimit jashtë funksionit. Krahasuar me vitin paraprak gjendja në këtë vendkalim është e njëjte nuk ka përmirësime sa i përket sigurisë hekurudhore. Me qëllim të rritjes së sigurisë së komunikacionin hekurudhor në këtë vendkalim duhet të vendosen shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës, të pastrohet zona në afërsi të binareve më qëllim të rritjes së dukshmërisë, sinjali në afërsi të vendkalimit duhet të rregullohet dhe të funksionalizohet.



Në këto fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në afërsi të betonjerkës, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës, gjendja për rreth binareve jo e mirë për shkak të shkurreve, dukshmëria e kufizuar për shkak të rritjes së barishteve në afërsi të hekurudhës, shenja hektometrike e cila tregon distancën prej fillimit të vijës hekurudhore deri në mbarim të saj e ka humbur kuptimin për shkak se shiriti i kuq në maje dhe me numrat e shkruar për hektometër dhe kilometër janë fshirë. Krahasuar me vitin paraprak vendkalimi në fjalë është në gjendje të njëjte nuk ka përmirësime sa i përket sigurisë hekurudhore. Në këtë vendkalim duhet të vendosen shenjat e rrezikut, të bëhet prerja e shkurreve dhe barishteve për rreth zonës së binarëve.



Në këto fotografi shihet vendkalimi cili gjendet 100m përtej betonjerkës vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës shtresa e balastit e pa mjaftueshme. Me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacionin hekurudhor dhe parandalimit të ndonjë aksidenti vendkalimi duhet të pajiset me shenja të rrezikut si dhe shtresa e balastit të jetë e mjaftueshme.



Në këto fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në afërsi të stacionit të Policisë vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës. Krahësuar me vitin paraprak vendkalimi është në gjendje të njëjte dhe nuk ka përmirësime sa i përket sigurisë hekurudhore. Me qenë se vendkalimi lidhet disa zona të banimit dhe ka një numër të madhe të automjeteve të cilat qarkullojnë përmes këtij vendkalimi si dhe për të evituar ndonjë aksident komunikacioni ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja sinjalizuese apo mundësisht me rampë (barrierë).



Në këto fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në fshatin Medvec vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës gjendja për rreth binareve jo e mirë për shkak të shkurreve shenja hektometrike e ka humbur kuptimin shiriti i kuq në majë dhe me numrat e shkruar për hektometër dhe kilometër të cilët tregojnë fillimin dhe fundin e vijës hekurudhore janë fshirë. Me qëllim të parandalimit të ndonjë aksidenti dhe rritjes së sigurisë në komunikacionin hekurudhor ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës të pastrohet zona për rreth binareve nga barishtet.



Në këto fotografi shihet vendkalimi cili gjendet afër minierës në Medvec. Ky vendkalim është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës shtresa e balastit jo e mjaftueshme jastëkët e ndërrueses te pa vajosur gjendja sa i përket mirëmbajtjes për rreth binareve duhet të përmirësohet. Më qëllim të rritjes së sigurisë ky vendkalim duhet të pajiset me shenjat të rrezikut të bëhet vajosja e pjesëve përbërëse të ndërruesve si dhe sasia e balastit të jetë e mjaftueshme.



Në këto fotografi shihet ndërruesja si dhe shenja hektometrike të cilat ndodhen afër vendkalimit të minierës së Medvecit, shenja hektometrike e ka humbur kuptimin shiriti i kuq në maje dhe numrat të cilët tregojnë për distancën prej fillimit të vijës hekurudhore deri kah fundi i vijës hekurudhore janë fshirë, në figurën tjetër shihen pjesët përbërëse të ndërrueses jastëkët, dallëndyshja të cilat janë të pa vajosura.



Në këto fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në fshatin Medvec, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës, dukshmëria e kufizuar për shkak të objekteve në afërsi të hekurudhës. Krahasuar me vitin paraprak vendkalimi është në gjendje të njëjte nuk ka përmirësime sa i përket sigurisë hekurudhore. Më qenë se në këtë vendkalim frekuentojnë numër i madh i automjeteve dhe këmbësoreve ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut në te dy anët e rrugës si dhe mundësisht me rampe mbrojtëse (barrierë).



Në këto fotografi shihet vendkalim i cili gjendet në Medvec, është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, gjendja për rreth binareve jo e mirë për shkak të rritjes së shkurreve shtresa e balastit e pa mjaftueshme dukshmëria e kufizuar për shkak të objektit të banimit në afërsi të binarëve. Më qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacion dhe parandalimit të ndonjë aksidenti vendkalimi në fjalë duhet të pajiset me shenja të rrezikut të pastrohet zona për rreth binarëve shtresa e balastit të jetë e mjaftueshme.



Në këto fotografi shihet gjendja ekzistuese e hekurudhës në Magure e cila është jashtë funksionit, siç shihet në foto mbeturinat, barishtet e kanë mbuluar një pjesë të hekurudhës

5.2.2.5.3. INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-DRENAS

Datë: 10.09.2014

Gjatë inspektimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Drenas janë inspektuar:

- ✚ Sinjalizimi
- ✚ Traversat
- ✚ Rampat mbrojtëse
- ✚ Kalimet në nivel
- ✚ Platforma e stacionit
- ✚ Balasti
- ✚ Ndërrueset

- ✚ Bulonat
- ✚ Binarët
- ✚ Dukshmëria
- ✚ Ndriçimi
- ✚ Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore




Në këto dy fotografi shihet gjendja ekzistuese e stacionit hekurudhor në Bardh, stacioni hekurudhor në Bardh përbehet nga 6 binarë dhe 15 ndërruese të cilat janë mekanike, platforma e stacionit nuk është e shenjëzuar, mungon shenja e ndalimit të trenit në stacion, mirëmbajtja rreth binareve nuk është e mirë, sistemi i sinjalizimit është jashtë funksionit, sistemi i ndriçimit në stacion mungon, shtresa e balastit është e mjaftueshme.


Në këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili ndodhet në dalje të stacionit hekurudhor në Bardh në afërsi të ndërrueses nr10. Vendkalimi në fjalë është i pajisur me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës. Meqenëse në këtë vendkalim ka frekuentim të madh të automjeteve vendkalimi në fjalë duhet të sigurohet me sistem të sinjalizimit me dritë (semafor) ose me rampe mbrojtëse (barrierë).




Në këto dy fotografi shihet ndërruesja mekanike e cila gjendet në stacionin hekurudhor në Bardh, dallëndyshja si dhe jastëkët janë të pajosura, bulonat lidhës në gjendje të mirë teknike.




Në këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet ne fshatin Grabovc rruga 12 qershori, vendkalimi ne fjale është i pajisur me shenja të rrezikut në te dy anët e rrugës, me qenë se në këtë vendkalim frekuentojnë numër i madh i automjeteve ne rekomandojmë qe ky vendkalim te sigurohet me sistem te sinjalizimit apo me rampe mbrojtëse (barrierë).



Në këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet ne fshatin Dritan, ky vendkalim është i pajisur me shenja të rrezikut ne të dy anët e rrugës, dukshmëria ne këtë vendkalim është e kufizuar për shkak te shkurreve dhe barishteve. Me qellim te rritjes se sigurisë ne komunikacion zona afër vendkalimit duhet të pastrohet nga shkurret dhe barishtet sepse e pengojnë dukshmërinë.



Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në Qikatovë të vjetër, vendkalimi në fjale është i siguruar vetëm në njërën anë të rrugës me shenjen STOP, ana tjetër e rrugës siç shihet edhe ne fotografimin e parë është tërësisht e pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut STOP si dhe kryqi i Andreut, afër vendkalimit ka shumë barishtet te cilat e zvogëlojnë dukshmërinë gjate lëvizjes. Me qellim të rritjes së sigurisë për te gjithë pjesëmarrësit ne komunikacion ky vendkalim duhet te pastrohet zona ne afërsi te vendkalimit nga barishtet te pajiset me shenja te rrezikut ne të dy anët e rrugës.



Ne këto dy fotografi shihet vendkalimi në hyrje të Drenasit përballë Ferronikelit, vendkalimi në fjalë është i pajisur me shenja të rrezikut në njërin anë të rrugës, gjendja në afërsi të binareve jo e mirë për shkak të shkurreve dhe barishteve. Meqenëse afër vendkalimit ndodhen objektet e banimit dhe ka frekuentim të madh të automjeteve ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut edhe në anën tjetër të rrugës, si dhe të bëhet pastrimi në afërsi të binareve nga shkurret dhe barishtet.



Ne këto fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në afërsi të hyrjes së stacionit në Drenas përball xhamisë, ky vendkalim nuk ka shenja të rrezikut në asnjërin anë të rrugës, zona në afërsi të binarëve e pa pastër ka shkurreve dhe barishte. Meqenëse në këtë vendkalim frekuentojnë një numër i madh të automjeteve, si dhe objektet e banimit janë afër vendkalimit, ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja të rrezikut apo mundësisht me rampe mbrojtëse barrierë, si dhe të bëhet pastrimi në afërsi të binarëve për shkak se dukshmëria është kufizuar gjatë lëvizjes.

5.2.2.5.4. INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-MITROVICË

Datë: 18.11.2014

Kjo linjë nuk është në shfrytëzim

Gjatë inspektimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Mitrovicë janë inspektuar:

- | | |
|-------------------------|---------------------------|
| ✚ Sinjalizimi | ✚ Bulonat |
| ✚ Traversat | ✚ Binarët |
| ✚ Rampat mbrojtëse | ✚ Dukshmëria |
| ✚ Kalimet në nivel | ✚ Ndriçimi |
| ✚ Platforma e stacionit | ✚ Mirëmbajtja pranë vijës |
| ✚ Balasti | hekurudhore |
| ✚ Ndërrueset | |



Ne këtë fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet ne rrugën Naser Sekiraqa, Në këtë vendkalim mungon shenja STOP në njërën anë të rrugës. Ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja të rrezikut edhe në pjesën tjetër të rrugës aty ku nuk janë te vendosura shenjat e rrezikut.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi cili është legal dhe gjendet ne rrugën Mirenët vendkalimi ne fjale është i pajisur me shenjen afërsi e rrezikut te trenit ndërsa shenja STOP mungon në te dy anët e rrugës. Për shkak të frekuentimit të madh te automjeteve nëpër këtë vendkalim duhet te pajisen me te gjitha shenjat e rrezikut ne të dy anët e rrugës me qellim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit ne komunikacion.



Në këto dy fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në hyrje të stacionit të Obiliqit vendkalimi është i pajisur me të gjitha shenjat e rrezikut si dhe me rampe mbrojtëse (barrierë) në të dy anët e rrugës, mirëpo vendkalimi është jashtë funksionit për arsye të disa defekteve teknike



Në tri fotografit e para shihet gjendja në stacionin hekurudhor të Obiliqit, stacioni në fjalë posedon 6 binare 5 prej tyre janë funksional ndërsa 1 jashtë funksionit, stacioni ka 13 ndërruese automatike funksionale si dhe 4 rrëshqitëse 3 prej tyre funksionale ndërsa 1 jashtë funksionit, stacioni nuk posedon ndriçim, platforma e stacionit është e pa shënjestuar, sistemi i sinjalizimit në gjendje pjesërisht të mirë për arsye se sinjali hyrës nuk funksionon, shenja për ndalimin e trenit në stacion(S) ekziston, siç shihet në fotografi ka mungesë të bulonave në disa vende, po ashtu edhe disa traversa janë të dëmtuara, shtresa e balastit e pa mjaftueshme në disa vende.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi legal në fshatin Plemetin rruga Vidovanska, siç shihet në foto vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës. Me qëllim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, vendkalimi duhet të pajiset me shenja të rrezikut në te dy anët e rrugës.



Në këtë fotografi shihet gjendja e stacionit në Plemetin platforma e pa shënjestuar, pa pastërtia nga shkurret dhe mbeturinat ne afërsi të binarëve. Zona për rreth binarëve duhet të pastrohet nga shkurret dhe mbeturinat.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e urës e cila gjendet në kilometrin (237+900) siç shihet në foto traversat në urë janë të dëmtuara, mungojnë disa bulona të cilët bëjnë lidhjen e binarit me bazamentin e urës.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi në hyrje te stacionit të Prilluzhës vendkalimi është i pajisur me te gjitha shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës, mungon rampa e cila është hequr nga vendkalimi.



Në këto dy fotografi shihet gjendja në stacionin e Prilluzhës, stacioni ka 4 binarë dhe 6 ndërruese që të gjitha funksionale dhe të vajosura, stacioni nuk posedon ndriçim, platforma e stacionit e pa shënjestuar, disa traversa të dëmtuara, ka mungesë të disa bulonave të cilët bëjnë lidhjen në mes binarit dhe traversës.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet fshatin Druar në afërsi të kilometrit (230+800) siç shihet në fotografi vendkalimi është i pajisur me shenjen STOP, dukshmëria e shenjave.



Në këtë fotografi shihet gjendja e stacionit hekurudhor në fshatin Druar siç mund të shihet edhe në foto gjendja në afërsi të binareve nuk është e mirë nga barishtet dhe mbeturinat, shenja kilometrike është në gjendje të mirë, stacioni nuk posedon ndriçim, platforma e stacionit nuk është e shënjestuar, shtresa e balastit e pa mjaftueshme.



Në këto dy fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në hyrje të stacionit hekurudhor të Vushtrrisë vendkalimi është i pajisur me të gjitha shenjat e rrezikut, kryqin e Andreut sinjalizimin me drite dhe me zile rampe mbrojtëse barrierë, por për momentin këto sisteme sinjalizuese të sigurisë në

ketë vendkalim janë jashtë funksionit.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në stacionin e Vushtrrisë, stacioni posedon 4 binarë që të gjithë funksional si dhe 7 ndërruese automatike të gjitha funksionale dhe të vajosura, sistemi i sinjalizimit pjesërisht funksional për arsye se para sinjali dhe sinjali kryesor nuk funksionojnë, platforma e pa shenjezuar, stacioni nuk ka sistem të ndriçimit, shenja për ndalje në stacion (s) ekziston shtresa e balastit jo e mjaftueshme, traversat në gjendje të mirë.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili është ilegal dhe gjendet në afërsi të kilometrit (220+400) vendkalimit i mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës. Propozimi ynë është që ky vendkalim të pajiset me të gjitha shenjat e rrezikut më qëllim të rritjes së sigurisë gjatë lëvizjes.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili është legal dhe gjendet në fshatin Frashër në afërsi të qumështores Aldi, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar i mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës. Propozimi ynë është që ky vendkalim të pajiset me të gjitha shenjat e rrezikut me qëllim të rritjes së sigurisë gjatë lëvizjes.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në hyrje të qytetit të Mitrovicës në afërsi të hotel Lux-it vendkalimi është tërësisht i pa siguruar.



Ky vendkalim i cili është legal dhe gjendet në hyrje të stacionit të Mitrovicës, është i pajisur me të gjitha shenjat e rrezikut si dhe me rampe mbrojtëse (barrierë), por momentalisht këto pajisje sinjalizuese janë jashtë funksionit.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e stacionit hekurudhor të Mitrovicës, stacioni posedon tetë binar pesë prej tyre janë funksional, ndërsa binari gjashtë shtatë dhe tetë janë jashtë funksionit, stacioni ka 19 ndërruese automatike funksionale si dhe 4 rrëshqitëse të gjitha funksionale, stacioni në fjalë nuk posedon ndriçim, platforma e stacionit është e pa shenjzuar sistemi i sinjalizimit është funksionale vetëm në stacion para sinjali dhe sinjali kryesor janë jashtë funksionit, gjendja e traversave në stacione e mirë, shtresa e balastit në stacione e mjaftueshme pastërtia në afërsi të binarëve jo e mirë për shkak të barishteve.

5.2.2.5.5. INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE KLINË-XËRXË-PRIZREN

Datë: 13.10.2014

Kjo linjë nuk është në shfrytëzim

Gjatë inspektimit të linjës hekurudhore Klinë-Xërxë-Prizren janë inspektuar:

- | | |
|-------------------------|---------------------------------------|
| ✚ Sinjalizimi | ✚ Bulonat |
| ✚ Traversat | ✚ Binarët |
| ✚ Rampat mbrojtëse | ✚ Dukshmëria |
| ✚ Kalimet në nivel | ✚ Ndriçimi |
| ✚ Platforma e stacionit | ✚ Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore |
| ✚ Balasti | |
| ✚ Ndërrueset | |



Në këto dy fotografi shihet gjendja ekzistuese e infrastrukturës hekurudhore në linjën e hapur Klinë-Prizren e cila është jashtë funksionit, në figurën e parë shihet gjendja e traversës e cila është shumë e dëmtuar mungojnë bulonat të cilët bëjnë lidhjen e traversës me binarin, në figurën e dytë shihet sistemi i sinjalizimit i cili është jashtë funksionit.



Në këto dy fotografi shihet vendkalimi legal i cili ndodhet në Volljak, vendkalimi në fjalë është i pajisur me kryq të Andreut në njërin anë të rrugës, por shenja është e dëmtuar nga ndryshku, në fotografimin e dytë shihet gjendja në afërsi të binarëve e cila është jo e mirë për shkak të shkurreve dhe barishteve të cilat janë rritur dhe e zvogëlojnë dukshmërinë gjatë lëvizjes. Vendkalimi në fjalë duhet të pajiset me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës si dhe të bëhet pastrimi i zonës në afërsi të binarëve nga shkurret dhe barishtet.



Në fotografi shihet traversa e cila ndodhet afërsisht në kilometrin (10+200) e cila është e dëmtuar i mungon njëri bulon i cili bënë lidhjen e traversës me binarin.




Në fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në kilometrin (10+250) vendkalimi në fjalë është i pajisur me shenja të rrezikut. Më qenë se afër këtij vendkalimi gjendet rruga magjistrale dhe frekuentimi i automjeteve është i madh, ky vendkalim duhet te pajiset me rampe mbrojtëse (barrierë), nëse bëhet aktivizimi i linjës.



Në këto dy fotografi shihet gjendja ekzistuese e infrastrukturës hekurudhore në fshatin Qiflag, në fotografinë e parë shihet vendkalimi i cili është i pajisur vetëm me shenjen STOP, kurse në fotografinë e dytë shihet gjendja e binarëve të cilët është vështirë dallohen nga balta e cila i ka mbuluar pothuajse tërësisht.



Në këto dy fotografi shihet gjendja ekzistuese e infrastrukturës hekurudhore në fotografinë e parë shihen traversat të cilat janë të dëmtuara, si dhe mungesa e bulonave të cilët bëjnë lidhjen në mes traversës dhe binarit në fotografinë e dytë shihet mungesa e bulonave në disa traversa.



Në shihet stacioni hekurudhor i cili gjendet në fshatin Kramovik siç shihet gjendja e infrastrukturës nuk është aspak e mirë, mirëmbajtja në afërsi të binarëve jo e mirë për shkak të shkurreve, stacioni i trenit pjesërisht i demoluar, sistemi i sinjalizimit jashtë funksionit.




Në këtë fotografi e cila gjendet në kilometrin (29+700) shihet gjendja e binarëve dhe traversave të cilat janë të mbuluara nga barishtet, po ashtu vërehet edhe mungesa e balastit



Në këto dy fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në Xërxe në afërsi të kilometrit (34+800) siç shihet në fotografinë e parë vendkalimi është i pajisur me shenja të rrezikut, problem të ky vendkalim paraqet dukshmëria për shkak të rritjes së barishteve në afërsi të vendkalimit, ne raste se kjo linje hekurudhore funksionalizohet ky vendkalim duhet të sigurohet me rampë mbrojtëse (barrierë) për shkak se ka frekuentim të madh të automjeteve.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës në stacionin hekurudhor në Xërxe, gjendja e infrastrukturës në këtë stacion është shumë e rënde duke filluar nga binarët dhe traversat të cilat janë mbuluar me barishte, sistemi i sinjalizimit jashtë funksionit, mungesë të shenjave hektometrike, mungesë e balastit, objekti i stacionit të trenit i demoluar. Në këtë stacion vetëm platforma e stacionit është në gjendje të mire sa i përket infrastrukturës hekurudhore.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në Rahovec vendkalimi është i pajisur me shenja të rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut, më qenë se gjatë inspektimit kemi parë shume automjete te cilat kalojnë përmes këtij vendkalimi, sugjerimi ynë është qe nëse kjo linjë funksionalizohet, ky vendkalim te pajiset më rampë mbrojtëse (barrierë) për shkak të frekuentimit të madh te automjeteve.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në stacionin hekurudhor të Prizrenit, siç shihet edhe në foto gjendja e infrastrukturës nuk është e mirë duke filluar nga binaret dhe traversat të cilat janë të mbuluara me barishte dhe nuk dallohen, sistemi i sinjalizimit i cili është jashtë funksionit, ndriçimi në stacion jashtë funksionit, nuk ka shenjëzime të platformës së stacionit, nuk ka shenjë për ndalim (S) në stacion, shtresa e balastit e pa mjaftueshme. Në këtë stacion vetëm platforma e stacionit është pjesërisht e mirë ndërsa sa i përket elementeve të tjera të infrastrukturës të gjitha janë jashtë funksionit.

5.2.2.5.6. INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PRISHTINË-PODUJEVË

Datë: 16.10.2014

Kjo linjë nuk është në shfrytëzim

Gjatë inspektimit të linjës hekurudhore Prishtinë-Podujevë janë inspektuar;

- | | |
|-------------------------|---------------------------|
| ✚ Sinjalizimi | ✚ Bulonat |
| ✚ Traversat | ✚ Binarët |
| ✚ Rampat mbrojtëse | ✚ Dukshmëria |
| ✚ Kalimet në nivel | ✚ Ndriçimi |
| ✚ Platforma e stacionit | ✚ Mirëmbajtja pranë vijës |
| ✚ Balasti | hekurudhore |
| ✚ Ndërrueset | |



Në këto dy fotografi shihet gjendja ekzistuese e infrastrukturës hekurudhore në dalje të stacionit hekurudhor të Prishtinës, gjendja e infrastrukturës e nuk është e mirë sa i përket mirëmbajtjes, traversat nuk shihen nga balta, në afërsi të binarëve është pa pastërti për shkak të barishteve, shtresa e balastit e pa mjaftueshme.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili ndodhen në Prishtinë afër xhamisë së Llapit vendkalimi është legal dhe është i pa siguruar, gjendja e traversave afër këtij vendkalimi jo e mire për shkak të baltës e cila i ka mbuluar pjesën më të madhe të tyre.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili ndodhet afër xhamisë së Llapit vendkalimi është i pajisur me shenja të rrezikut, mirëpo siç shihet në foto ky vendkalim shfrytëzohet nga tregtarët ku veturat e tyre i ndalojnë mbi binarë. Me ri funksionalizimin e kësaj linje ky vendkalim duhet të pajiset me rampe mbrojtëse me qenë se numri i automjeteve të cilat e frekuentojnë këtë vendkalim është i madh.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në Prishtinë, lagjja Hani i Dilit afër dyqanit Muja Dekor, vendkalimi në fjalë është i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut, për shkak të frekuentimit të madh të automjeteve nëpër këtë vendkalim organet përgjegjëse duhet ta sigurojnë me të gjitha shenjat e rrezikut.



Në këtë fotografi shihet gjendja ekzistuese e hekurudhës e cila nuk është aspak e mire sa i përket pastërtisë traversat janë të mbuluara nga balta, një pjesë e binarëve nuk shihet nga barishtet, objektet e banimit afër hekurudhës.



Në këtë fotografi shihet gjendja e vendkalimit i cili gjendet në Prishtinë përkatësisht te Hani i Dilit, vendkalimi në fjalë nuk ka shenja të rrezikut ne asnjërën anë te rrugës. Më qëllim të rritjes se sigurisë në komunikacion ky vendkalim duhet te pajiset me të gjitha shenjat e rrezikut.



Në këtë fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në Bardhosh siç shihet në fotografi gjendja nuk është aspak e mirë sa i përket pastërtisë binaret janë të mbuluar nga barishtet dhe balta, traversat nuk shihen për shkak se plotësisht janë mbuluar me baltë



Në këtë fotografi shihet ndërruesja e cila gjendet në fshatin Bardhosh ndërruesja në fjalë është e kompletuar, por nuk është funksionale për shkak të mos qarkullimit të mjeteve lëvizëse në këtë linjë.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në fshatin Bardhosh, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar i mungojnë shenjat e rrezikut në te dy anët e rrugës, mirëmbajtja e binarëve në afërsi të këtij vendkalimi nuk është e mirë për shkak të shkurreve dhe barishteve, sistemi i sinjalizimit i cili ndodhet disa metra larg këtij vendkalimi është jashtë funksionit.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në fshatin Lupq vendkalimi në fjalë nuk është i siguruar në asnjërën anë të rrugës e mëtej tjetër e këtij vendkalimi është edhe pastërtia për rreth binareve siç shihet në foto binaret janë të mbuluar nga barishteve dhe me vështirësi mund të dallohen.




Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në fshatin Lluçhan vendkalimi posedon vetëm një shenjë të kryqit të Andreut e cila e ka humbur kuptimin për shkak të dëmtimit dhe ndryshkut. Me ri funksionalizimin et me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës si dhe të pastrohet zona për rreth binarëve.



Në këto fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në fshatin Sibofc, siç shihet edhe në fotografi në këtë vend ka mungesë të binarëve, traversave, bulonave, balastit, shenjave hektometrike, mirëmbajtja pranë binarëve nuk është e mirë për shkak të rritjes së shkurreve dhe barishteve.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në qytetin e Podujevës tek Silosi, siç shihet edhe në fotografi gjendja e infrastrukturës nuk është aspak e mirë për shkak të mbeturinave të hedhura në hekurudhe, traversave të dëmtuara, mungesës së balastit, mungesës së bulonave etj. Dukuri mjaftë



Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në qytetin e Podujevës tek Silosi, siç shihet edhe në fotografi gjendja e infrastrukturës nuk është aspak e mirë për shkak të mbeturinave të hedhura në hekurudhe, traversave të dëmtuara, mungesës së balastit, mungesës së bulonave etj. Dukuri mjaftë shqetësuese kohët e fundit është edhe ndërtimi i objekteve të banimit pranë hekurudhës, këto objekte janë në kundërshtim me Ligjin për Hekurudhat në Republikën e Kosovës.



Dukuri mjaftë shqetësuese kohët e fundit është edhe ndërtimi i objekteve të banimit pranë hekurudhës, këto objekte janë në kundërshtim me Ligjin për Hekurudhat në Republikën e Kosovës.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore në dalje të qytetit të Podujevës, siç shihet në fotografi gjendja e binarëve dhe e traversave nuk është aspak e mirë për shkak të mbulimit me baltë dhe mbeturina, problem tjetër paraqet edhe dukuria e ndërtimit të objekteve të banimit në afërsi të hekurudhës.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e infrastrukturës në qytetin e Podujevës siç shihet në fotografi gjendja e mirëmbajtjes nuk është aspak e mirë për shkak të mbeturinave, barishteve, shkurreve. Në fotografimin e dytë shihet se hekurudha shfrytëzohet si zonë për biznes (shitje të druve).

5.2.2.5.7. INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-HANI I ELEZIT

Datë: 18.09.2014

Gjatë inspektimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit janë inspektuar:

- | | |
|-------------------------|---------------------------------------|
| ✚ Sinjalizimi | ✚ Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore |
| ✚ Traversat | ✚ Urat |
| ✚ Rampat mbrojtëse | ✚ Tunelet |
| ✚ Kalimet në nivel | ✚ Dukshmëria |
| ✚ Platforma e stacionit | ✚ Ndërrueset |
| ✚ Balasti | ✚ Bulonat |
| ✚ Ndriçimi | ✚ Binarët |



Ne këtë fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në kilometrin (255+200) vendkalimi në fjalë është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut në të dy anët e rrugës. Më qëllim të rritjes së sigurisë gjatë lëvizjes së trenit ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës.




Ne fotografimin e dytë shihet vendkalimi legal i cili gjendet në kilometrin (258+300) vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacion ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja të rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut në të dy anët e rrugës.



Ne këto fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në kilometrin (259+00) vendkalimi në fjalë është i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut në të dy anët e rrugës, me qëllim të parandalimit të ndonjë aksidenti në komunikacion ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës.



Ne këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në afërsi të hyrjes së stacionit hekurudhor të Lipjanit, vendkalimi në fjalë është i pajisur me të gjitha shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës STOP, kryqi i Andreut, sistemi i sinjalizimit, rampe mbrojtëse (barrierë), ky vendkalim i plotëson të gjitha parametrat e sigurisë për qarkullim të sigurt gjatë lëvizjes së trenit.




Ne këto tri fotografi shihet gjendja ekzistuese në dalje të stacionit të Lipjanit, siç shihet edhe në fotografi sistemi i sinjalizimit është funksional, elementet përbërëse të ndërrueses janë të pa vajosura (jastëkët si dhe dallëndyshja) në fotografin e tretë shihet vendkalimi i cili i plotëson parametrat e sigurisë, vendkalimi në fjalë është i sigurt me shenja të rrezikut si dhe me rampe mbrojtëse (barrierë).

Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në kilometrin (263+700) vendkalimi në fjalë është i sigurt vetëm në njërin anë të rrugës me shenjat e rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut, me qëllim të rritjes së sigurisë gjatë lëvizjes së trenit, ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja të rrezikut edhe në pjesën tjetër të rrugës.



Në këtë foto shihet vendkalimi legal i cili gjendet në kilometrin (264+550), vendkalimi është tërësisht i pa sigurt mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, pastërtia afër binareve nuk është e mirë për shkak të rritjes së barishteve ky vendkalim duhet pastrohet nga barishtet dhe të pajiset me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës.



Në këto foto shihet gjendja ekzistuese e stacioni hekurudhor në Bablak, siç shihet në fotografi sistemi i sinjalizimit është funksional shtresa e balastit është e mjaftueshme, platforma e stacionit nuk është e shenjëzuar, në stacionin ekzistojnë katër (4) ndërruese automatike një (1) e thjeshte si dhe dy (2) rrëshqitëse automatike dhe një (1) e thjeshtë elementet përbërëse të ndërruesve janë të vajosura shenja për ndalimin e trenit (S) ekziston në stacion ekziston.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në kilometrin (272+850) vendkalimi në fjalë është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës. Ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës.



Ne këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në kilometrin (275+220) vendkalimi në fjalë është i siguruar vetëm në një anë të rrugës me kryqin e Andreut i cili është mjaft i dëmtuar nga ndryshku me qellim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit e komunikacionit ky vendkalim duhet të pajiset me të gjitha shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës.



Ne këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në kilometrin (277+990) vendkalimi është i siguar me shenja të rrezikut STOP dhe kryqi i Andreut vetëm në një anë të rrugës, dukshmëria afër vendkalimit është e kufizuar për shkak të barishteve. Ky vendkalim lidhë disa zona të banimit dhe paraqet rrezik për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, vendkalimi në fjalë duhet të sigurohet edhe në anën tjetër të rrugës me shenja të rrezikut.



Ne këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në afërsi të palestrës sportive Bill Clinton në Ferizaj, vendkalimi në fjalë është tërësisht i pa siguar, më qenë se vendkalimi ndodhet në qytet dhe numri i frekuentimit të automjeteve është i madhe vendkalimi në fjalë duhet të sigurohet me të gjitha shenjat e rrezikut.



Ne këtë foto shihet vendkalimi i cili gjendet në hyrje të qytetit të Ferizajt, siç shihet edhe në fotografi frekuentimi i automjeteve për gjatë këtij vendkalimi është i madh por nuk paraqet problem sepse është i siguar me të gjitha shenjat e rrezikut si dhe me rampe mbrojtëse (barrierë), vendkalimi në fjalë i plotëson të gjitha parametrat e sigurisë për qarkullim të sigurt.



Në këto fotografi shihet gjendja ekzistuese në stacionin hekurudhor në Ferizaj, shenjat sinjalizuese janë funksionale platforma e stacionit e pa shenjejuar, shenja për ndalimin e trenit në stacion(S) ekziston, shtresa e balastit e mjaftueshme, traversat në gjendje të mirë, elementet përbërëse të ndërrueses jastëkët dhe dallëndyshja të vajosura, pastërtia për rreth binarëve jo e mirë.



Ne këtë fotografi shihet vendkalimi në dalje të qytetit të Ferizajt, siç shihet në fotografi vendkalimi është i pajisur me të gjitha shenjat e rrezikut me sinjalizim me dritë, kryq të Andreut, afërsi e rrezikut si dhe me rampë mbrojtëse (barrierë), vendkalimi në fjalë i plotëson të gjitha kushtet e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi ilegal i cili gjendet në hyrje të stacionit në Gurëz, vendkalimi në fjalë është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, me qenë se vendkalimi ndodhet afër hyrjes së stacionit hekurudhor dhe paraqet rrezik për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, ky vendkalim duhet të pajiset me shenja e rrezikut në të dy anët e rrugës.



Në këto tre foto shihet gjendja në stacionin hekurudhor Gurëz, siç shihet edhe në fotografi sistemi i sinjalizimit është funksional, platforma e stacionit është e pa shenjëzuar elementet përbërëse të ndërrueses jastëkët dhe dallëndyshja janë te vajosura, shenja për ndalimin e trenit në stacion (S) ekziston shtresa e balastit e mjaftueshme traversat në gjendje të mirë, bulonat të cilët bëjnë lidhjen në mes të traversës dhe binarit mungojnë në disa vende.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi i cili gjendet në kilometrin (289+710) vendkalimi është i pajisur në të dy anët e rrugës me kryq të Andreut që është i dëmtuar nga ndryshku, mungon shenja e STOP dukshmëria është e kufizuar për shkak të barishteve të cilat janë afër vendkalimit.



Në këtë fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet në kilometrin (292+710) vendkalimi në fjalë është i siguruar vetëm me shenjen e kryqit të Andreut në njërin anë të rrugës, me qenë se ky vendkalim lidhë disa zona të banimit dhe qarkullimi i automjeteve nëpër këtë vendkalim është i pa shmangshëm, ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut edhe në anën tjetër të rrugës.



Në këto dy fotografi shihet gjendja e urave e cila është njëjtë te shumica e urave në këtë linje, siç shihet në fotografi ura ka mbrojtëse anësore në të dy anët, traversat në gjendje të mirë teknike, gjendja statike e urës e mirë, ura posedon vetëm një rrugë për këmbësor, në fotografin e dyte shihet se disa bulona të cilët bëjnë lidhjen në mes traversës dhe binarit mungojnë, te disa ura ka mungesë të bulonave të cilët bëjnë lidhjen e traversës me bazamentin e urës.



Në këto dy fotografi shihet tuneli i Rumevës, gjendja e tunelit nuk është e mirë për shkak se në tunel ka rrjedhje të ujit, materiali ndërtues në njërin anë në brendi të tunelit ka filluar të bie, tuneli ka mungesë të ndriçimi. Në stinën e dimrit nga rrjedhja e ujit formohet shtresa e akullit dhe mund të paraqet rrezik gjatë lëvizjes së trenit. Me qëllim të rritjes së sigurisë gjatë lëvizjes së trenit ky tunel duhet të izolohet rrjedhja e ujit.

5.2.2.5.8. INSPEKTIMI I LINJËS HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-PRISHTINË

Datë: 16.07.2014

Gjatë inspektimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Prishtinë janë inspektuar

- | | |
|-------------------------|---------------------------|
| ✚ Sinjalizimi | ✚ Bulonat |
| ✚ Traversat | ✚ Binarët |
| ✚ Rampat mbrojtëse | ✚ Dukshmëria |
| ✚ Kalimet në nivel | ✚ Ndriçimi |
| ✚ Platforma e stacionit | ✚ Mirëmbajtja pranë vijës |
| ✚ Balasti | hekurudhore |
| ✚ Ndërrueset | |



Në këtë foto shihet shenja sinjalizuese (përfundim i shpejtësisë së kufizuar), e cila gjendet në dalje të stacionit të Fushë Kosovës në drejtim të Prishtinës, ngjyrat e tabelës sinjalizuese në masë të madhe janë të dëmtuara nga korrozioni dhe kjo e vështirëson kuptimin domethënës të shenjës.



Në këtë foto shihet shenja sinjalizuese (fillimi i shpejtësisë së kufizuar), e cila gjendet në hyrje të stacionit të Fushë Kosovës, dukshmëria e shenjës nuk është e mirë për shkak të barishteve në afërsi të shenjës.



Në këto foto shihet gjendja ekzistuese në këtë pjesë të linjës hekurudhore Prishtinë- Fushë Kosovë dukshmëria përgjatë vijës hekurudhore e mire, shtresa e balastit është e mjaftueshme, bulonat lidhës te binarit me traversa në gjendje të mire, traversat në gjendje të mire.



Në stacionin hekurudhor të Fushë Kosovës ekzistojnë gjithsejtë 12 binarë, funksionalë vetëm 6 prej tyre, ndërsa sa i përket ndërruesve nga hyrja e stacionit të Fushë-Kosovës deri në dalje të stacionit në drejtim të Pejës janë gjithsejtë 42 ndërruese. Në foto shihen disa pjesë të ndërruesve në hyrje të stacionit në Fushë Kosovë. Pjesët e ndërrueses janë të vajosura në foto shihet dallëndyshja e ndërrueses e cila është e vajosur, në foton e dytë shihen jastëkët e ndërrueses të cilët po ashtu janë të vajosur. Çdo ndërruese i posedonte nga dy çelësa dorezat e ndërruesve në gjendje të rregullt, mekanizmi i ndërrueses në gjendje të rregullt.



Në këto foto shihet shenja sinjalizuese e cila është e vendosur para vendkalimit të siguar me rampë automatike si dhe me shenjat e tjera të rrezikut në hyrje të stacionit hekurudhor të Fushë Kosovës, dritat sinjalizuese të sinjalit janë të dobëta dhe mezi vërehen nga pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, zilha e shenjës sinjalizuese është jashtë funksionit.



Në foto nr. 9 që gjendet afër (shenjës hektometrike nr. 8) siç shihet për shkak të traversës së dëmtuar janë liruar bulonat, fakt ky që mund të paraqesë rrezik për një lëvizje të sigurve të trenit në këtë pjesë.



Në këto foto shihet platforma e stacionit në Fushë Kosovë e cila është në gjendje relativisht të mirë sa i përket mirëmbajtjes, ndërsa sa i përket ndriçimit stacioni nuk ka ndriçim, orari i lëvizjes së trenave nuk është i ekspozuar në stacion, sistemi i zërimit (lajmërimit) për arritjen e trenit është jashtë funksionit, qasja e personave me aftësi të kufizuar në stacion është e vështirësuar dhe platforma nuk është e shenjësuar (pjesa ndarëse që tregon se udhëtarët nuk mund të afrohen te vija ndarëse ndërmjet platformës dhe binarëve).



Ne këto foto shihen shenjat sinjalizuese të cilat nuk janë funksionale, në foton e dytë po ashtu shihet edhe gjendja jo e mirë në afërsi të hekurudhës.



Ne këto foto shihet gjendja ekzistuese para vendkalimit që gjendet në rrugën Fehmi Lladrovci, vendkalimi është i pajisur me shenja vertikale të rrezikut (stop, afërsia e vendkalimit të trenit). Meqëse në këtë vendkalim frekuentojnë një numër i madh i automjeteve dhe paraqet rrezik, ky vendkalim duhet të pajiset me rampë mbrojtëse (barriere).



Ne këto dy foto shihet se vendkalimi i cili gjendet pranë rrugës Naser Sekiraqa, është i pajisur me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës. Meqëse vendkalimi në fjalë ndodhet afër vendbanimeve dhe paraqet rrezik për pjesëmarrësit e tjerë të komunikacionit, vendkalimi mundësisht duhet të pajiset me rampe mbrojtëse (barriere).



Ne këto foto shihet vendkalimi afër rrugës Hajrullah Zymi, i cili është i pajisur në një anë të rrugës me shenjë vertikale "afërsi e vendkalimit" të trenit, kurse në pjesën tjetër të rrugës nuk ka shenja të rrezikut që tregon afërsinë e vendkalimit të trenit, po ashtu afër vendkalimit dukshmëria e shenjës është e kufizuar për shkak të rrëzës në afërsi të vendkalimit. Duke marrë parasysh se në këtë vendkalim ka qarkullim të automjeteve, ky vendkalim duhet të sigurohet me shenja të rrezikut në të dy anët e rrugës si dhe mundësisht me rampë mbrojtëse (barriere).



Në këto foto shihet vendkalimi ilegal i cili është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës, mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore nuk është e mire për shkak të barishteve në afërsi të hekurudhës. Ky vendkalim ilegal duhet të sigurohet me shenja vertikale të rrezikut në të dy anët e rrugës dhe të mirëmbahet.



Në këto foto shihet vendkalimi i cili gjendet afër zonës industriale, dukshmëria e zvogëluar për shkak të barishteve afër vendkalimit, në anën e epërme dukshmëria e zvogëluar për shkak të objektit në afërsi të vendkalimit, shenjat e rrezikut janë të vendosura në të gjitha anët e rrugës. Me qenë se ky vendkalim është shumë i frekuentuar nga automjetet, vendkalimi duhet të sigurohet me rampë mbrojtëse (barrierë).

5.2.2.5.9. INSPEKTIM I TERMINALIT DOGANOR NË MIRADI

Datë: 05/09/2014

Gjatë inspektimit në terminalin doganor në Miradi janë inspektuar:

- ✚ Sinjalizimi
- ✚ Traversat
- ✚ Platforma e stacionit
- ✚ Balasti
- ✚ Ndërrueset
- ✚ Bulonat

- ✚ Binarët
- ✚ Dukshmëria
- ✚ Ndriçimi
- ✚ Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore

Disa të dhëna për terminalin hekurudhor në Miradi

Stacioni hekurudhor ne Miradi përbëhet nga 13 binarë, blloku 1 përbëhet prej një binari nxjerrës dhe prej 22 ndërruesve, 5 ndërruese janë te tipit anglez ndërsa te tjerat janë te thjeshta, blloku 2 përbëhet nga 2 binarëve nxjerrës te cilët nuk janë ne përdorim, blloku ne fjale përbëhet prej 25 ndërruesve 4 janë te tipit anglez te tjerat janë te thjeshta. Binari i parë është për kalimin e trenave te udhëtarëve ndërsa 4 binarë janë për pranimin e trenave te mallrave. Me terminalin e mallrave në Miradi janë të lidhur 5 binare industrial të katër kompanive te derivateve siç janë: Petrol Copmany, Standard Plin, Patroni Company, Bytyçi Company dhe Al Petroll. Gjatësia e binareve ne B1 është 1700 metra ne B2 është 1602 metra. Ne stacionin hekurudhore ne Miradi ndriçimi nuk është funksional, disa ndërruese



Në këtë fotografi shihet makina cila kryen ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave qe transportohen përmes transportit hekurudhor, kapaciteti i kësaj makine për ngarkim shkarkim te kontejnerëve është 35 ton.



Në këto dy fotografi shihen ndërrueset, ne fotografën e pare shihen elementet e ndërrueses jastëkët dhe dallëndyshja te cilat janë te vajosura, mekanizmi i ndërrueses ne gjendje te mire teknike, bulonat te cilët bëjnë lidhjen ne mes te binareve dhe traversave ne gjendje te mire, po ashtu, ne fotografën e dytë shihet ndërruesja e cila lidhë disa binarë, ndërrueses në fjalë i mungon shenja reflektuese, traversat te cilat shihen ne afërsi te ndërrueses janë ne gjendje pjesërisht të mire.



Në këto dy fotografi shihen shenjat sinjalizuese, ne fotografën e parë shihet shenja e cila tregon ngritjen dhe rënien e nivelit të hekurudhës e cila e ka humb kuptimin e domethënies për shkak të fshirjes, ne fotografën e dytë shihet shenja sinjalizuese kufizim i shpejtisë së lëvizjes. Shenja e cila tregon ngritje dhe rënien e nivelit të hekurudhës duhet të zëvendësohet me shenje dhe domethënie të njëjta, ndërsa tek shenja kufizim i shpejtisë së lëvizjes duhet të pastrohet zona afër shenjës me qellim që dukshmëria e shenjës të jetë më e mirë.



Në fotografinë e parë shihet rrëshqitësja e binareve, kurse në fotografën e dytë shihet shenja sinjalizuese manovrimi i ndaluar (tabela sinjalizuese e kaltër me skaj të bardhë në pozite vertikale) e cila për momentin është jashtë funksionit.

5.3. DEPARTAMENTI I INTEROPERABILITETIT

Ky është raporti i tretë mbi Interoperabilitetin hekurudhor. Ai mbulon të dhëna për vitin 2014 në formë të përmbledhur, të aktiviteteve dhe rezultateve që Departamenti i Interoperabilitetit brenda ARH-së ka zhvilluar për këtë periudhë.

Interoperabiliteti

Interoperabiliteti është një iniciativë e Bashkimit Evropian për promovimin e një tregu të vetëm në sektorin hekurudhor. Kjo iniciativë evropiane është e dizajnuar për të përmirësuar pozitën konkurruese të sektorit hekurudhor, kështu që ajo të mund të konkurrojë në mënyrë më efektive me format e tjera të transportit. Këtë e bënë përmes një kuadri rregullator që nxit harmonizimin teknik dhe standardizimin e hekurudhave të Evropës.

Parashikon standartet e përbashkëta teknike të quajtura Specifikime Teknike për Interoperabilitet STI, që të aplikohen në të gjithë sistemin hekurudhor brenda dhe jashtë Kosovës

5.3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta, departamenti udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-63 dhe sipas Dispozitave të Direktivës 2008/57/EC për Interoperabilitet dhe Direktivës 2004/49/EC për Siguri.

Si Departament brenda ARH-së është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova.

Kushtet në lidhje me interoperabilitetin përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit e gjithashtu edhe kualifikimeve profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon në operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

Departamenti ka për detyrë të hartojë legjislacionin sekondar në fushën e Interoperabilitetit hekurudhor i cili duhet të jetë në përputhje me standardet dhe rregullat evropiane të përcaktuara nga Direktivat për Interoperabilitet.

5.3.2. Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit

Legjislacioni në fuqi kërkon:

Harmonizimin e legjislacionit, rregullave dhe të standardeve në sektorin hekurudhor me ato të BE-së të përshtatshme për Kosovën.

Janë këto aktivitete të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar në vazhdim të këtij raporti:

5.3.2.1. Miratimi i Rregullores 01/2014 Modeli i Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor

Me të gjitha përgatitjet të cilat ishin realizuar në fund të vitit 2013, në fillim të vitit 2014 Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton Rregulloren Nr. 01/2014 „Modeli i deklaratës së konformitetit për llojin e autorizuar të mjetit lëvizës,” përgatitur nga Departamenti për Interoperabilitet.

Qëllimi i Rregullores ishte që të paraqes procedurat për modelin e Deklaratës së Konformitetit për llojin e autorizuar të mjetit lëvizës hekurudhor, duke marrë parasysh Ligjin për Hekurudhat e Kosovës neni 110 (3) dhe Direktivën 2008/57/EC për Interoperabilitet, nenit 26 (3).

Kjo rregullore është konform rregullores së BE-së Nr. 201/2011 „Për modelin e Deklaratës së Konformitetit për llojin e autorizuar të mjetit lëvizës,”

Rregullorja në fjale do t’iu mundësojë aplikuesve që mjetit të konfirmuar të transportit i cili e ka autorizimin, t’i jepet autorizimi për futje në shërbim duke u bazuar në Deklaratën e Konformitetit mbi tipin pa kontrollime të mëtutjeshme.

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë Operatorët Hekurudhorë dhe Menaxherët e Infrastrukturës në Republikën e Kosovës të cilët kanë për qëllim autorizimin për futje në shërbim të mjeteve të reja hekurudhore, lloji i të cilave është i autorizuar në një shtet anëtar të BE-së dhe në shtetet tjera me të cilat Kosova ka marrëveshje të veçanta.

5.3.2.2. Autorizimet për futje në shërbim të nënsistemeve strukturale konform kërkesave për interoperabilitet

ARH-ja është përgjegjëse për të gjitha vlerësimet dhe analizat e Interoperabilitetit në Kosovë dhe kërkesave të tjera të cilat kanë të bëjnë me futjen në shërbim, përmirësimin, renovimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit.

Brenda vitit 2014 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ka pranuar kërkesë nga INFRAKOS për autorizim për futje në shërbim për mjetin e mirëmbajtjes Plaser 08-16 SH. Departamenti i Interoperabilitetit i thirrur për t'i definuar kushtet për interoperabilitet pranon aplikacionin e mjetit Plaser për autorizim për futjen në shërbim për të shqyrtuar dhe vlerësuar nëse mjeti në fjale është konform kërkesave për Interoperabilitet. Brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj ka zhvilluar shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për pjesën e Interoperabilitetit për mjetin e mirëmbajtjes në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-63 dhe Direktivën 2008/57/EC për Interoperabilitet. Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit më datë 30/01/2014 bëhet njoftimi zyrtarë mbi pranimin e mjetit të mirëmbajtjes të tipit Plaser.

Një vlerësim ndërmjet mjeteve transportuese me kërkesat për interoperabilitet është një kontribut drejtë krijimit progresiv hekurudhorë në pajisje dhe shërbime që qojnë drejtë funksionimit të sistemit dhe nënsistemeve hekurudhore drejt ndër-operabilitetit.

5.3.2.3. Regjistrimi i mjeteve lëvizëse

Sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, neni 28 paragrafi 7, ARH respektivisht Organin për Interoperabilitet është përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovës dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshtetur në ligj, sikurse neni 18 paragrafi 3.6 që obligon ARH për mbikëqyrje se a janë regjistruar mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar.

ARH brenda vitit 2014 ka realizuar regjistrimin dhe ri-regjistrimin e një numri të konsiderueshëm të mjeteve lëvizëse nga Menaxheri i Infrastrukturës INFRAKOS dhe Operatori me Trena TRAINKOS. Mjetet e regjistruara dhe ri-regjistruara i janë bashkangjitur Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR) realizuar në vitin 2012.

Me datë: 06/12/2014 në Departamentin e Interoperabilitetit është pranuar aplikacioni për regjistrimin e mjetit të mirëmbajtjes Plaser 08-16-SH nga INFRAKOS, ndërsa me datë: 07/02/2014 i është konfirmuar Menaxherit të Infrastrukturës -INFRAKOS-it pranimi i aplikacionit për regjistrim .

Pas shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim më datë: 12/02/2014 njoftohet zyrtarisht INFRAKOS, se aplikimi i tyre për regjistrim të mjetit të mirëmbajtjes me numër evropian : 99 00 9428 008-0 është i pranuar nga Departamenti i Interoperabilitetit dhe është pjese e regjistrit Nacional të Mjeteve lëvizëse NVR. Regjistrimi i mjetit Plaser është realizuar pas marrjes se autorizimit për futje në shërbim nga ARH.

Gjithashtu brenda vitit 2014 në Departamentin e Interoperabilitetit janë pranuar aplikacionet për ri-regjistrim të 25 mjeteve hekurudhore nga Operatori me Trena – TRAINKOS pas marrjes se autorizimeve për futje në shërbim.

Më datë: 25/03/2014 pranohen në ARH aplikacionet për ri-regjistrimin e 9 lokomotivave, 2 lokomotivave manovruese, 2 trenave motorik dhe 9 vagonë të udhëtareve, mjete hekurudhore të cilat ishin pajisur me autorizim për futje në shërbim nga ARH. Më datë: 26/03/2014 i është konfirmuar TRAINKOS-it pranimi i aplikacioneve për mjetet për të cilat kanë aplikuar.

Më datë: 23/04/2014 në ARH janë pranuar gjithashtu edhe 4 aplikacione për ri-regjistrim për mjete të cilat kanë pësuar riparim gjeneral dhe të mesëm. Më datë: 24/04/2014 konfirmojmë pranimin e aplikacioneve për ri-regjistrim nga TRAINKOS për mjetet lëvizëse të lartcekura.

Ri-regjistrimeve iu nënshtruan këto mjete hekurudhore të paraqitura në formë tabelore:

Tabela 1: Lokomotivat e ri-regjistruara

Numri rendor	Mjeti lëvizës	Numri evropian
1	Lokomotivë	92 00 2640 001-9
2	Lokomotivë	92 00 2640 002-7
3	Lokomotivë	92 00 2640 003-5
4	Lokomotivë	92 00 2640 004-3
5	Lokomotivë	92 00 2620 005-4
6	Lokomotivë	92 00 2640 006-8
7	Lokomotivë	92 00 2640 007-6
8	Lokomotivë	92 00 2640 008-4
9	Lokomotivë	92 00 2710 009-7
10	Lokomotivë	92 00 2640 010-0

Tabela 2: Lokomotivat manovruese të ri-regjistruara

Numri rendor	Mjeti lëvizës	Numri evropian
1	Lokomotivë manovruese	92 00 2760 001-3
2	Lokomotivë manovruese	92 00 2760 002-1

Tabela 3: Trenat motorik të ri-regjistruar

Numri rendor	Tren Motorik	Numri evropian
1	Tren motorik	95 00 5800 001-5
2	Tren motorik	95 00 5800 002-3
3	Tren motorik	95 00 5800 003-1
4	Tren motorik	95 00 5800 004-9

Tabela 4: Vagonët e udhëtareve të ri-regjistruar

Numri rendor	Vagonë udhëtarësh	Numri evropian
1	Vagonë udhëtarësh	92 00 2640 001-9
2	Vagonë udhëtarësh	92 00 2640 002-7
3	Vagonë udhëtarësh	92 00 2640 003-5
4	Vagonë udhëtarësh	92 00 2640 004-3
5	Vagonë udhëtarësh	92 00 2620 005-4
6	Vagonë udhëtarësh	92 00 2640 006-8
7	Vagonë udhëtarësh	92 00 2640 007-6
8	Vagonë udhëtarësh	92 00 2640 008-4
9	Vagonë udhëtarësh	92 00 2710 009-7

Departamenti i Interoperabilitetit ka shqyrtuar të gjithë formularët e regjistrimit konform legjislacionit në fuqi dhe në afat kohore të përcaktuar në rregulloren e regjistrimit Nr. 05/2012.

Gjithashtu një bashkëpunim konstruktiv në mes ARH-se dhe kompanive (TRAINKOS dhe INFRAKOS) ka ndihmuar që i gjithë regjistrimi të realizohet me sukses, duke kontribuar që implementimi i Rregullores 05/2014 të realizohet në mase të kënaqshme e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Regjistrimi i mjeteve lëvizëse duke përfshirë „Modifikimet (ri-regjistrimet)„ dhe „Tërheqjet„ rregullohet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, Direktivën për Interoperabilitet 2008/57/EC dhe Rregulloren 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse miratuar nga ARH.

Pas shqyrtimit të të gjitha aplikacioneve TRAINKOS njoftohet zyrtarisht nga ARH-ja se aplikimet për ri-regjistrim të dhjetë (10) Lokomotivave, dy (2) Lokomotivave Manovruese, dy (2) Trenave motorik dhe nëntë (9) vagonë të udhëtareve është i pranueshëm nga ARH.

Më datë: 05/08/2014 njoftohet TRAINKOS se aplikimet e tyre për regjistrimin e Lokomotivave është i pranueshëm nga ARH

Më datë: 25/04/2014 njoftohet TRAINKOS se aplikimet për regjistrimin e Lokomotivave Manovruese është i pranueshëm nga ARH.

Më datë: 11/04/2014 njoftohet TRAINKOS se aplikimet për regjistrimin e Vagonëve të Udhëtareve është i pranueshëm nga ARH.

Më datë: 18/04/2014 njoftohet TRAINKOS se aplikimet e tyre për regjistrimin e Trenave Motorik është i pranueshëm nga ARH

5.3.2.4. Marrëveshjet kontraktuale

Departamenti për Interoperabilitet, në mënyrë që ti vlerësoj kushtet për interoperabilitet kërkon informacion nga Menaxheri i Infrastruktues dhe Operatori me Trena rreth marrëveshjeve kontraktuale mbi operimin dhe mirëmbajtjen brenda dhe jashtë vendit me institucionet/kompani tjera hekurudhore.

Më datë 16/09/2014 ARH zyrtarisht kërkon nga INFRAKOS listën e marrëveshjeve kontraktuale mbi operimin dhe mirëmbajtjen që INFRAKOS ka për operime brenda dhe jashtë vendit me institucionet/kompanitë tjera hekurudhore. Gjithashtu më datë: 19/09/2014 nga TRAINKOS kërkohet zyrtarisht marrëveshjet kontraktuale me institucionet/kompanitë hekurudhore brenda dhe jashtë vendi.



Më datë 25/09/2014 pranohet në ARH lista e marrëveshjeve të kërkuara nga Menaxheri i Infrastrukturës INFRAKOS që kryesisht përbëhet prej marrëveshjeve të realizuara me kompani vendore dhe me Maqedoninë.



Më datë: 23/09/2014 pranohet lista e marrëveshjeve kontraktuale nga TRAINKOS që gjithashtu përbëhet kryesisht me kompani vendore dhe Maqedoninë.

Nga të gjitha këto marrëveshje del që Menaxheri i Infrastrukturës -INFRAKOS dhe Operatori me Trena-TRAINKOS sa i përket operimit dhe mirëmbajtjes përveç marrëveshjeve me institucionet brenda vendit dhe Maqedoninë nuk posedojnë marrëveshje kontraktuale të tilla me vende të tjera. Marrëveshjet me Maqedoninë të finalizuara apo ato në prag të finalizimit konsiderohen si rrjedhojë e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar të nënshkruar më datë: 15/09/2011 dhe të ratifikuar nga Presidentja e Kosovës me datë 07/10/2011 .

5.3.2.5. Plani i implementimit për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet STI

Mandati ligjor i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, në nenin 28(1) të Ligjit për Hekurudha thekson se: Kosova ka për qëllim që të jetë pjesë e zonës Evropiane të Interoperabilitetit hekurudhor, gjë që do të thotë se sistemi hekurudhor i Kosovës duhet t'i plotësoj kushtet për interoperabilitet siç janë definuar në zonën Evropiane hekurudhore.

Është obligim ligjor që të gjitha nënsistemet hekurudhore duhet të jenë në përputhje me STI në fuqi në kohën e vendosjes së tyre shërbim, përmirësimin ose rinovimin. Si rrjedhojë u pa e nevojshme dhe e domosdoshme hartimi i një plani implementues për t'i dhënë qartësi dhe kuptim të përgjithësuar të gjitha STI-ve për të gjitha nënsistemet.

Qëllimi i planit të implementimit është të ndihmojë për të kuptuar dhe si rrjedhojë për të zbatuar STI në fuqi nga aktet e sektorit hekurudhor. Audienca e synuar përfshin autoritetet rregullatore dhe të gjithë aktet, si Ndërmarrjet Hekurudhore (NH), Menaxherët e Infrastrukturës (MI), prodhuesit, ofruesit e shërbimeve të mirëmbajtjes, entet e kontraktuara dhe Organet Njoftuese (OrNjo).

Ky plan ofron informacion për implementimin e Specifikimeve Teknike për Interoperabilitetin (STI) për sistemin hekurudhore të zakonshëm (konvencional).

Plani i implementimit do të shërbejë si mjet qartësues i obligimeve që janë të detyrueshme me ligj për t'u zbatuar dhe për tu ndjekur. Plani ofron shpjegime për dispozitat e përfshira në STI dhe duhet të jetë udhëzues për të kuptuar qasjet dhe rregullat që përshkruhen në to.



Më datë: 04/09/2014 Departamenti i Interoperabilitetit me sukses ka arritur që të hartoj dhe përfundoj Planin e Implementimit për STI i cili ka bazë ligjore Ligjin për Hekurudha, Direktivën e Interoperabilitetit dhe Vendimet e STI-ve.

Plani i Implementimit për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet është i disponueshëm në ueb faqen e ARH: www.arh-ks.org

5.3.2.6. Specifikimet Teknike për Interoperabilitet STI

Vendimit 2011/275/EU CR TSI „Infrastruktura „

Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet janë përgatitur dhe lëshuar në nivel të BE-së, në mënyrë që të përgatitet Hapësira Unike Hekurudhore dhe si të tilla duhet të paraqesin bazën kryesore të sigurisë hekurudhore në Kosovë.

Sipas Ligjit për Hekurudha për secilin nënsistem hekurudhorë, Specifikacionet Teknike të Interoperabilitetit në Kosovë duhet të lëshohen nga ARH-ja dhe duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale e në veçanti kërkesat e sigurisë.

ARH përgjegjëse për fushën e Interoperabilitetit e obliguar për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të tij kundrejt Ligjit, brenda vitit 2014 me angazhim arrin që të jetë në fazën e fundit të procesit të Adoptimit të Vendimit 2011/275/EU CR STI për Infrastrukturë. Në mungesë të Bordit, ARH-ja nuk ka mundur të miratojë adoptimin e këtij Vendimi. STI do të ketë rol integruar të sistemit tonë hekurudhore në atë të BE-së, meqë lehtësojnë tranzicionin nga sistemet e vjetra kombëtare hekurudhore të integruara, të cilat qeveriseshin kryesisht nga rregulla kombëtare në një zonë hekurudhore të përbashkët Europiane që qeveriset kryesisht nga rregullat e përbashkëta të BE-së. STI për infrastrukturë specifikon *'kushtet që duhen plotësuar për të arritur interoperabilitet'* dhe duhet konsideruar si një përkufizim i 'nivelet maksimal të harmonizimit teknik'

Ne synojmë të jemi pjesë e BE-së, prandaj transpozimi i legjislacionit hekurudhorë të Bashkimit Evropian (STI) të përshtatshëm për sektorin e hekurudhave në Kosovë është një avantazh për ti përmbushur obligimet kundrejt Ligjit për Hekurudhat e Kosoves, njëkohësisht edhe obligimeve ndaj BE-së si kusht për t'iu bashkuar familjes Evropiane.

Ne konsiderojmë që një veprim i tillë duke i vlerësuar rregulloret evropiane si model referimi, do të ndihmonte për ta vendosur sistemin hekurudhorë në një pozicion të qëndrueshëm dhe të sigurt.

Në dhjetor të vitit 2014 Departamenti për Interoperabilitet arrin që ta përfundoj draftin përfundimtar të Vendimit 2011/275/EU CR STI për Infrastrukturë

Në forme tabelore do të paraqesim STI të miratuara nga ARH dhe STI në nivel të BE-së:

Tabela 5: STI të miratuara nga ARH

Statusi	Numri	Nënsistemi	Dt: e miratimit
Vendim	2011/291/EU	Lokomotiva & mj.pasagjer	11/12/2013
Vendim	2011/275/EU	Infrastruktura	--

Vendimi 2011/275/EU CR TSI do të jetë i disponueshëm në ueb faqen e ARH-se kur edhe do të jetë miratuar (www.arh.ks.org) me qëllim që të ndihmojë akterët në zbatimin e kësaj STI

Tabela68: Statusi i STI në nivel të BE-së

1.STI strukturale dhe amendamentimet e tyre ndër vite (Janar 2015)

Viti	INF		ENE		STI SRT	STI PRM	RST				CCS		Viti
	HS STI INF	CR STI INF	HS STI ENE	CR STI ENE			HS STI RST	CR STI LOC&PAS	CR STI WAG	STI NOI	HIS STI CCS	SR STI CCS	
1999											<u>Vendim 1999/569</u>		1999
2000											Hyrja në fuqi 29/07/1999		2000
2001											<u>Vendim 2001/260</u>		2001
2002	<u>Vendim 2002/732</u>		<u>Vendim 2002/733</u>				<u>Vendim 2002/735</u>				<u>Vendim 2002/731</u>		2002
2003	HS INF STI		HS ENE STI				HS RST STI				HS CCS TSI		2003
2004	Hyrja në fuqi 30/11/2002		Hyrja në fuqi 30/11/2002				Hyrja në fuqi 30/11/2002		<u>Vendim 2004/44</u> 6	<u>Vendim 2004/44</u> 6 (vetëm CR)	<u>Vendim 2004/44</u> 7	<u>Vendim 2004/44</u> 7	2004
2005											(amendament Anex A)		2005

2006									<u>Vendim 2006/66</u> NOI TSI DtA: 28/9/2006	<u>Vendim 2006/860</u> 2nd HS CCS TSI DtA: 7/11/2006	<u>Vendim2 006/679</u> CR CCS STI DtA: 28/9/2006	2006
2007										<u>Vendim 2007/153</u> (amendment Ann. A) DtA: 6/3/2007	<u>Vendim 2007/153</u> (amendment Ann. A) DtA: 7/3/2007	2007
2008	<u>Vendim 2008/217</u> HS INF TSI Hyrja në fuqi 21/12/2007 DtA: 1/7/2008		<u>Vendim 2008/284</u> HS ENE STI Hyrja në fuqi 6/3/2008 DtA: 1/10/2008		<u>Vendim 2008/163</u> SRT TSI Hyrja në fuqi 21/12/2007 DtA: 1/7/2008	<u>Vendim 2008/164</u> PRM TSI Hyrja ne fuqi 27/12/2007 DtA: 1/7/2008	<u>Vendim 2008/232</u> HS RST TSI Hyrja ne fuqi 21/2/2008 DtA: 1/9/2008		<u>Vendim 2008/386</u> CR WAG TSI DtA: 31/01/2008	<u>Vendim 2008/386</u> (amendment Ann. A) DtA: 1/6/2008	<u>Vendim 2008/386</u> (amendment Ann. A) DtA: 1/6/2008	2008
2009											<u>Vendim 2009/561</u> (amendment ch. 7) DtA: 1/9/2009	2009
2010										<u>Vendim 2010/79</u> (amendment Ann A) DtA: 1/4/2010	<u>Vendim 2010/79</u> (amendment Ann A) DtA: 1/4/2010	2010
2011		<u>Vendim 2011/275</u> CR INF TSI DtA: 1/6/2011		<u>Vendim 2011/274</u> (CR ENE TSI) DtA: 1/6/2011	<u>Vendim 2011/291</u> (amendment) DtA: 1/6/2011		<u>Vendim 2011/29</u> 1 LOC& PAS TSI DtA: 1/6/2011		<u>Vendim 2011/229</u> NOI TS) (CR)			2011
2012 *											<u>Vendim 2012/696</u> (amendment annexes A dhe G) DtA: 23/7/2012	2012*
2013								<u>Regullor3 21/2013</u> CR WAG TSI Hyrja ne fuqi 13/4/201		<u>Vendim 2012/463</u> (amendment) DtA: 24/1/2013	<u>Vendim 2012/463</u> amendment DtA: 24/1/2013	2013

2014								3 DtA: 1/1/2014	Vendim 2012/88 (CCS TSI) DtA: 1/1/2013		2014
	<u>Regulation 1299/2014</u> (INF TSI) Hyrja ne fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regulation 1301/2014</u> (ENE TSI) Hyrja ne fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regullore 1303/2014</u> (2 nd PRM TSI) Hyrja ne fuqi DtA: 1/1/2015	<u>Regullore 1303/2014</u> (STR TSI) Hyrja ne fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regullore 1302/2014</u> (RST TSI) Hyrja ne fuqi dhe DtA: 1/1/2015	<u>Regullore 1236/2013</u> Hyrja ne fuqi 4//12/2013 DtA :1/1/2014 Amendment 2014				2015	
2015											

*Vendimi 2012/464 amendamenton Vendimet 2006/861/EC, 2008/163/EC, 2008/164/EC, 2008/217/EC, 2008/231/EC, 2008/232/EC, 2008/284/EC, 2011/229/EC, 2011/274/EU, 2011/275/EU, 2011/291/EU dhe 2011/314/E

2.STI funksionale dhe amendamentimet e tyre ndër vite (Dhjetor 2014)

Viti	TSI OPE		TA	
	HS TSI OPE	CR TSI OPE	CR TSI TAF	TSI TAP
2002	Vendim 2002/734 (HS OPE TSI) Dt.A: 12/3/2003			
2003				
2004			Vendim 2004/446 (në parametra bazik)	
2005			Rregullore 62/2006 (TAF TSI) Hyrja në fuqi: 19/1/2006	
2006		Vendim 2006/920 (CR OPE TSI) Dt.A: 18/05/2007		
2007				

2008	<u>Vendim 2008/231</u> (HS OPE TSI) Dt.A: 1/9/2008			
2009		<u>Vendim 2009/107</u> (amendment) Dt.A: 1/7/2009		
2010	<u>Vendim 2010/640</u> (amendment) Dt.A: 25/10/2010 dhe 1/1/2014**	<u>Vendim 2010/640</u> (amendment) Hyrja në fuqi: 25/10/2010 dhe 1/1/2014**		
2011		<u>Vendim 2011/314</u> (CR OPE TSI) Dt.A: 1/1/2012		<u>Rregullore 454/2011</u> (TAP TSI) Hyrja në fuqi: 13/5/2011
2012		Rregullore 328/2012 (amendment) Hyrja ne fuqi: 8/5/2012	<u>Rregullore328/2012</u> (amendment) Hyrja në fuqi: 8/5/2012	Rregullore 665/2012 (amendment) Hyrja në fuqi: 22/7/2012
*				
2013			Regulation 280/2013 (amendment) EiF: 24/3/2013	Rregullore 1273/2013 (amendment) Hyrja në fuqi: 8/12/2013
2014	Vendim 2012/757 OPE: 2012 (OPE TSI) Dt.A: 1/1/2014			
2015	(version I ri i TSI)		<u>Rregullore 1305/2014</u> (TAF TSI) Hyrja ne fuqi/Dt.A: 1/1/2015	

*Vendimi 2012/464 amendamenti Vendimet 2008/231/EC an 2011/314/EU

**Dt.A: 1/1/2014 është vetëm për piken 6, Annex I dhe piken 5 of Annex II

5.3.2.7. Hartimi i Draft - Rregullores Nënsistemet Hekurudhore dhe Kërkesat Esenciale

Sipas Ligjit për Hekurudha, neni 113(5), akti nënligjor në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së 2008/57 duhet të përcaktojë mbajtjen e listës të nënsistemeve dhe ndërlidhësit të cilat e formojnë sistemin hekurudhor, si dhe kërkesat esenciale të cilat përdoren në legjislacionin e BE-së e të cilat duhet të përdoren në Kosovë.

Hartimi i draft-Rregullores,,Nënsistemet dhe ndërlidhësit të cilat e formojnë sistemin hekurudhor si dhe kërkesat esenciale të cilat përdoren në legjislacionin e BE-së,, e të cilat duhet të përdoren në Kosovë tani është i gatshëm si draft. Për shkak të mungesës së Bordit të ARH-së përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore nuk është realizuar miratimi i kësaj Rregullore.

Qëllimi i hartimit të Rregullorës është që të paraqes nënsistemet hekurudhore duke përfshirë edhe ndërlidhjet të cilat e formojnë sistemin hekurudhor, si dhe kërkesat

esenciale të cilat përdoren në legjislacionin e BE-së e të cilat duhet të përdoren edhe në Kosovë, të kërkuara sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës.

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore të cilat menaxhojnë dhe kanë në shfrytëzim nënsistemet hekurudhore të sistemit hekurudhore në Republikën e Kosovës.

Miratimi i kësaj rregullore do tu mundësoj menaxhereve të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore që nënsistemet hekurudhore të jenë në pajtueshmëri me kërkesat esenciale duke i bërë ato nënsisteme që të jenë në përputhmëri me Ligjin për Hekurudha dhe Direktivën për interoperabilitet.

Sistemi hekurudhor, nënsistemet duke përfshirë edhe ndërlidhjet, duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale siç janë: siguria, besueshmëria dhe disponueshmëria, shëndeti, mbrojtja e mjedisit dhe kompatibiliteti teknik, ashtu siç janë përcaktuar në Aneksin III të kësaj Rregullore.

5.3.2.8. Inspektimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse

Organi përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit të hekurudhave duhet të jetë përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovë dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës (neni 28, paragrafi 7)

Përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore (NVR) është Departamenti i Interoperabilitetit i cili ka për detyrë të organizoj këtë regjistër dhe për t'i futur të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore që janë në shërbim në Kosovë.

ARH në fund të vitit 2012 kishte arritur që me sukses të realizoj regjistrimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore që gjinden në territorin e Kosovës dhe duke krijuar Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR sipas standardeve evropiane.

NVR është krijuar në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, Direktivën për Interoperabilitet 2008/57/EC, Rregulloren për Regjistrimin Nacional të mjeteve lëvizëse 05/2012 dhe Vendimin 2007/756/BE.

Megenëse regjistri duhet vazhdimisht të azhurnohet me të dhëna dhe aplikime nga kompanitë, Departamenti për Interoperabilitet planifikon një inspektim rreth përputhmërisë së mjeteve aktuale hekurudhore me NVR, me idenë për të parandaluar operimin me mjete të paregjistruara e cila do të ishte në kundërshtim me rregulloren 05/2012.

Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse të INFRAKOS është realizuar me dt: 02/12/2014

Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse të NEWCO FERRONIKELI është realizuar me dt: 04/12/2014

Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse të TRAINKOS është realizuar me dt: 26-27/11/2014 dhe 05/12/2014

Në fund të vitit 2014 është realizuar inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë të regjistruara që nga 2012 deri më 01 dhjetor të 2014.

Inspektimi është realizuar me sukses duke krahasuar përputhshmërinë e mjeteve të inspektuara me Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR krijuar në vitin 2012 i cili në vazhdimësi është azhurnuar nga ARH kërkuar sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës.

Inspektimit të regjistrimit të mjeteve lëvizëse iu nënshtruan mjetet e INFRAKOS-it (data e inspektimit 02/12/2014), mjetet e TRAINKOS-it (datat e inspektimit 26-27/11/2014 dhe 05/12/2014) si dhe mjetet e NEWCO FERRONIKELI (data e inspektimit 04/12/2014).

Me rezultatet e dala nga inspektimi janë përgatitur raportet për tri kompanitë që kanë përfshirë të gjitha mjetet hekurudhore në pronësi dhe administrim të INFRAKOS, TRAINKOS dhe NEWCO FERRONIKELI COMPLEX.

Ky ishte raporti i parë mbi Inspektimin e Regjistrimit Nacional të Mjeteve Lëvizëse hekurudhore (NVR) i krijuar në vitin 2012 i cili në vazhdimësi është mbajtur dhe azhurnuar nga Departamenti i Interoperabilitetit me të dhëna dhe aplikime për regjistrime të reja dhe modifikuara nga kompanitë (INFRAKOS, TRAINKOS dhe NEWCO FERRONIKELI COMPLEX).

Në forme tabelore kemi paraqitur operatorët, mjetet e të cilëve janë përfshirë në inspektim

Tabela 7: Operatoret hekurudhor mjetet lëvizëse të të cilëve janë në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse hekurudhore NVR

OPERATORI HEKURUDHOR		STATUSI	Ueb-faqja
Infrastruktura Hekurudhore e Kosovë	INFRAKOS	Në përdorim	www.kosovorailway.com
Operimi me trena në Kosovë	TRAINKOS	Në përdorim	www.trainkos.com
Newco Ferronikeli Complex L.L.C	FERRO-NICKEL	Në përdorim	www.cunicoresources.com

5.3.2.9. Mjetet hekurudhore me pronësi të pa definuar

Departamenti për Interoperabilitet në fund të vitit 2014 ka trajtuar mjetet lëvizëse hekurudhore të cilat nuk kanë pronësi të definuar dhe nuk janë pjesë e Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR realizuar në vitin 2012. Fillimisht për ta sqaruar statusin e tyre ARH ka kërkuar nga TRAINKOS dhe INFRAKOS informacion të përgjithshëm rreth administrimit dhe përgjegjësisë ndaj këtyre mjeteve lëvizëse.

INFRAKOS më datë: 17/12/2014 i përgjigjet kërkesës së ARH-së duke deklaruar se nuk ka pronësi mbi këto mjete hekurudhore, por edhe nuk ka ndonjë përgjegjësi të veçantë bazuar në raportet mbi ndarjen e kompanisë.

TRAINKOS më datë: 12/12/2014 gjithashtu deklaron se nuk mbajnë përgjegjësi ndaj mjeteve me pronësi të pa definuar, sikurse edhe nuk administrojnë me mjetet në fjalë.

ARH përgjigjëse për regjistrimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore bazuar në deklaratat e INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it përgatitë një njoftim zyrtar drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Infrastrukturës duke i informuar mbi gjendjen reale të këtyre mjeteve.

ARH bazuar në këtë informacion vlerëson se për qëllim të zbatimit të Ligjit për Hekurudha duhet ndërmerren hapa konkret në këtë drejtim. Një numër aq i madh mjetesh hekurudhore (përafërsisht 560) pa pronësi të definuar dhe pa përgjegjësi të kompanive kundrejt tyre, vlerësuar sipas ARH-së nuk reflekton siguri. Andaj një regjistrim formal nga Departamenti përgjegjës për regjistrim brenda ARH-së do ta rriste sigurinë dhe do të parandalonte mundësinë e keqpërdorimit të këtyre mjeteve, meqë regjistrimi i rregullt nuk do të mund të realizohej në këtë rast pa një përgjegjës dhe aplikues.

Si rrjedhojë në fillim të vitin 2015 Departamenti për Interoperabilitet planifikon regjistrimin e të gjitha mjeteve me pronësi të pa definuar të cilat gjinden në territorin e Republikës së Kosovës.

5.3.3. Bashkëpunimi ndërinstytucional


ARH-ja përgjegjës për Departamentin e Interoperabilitetit ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse për transportin hekurudhor dhe palët tjera të interesit në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikrat më të mira rajonale dhe evropiane.

5.3.4. Synimet e Departamentit të Interoperabilitetit

Objektivi i përgjithshëm i Departamentit të Interoperabilitetit është që të mbështesë zbatimin e reformave në sektorin hekurudhor të Kosovës, përderisa si çështje specifike konsideron draftimin dhe implementimin e legjislacionit përkatës në fushën e interoperabilitetit hekurudhorë.

Ndjekja e këtij objektivi duhet të çojë në përcaktimin e një niveli optimal në harmonizimin teknik dhe të bëjë të mundur për të lehtësuar përmirësimin dhe zhvillimin e shërbimeve të transporti hekurudhor brenda dhe jashtë vendit.

Një përkufizim figurativ mbi synimet e Interoperabilitetit do të dukej sikur në figurën e mëposhtme:



5.4. DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT TË TREGUT

Raporti Vjetor i Rregullimit të Tregut për vitin 2014, mbulon aktivitetet e fushës së rregullimit të tregut hekurudhor në Kosovë, siç është kërkuar nga Ligji për Hekurudha 04/L-063, Rregullorja 01/2013 dhe Direktiva 2001/14/EC

5.4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

	a. Zhvillimin e rregullimit të tregut hekurudhor duke përfshirë sigurimin që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese b. Sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese. c. Mbikëqyrja e negocimeve ndërmjet aplikuesve dhe Menaxherëve të Infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Ato negociata duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e Organit Rregullativ të Tregut Hekurudhor. d. Intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, e. Sigurimi se a përmban Ekspozeu i Rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët, f. Sigurimi se a përmban Ekspozeu i Rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët, g. Analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun hekurudhor të brendshëm dhe të jashtëm konkurrues me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve
--	--

5.4.2. Aktivitetet e Departamentit të Tregut

Ky raport përshkruan aktivitetet e vitit paraprak me informacionin si në vijim:

5.4.2.1. Shqyrtimi i ankeses nga TRAINKOS

Departamenti i Rregullimit të Tregut ka zhvilluar aktivitetin e vet në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, Rregulloret të Tregut si dhe Direktivës 2001/14/EU

Pas pranimit të draft Ekspozeut të Rrjetit nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore INFRAKOS në muajin qershor kemi pranuar një ankesë nga ana e Ndërmarrjes Hekurudhore TRAINKOS. Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor në kuadër të ARH-së ka filluar me shqyrtimin e kësaj anekese. TRAINKOS në letrën dërguar ARH-së kishte disa vërejtje për draft Ekspozeun e Rrjetit 2015:

Departamenti i Rregullimit të Tregut në qershor të 2014 ka pranuar ankesë nga TRAINKOS në lidhje me Ekspozeun e Rrjetit 2015.

Departamenti për Rregullimin e Tregut ka shqyrtuar pikat e ankesës si më poshtë:

1. Niveli shumë i lartë i tarifave,
2. Koeficienti i Trenave TCO
3. Koeficienti i Kualitetit të mjeteve tërheqëse QIT
4. Koeficienti i Zhurmës QIN
5. Shfrytëzimi dhe qasja në objektet për pastrim, Larjen e Trenave dhe Vagonëve
6. Shfrytëzimi i Objekteve për pranim dhe përcillje të udhëtareve
7. Shfrytëzimi dhe vendosja e vagonëve
8. Shfrytëzimi dhe qasja e vagonëve në binarët industrial
9. Shfrytëzimi i binareve për parkimin e vagonëve
10. Qasja deri te objektet për mirëmbajtje dhe objekte tjera teknike
11. Manovrimi formimi i trenave të udhëtareve dhe përgatitja e dokumentacionit për trenat e udhëtareve në nisje.
12. Shitja e biletave
13. Evidentimi dhe udhëheqja e evidencave të vagonëve.

5.4.2.2. Procesi i konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit 2015

Me datë 25/06/2014 Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor ka mbajtur një takim zyrtar me INFRAKOS, TRAINKOS, MI, MZHE, ku janë zhvilluar konsultime intensive lidhur me Draft Ekspozeun e Rrjetit 2015 .

Si temë specifike ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i Ekspozeut të Rrjetit me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës INFRAKOS.

INFRAKOS ka argumentuar të dhënat e futura në këtë Ekspoze ku sipas tyre këto janë çmimet reale për mirëmbajtje të Infrastrukturës Hekurudhore. Ndërmarrja Hekurudhore TRAINKOS në këtë takim ka paraqitur vërejtjet e tyre lidhur me Ekspozeun e Rrjetit 2015, posaçërisht ka pasur ankesa për pikat e përmendura më lartë. Ne si Departament për Rregullimin e Tregut pas këtij takimi kemi filluar të punojmë në nxjerrjen e fakteve lidhur me ankesën e paraqitur nga ana e TRAINKOS-it, për çmimet e operimit në Infrastrukturën hekurudhore si dhe krahasimin me atë të vendeve fqinje siç janë: Maqedonia dhe Mali i Zi. Pas një procesi të gjithanshëm të konsultimeve me palët e interesit, kemi paraqitur opinionin tonë për pika të caktuar nga draft Ekspozeu i Rrjetit 2015.

Departamenti i Rregullimit të Tregut më 25/06/2014 ka mbajtur takim konsultativ me palët e interesit për Ekspozeun e Rrjetit 2015.

5.4.2.3. Shqyrtimet e ARH-së në komentet e TRAINKOS-it lidhur me draft Ekspozeun e Rrjetit 2015

Nga Kryeshefi Ekzekutiv i TRAINKOS me datë: 22/07/2014, Lënda: Komentet për Draft-Ekspozeun e Rrjetit Hekurudhor 2015 dhe në letrën tjetër zyrtare nga INFRAKOS në përgjigjen në komentet lidhur me draft Ekspoze të Rrjetit 2015, siç kuptohet edhe nga subjekti i saj, kërkohet nga ARH-ja, respektivisht nga Rregullatori i Tregut që të japim përgjigjeje rreth komenteve lidhur me Draft- Ekspoze të Rrjetit 2015.

Departamenti për Rregullimin e Tregut ka për detyrë sigurimin që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës nuk janë diskriminuese, sipas nenit 25.3.1 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës dhe sigurimi që qasja në binar, qasja në stacione, qasja në depot e operatorit që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë, transparente dhe jo diskriminuese, e gjithë kjo sipas nenit 25.3.2.

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, sipas nenit 61.3 i cili ka të bëjë me përcaktimin e tarifave për shërbimet hekurudhore dhe në bazë të Udhëzimit

Administrativ Nr. 02/2013 për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore, Udhëzimit Nr .03/2013 për Vendosjen,

Përcaktimin dhe Arkëtimin e Pagesave të Qasjes në Infrastrukturë Hekurudhore si dhe Rregulloren për Ekspoze të Rrjetit Nr. 01/2013, Departamenti i Rregullimit Tregut për draft Ekspozeun e Rrjetit 2015 sugjeron që pikërisht kapitulli i 6 i cili ka të bëjë me sistemin e tarifave nivelin e përgjithshëm të pagesave për shfrytëzimin e shërbimeve të cilat i ofron Menaxheri i Infrastrukturës do të duhej të jetë në harmoni me legjislacionin e lartcekur.

Bazuar në kompetencën formale të ARH-së, për draft Ekspozeun e Rrjetit 2015 jep opinion se: *Ky draft Ekspoze do të duhej të parasheh tarifa konkurrencte me rajonin.* Më rastin e dhënies së përgjigjes së komenteve për Draft- Ekspoze të Rrjetit 2015, ARH-ja ka analizuar situatën e tregut bazuar në informacionin e pranuar dhe ka ardhur deri tek konstatimi i mësipërm. Mirëpo pasi që nga INFRAKOS kërkohet sipas Nenit 7.1 dhe Nenit 45.5 Ligji për Hekurudhat “ që të veprojnë në baza komerciale sipas kushteve të rrjetit”, ARH-ja e sugjeron se Ministria do të duhej të sigurojë se në rast të zvogëlimit të të hyrave që vijnë nga ndryshimet të kompensohen nga të hyrat tjera sipas nenit 45.15 të Ligjit për Hekurudhat që kanë të bëjnë me asetet dhe aktivitetet e tjera të INFRAKOS-it, e që është si e hyrë nga kontributet shtetërore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët dhe ndonjë kontributi tjetër me origjinë publike apo private.

Mbulimi i diferencës mes Ekspoze të Rrjetit 2015 dhe kostos direkte për mirëmbajtje të rrjetit përveç këtyre kërkesat duhet të përmbushet edhe në bazë të nenit 63.3 sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, pastaj edhe për TRAINKOS-in për të mbijetuar del si konkluzion se do të duhej që si operatorë vendorë i transportit hekurudhor të marrë kompensim financiar nga shteti për shërbimet publike në bazë të një kontrata PSO ku të ardhurat apo kompensime duhet të jenë me origjinë publike ose private".

ARH-ja duke u bazuar në statusin e kompanive hekurudhore sugjeron që Qeveria përkatësisht Ministria përgjegjëse për çështjet hekurudhore në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për ndërmarrjet publike, të analizojnë gjendjen financiare të kompanive dhe të ju sigurohet një ndihmë shtetërore. Pas analizimit të pikave veç e veç të cilat kanë qenë të ngritura nga TRAINKOSI në lidhje me Ekspoze të Rrjetit 2015, si pjesë e këtyre komenteve janë qëndrimet e palëve në takimin konsultativ dëgjimor me palët e interesit e cila është mbajtur me datë: 25/06/2014.

Aranzhimet për qasje dhe pagesës për shërbimet shtesë, neni 52.2 të Ligjit për Hekurudha, Menaxherit të Infrastrukturës i garanton lirinë që të ofroj “çfarëdo lloji të shërbimit shtesë. Ai duhet t’i ofroj ato me kërkesë të një Ndërmarrje Hekurudhore

5.4.2.4. Shqyrtimet e ARH-së në komentet për Ministrin e Infrastrukturës lidhur me draft Ekspozeun e Rrjetit 2015

Nga Ministria e Infrastrukturës me datë: 30/07/2015, Lënda: Komentet për Draft-Ekspoze të Rrjetit Hekurudhor 2015. ARH-ja, respektivisht Departamenti për Rregullimin e Tregut bazuar në informacionin e pranuar ka ardhur deri tek konstatimi se ky Draft Ekspoze i Rrjetit 2015, në parim është në përputhje me Ligjin 04/L-063, për Hekurudhat e Kosovës, me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2013, për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore, Udhëzimin Nr. 03/2013 për Vendosjen, Përcaktimin dhe Arkëtimin e Pagesave të Qasjes në Infrastrukturë dhe me Rregulloren për Ekspoze të Rrjetit Nr. 01/2013.

Andaj, një nga detyrat e Departamentit të Rregullimit të Tregut është sigurimi që pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesave nuk janë diskriminuese. Sipas nenin 25.3.1. të Ligjit për Hekurudhat, qasja në binar, stacione dhe depot e operatorit që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë, transparente dhe jo diskriminuese, e gjithë kjo sipas nenit 25.3.2.

ARH-ja, respektivisht Organi për Rregullimin e Tregut ka analizuar situatën e tregut bazuar në informacionin e pranuar dhe ka konstatuar se kapitulli 6 nuk parasheh tarifa konkurrencte me rajonin. Andaj, Rregullimi i Tregut del me rekomandim për kapitullin e 6, *“Se tarifat duhet të jenë konkurrencte me rajonin,,*.

Departamenti i Rregullimit të Tregut sugjeron Ministrin e Infrastrukturës dhe Ministrin e Zhvillimit Ekonomik që të veprojnë sipas nenit 61 të Ligjit për Hekurudhat “Pagesat e infrastrukturës,, dhe me paragrafin 3 të këtij neni ku struktura e sistemit të vendosjes së çmimit për shfrytëzuesit e rrjetit dhe niveli i përgjithshëm i pagesave të shfrytëzimit propozohet nga Menaxheri i Infrastrukturës në pronësi të shtetit dhe e miraton Ministria në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për ndërmarrjet publike. Menaxheri i Infrastrukturës në shfrytëzim të përbashkët në pronësi shtetërore cakton pagesat dhe kostot në përputhje me situatën e tregut, duke respektuar parimin e mos diskriminimit.

Bazuar në Ligjin për Hekurudha, neni 61.3 i cili ka të bëjë me përcaktimin e tarifave për shërbimet hekurudhore, ARH ka analizuar draft Ekspozeun e Rrjetit, respektivisht kapitullin e 6 i cili ka të bëjë me sistemin e tarifimit, nivelin e përgjithshëm të pagesave për shfrytëzimin e shërbimeve të cilat i ofron Menaxheri i Infrastrukturës.

Si rezultat ARH ka dalë me rekomandim si në vijim:

Pasi që INFRAKOS-it i kërkohet nga neni 7.1 dhe neni 45.5 Ligji për Hekurudhat “ që të veproj në baza komerciale sipas kushteve të rrjetit”, është e nevojshme që të sigurohet se zvogëlimet e të hyrave që vijnë nga ndryshimet të kompensohen nga të hyra të tjera sipas neni 45.15 Ligji për Hekurudhat. Përveç këtyre kërkesat mund të përmbushen edhe në bazë të neni 63.3 të Ligji për Hekurudha

5.4.2.5.Përgatitja e Raportit të Monitorimit të Tregut 2013

Një nga detyrat e Departamentit të Tregut është përgatitja e raportit vjetor të monitorimit që mbulon zhvillimet në tregun hekurudhor të Kosovës, kerkuar sipas Ligjit për Hekurudha Ky është raporti i parë që mbulon tregun hekurudhor të vitit 2013.

Në vazhdim e gjeni Raportin e plotë të Monitorimit të Tregut Hekurudhore të Kosovës

.

5.4.2.3.1. RAPORTI I MONITORIMIT TREGUT PËR VITIN 2013

1. Hyrje

ARH është një institucion rregullativ në kuadër të të cilit vepron Departamenti i Rregullimit të Tregut si organ i pavarur, qëllimi i përgjithshëm i të cilit është të lehtësojë krijimin e një tregu të vetëm konkurrues dhe i qëndrueshëm për rregullimin e tregut të brendshëm hekurudhor në Kosovë.

Departamenti është themeluar në prill të vitit 2012 dhe vepron si një platformë për rregullimin e tregut hekurudhor kombëtar dhe për të ndarë praktikën më të mira në mënyrë që në të ardhmen sfidat rregullatore mund të trajtohen në një mënyrë të qëndrueshme në Kosovë.

Ky departament rregullator ka për detyrë për të monitoruar zhvillimin e konkurrencës në tregun e shërbimeve hekurudhore, dhe në mënyrë të veçantë në tregun e transportit hekurudhor në përputhje me Ligjin 04/L-063, me Rregulloren për Ekspoze të Rrjetit Nr. 01/2013, me Direktivën 2001/14 EU dhe me Direktivë 2012/34/EU.

Një nga detyrat e departamentit është të përgatis një raport vjetor të monitorimit që mbulon zhvillimet në tregun hekurudhor të Kosovës. Ky është raporti i parë që mbulon tregun hekurudhor të vitit 2013. Këtë vit ARH-ja gjithashtu paraqet rezultatet e monitorimit të tregut të shërbimeve hekurudhore të ngjashme të caktuara për herë të parë.

2. Qëllimi

Monitorimi i tregut hekurudhor të Kosovës është një instrument i rëndësishëm për mbledhjen e informacionit të tregut hekurudhorë të brendshëm si dhe vendosjen e udhëzimeve për aktivitetet e Departamentit të Rregullimit të Tregut dhe stimulimin e pjesëmarrësve të tregut për të përmirësuar aktivitetet e tyre. Qëllimi i raportit është se ARH-ja do të paraqesë rezultatet e procesit të mbledhjes së të dhënave përkatëse të udhëhequra nga Departamenti i rregullimit të tregut. ARH-ja, do të përdor raportin për zhvillimin e njohurive të tyre të tregut hekurudhor, si dhe zhvillimin e tregut dhe evolucionit.

3. Metodologjia

Metodologjia e ARH-së tregon se në vitin 2013 ishte një treg pa një hyrje të 're' të operatorëve të pasagjerëve dhe mallrave. Tregu hekurudhor vepron me transportin e udhëtareve dhe të mallrave vetëm me një operator i cili është publik. Tregu hekurudhor si ai i udhëtareve dhe i mallrave ka një lidhje ndërkombëtare në jug me Maqedoninë dhe në veri me Serbinë, ndërsa vlen të theksohet se viti i liberalizimit të transportit hekurudhor për të dy kategoritë ka qenë viti 2011 kur edhe janë ndarë Hekurudhat e Kosovës.

Nuk ka pasur ndonjë hyrje të re në tregun hekurudhor gjatë vitit 2013 dhe rrjeti hekurudhor është përdorur vetëm 50% si rezultat i mos funksionimit të disa linjave siç është linja kryesore

Fushe-Kosovë-Leshak. Në hekurudhat e Kosovës qarkullojnë rreth 8 lokomotiva dizel ku bartin 27 vagonë, 9 të udhëtareve dhe 18 për mallra.

Raporti fokusohet në pesë (5) fusha përmes të cilave përpilohet ky raport

- Struktura e përgjithshme e tregut,
- Karakteristikat e infrastrukturës dhe përdorimi i saj,
- Tregu hekurudhor i pasagjerëve,
- Tregu hekurudhor i mallrave,
- Tregu për shërbimet që kanë të bëjnë me hekurudhat

3.1. Struktura e përgjithshme e tregut

Bazuar në të dhënat të cilat i kemi në dispozicion si Departament i Tregut, ne do ti japim disa nga statistikat e të dhënave për Hekurudhat e Kosovës të cilat do jenë të nevojshme për raportin e monitorimit. Në territorin e Kosovës kemi gjithsej 333 km binar hekurudhor për transport dhe 110 km linja private.

Tabela 1: Data e liberalizimit të tregut:

Kategoria e transportit	Data e liberalizimit
<u>Tregu hekurudhor i mallrave:</u>	1 Shtator 2011
<u>Tregu hekurudhor i pasagjerëve:</u>	1 Shtator 2011
Struktura pronësore	%
<u>Transporti i Mallrave</u>	100% publike
<u>Transporti i Pasagjerëve</u>	100% publike

3.2. Infrastruktura

Hekurudhat e Kosovës disponojnë me 333 km linjë hekurudhore një binarëshe dhe me 110 km tjera me binar privat apo industrial dhe nuk ka linja të elektrifikuara. Rrjeti i hekurudhave të Kosovës është i lidhur me dy shtete: Republikën e Serbisë dhe Republikën e Maqedonisë. Infrastruktura është pronë e shtetit dhe menaxhohet nga Menaxheri i Infrastrukturës “INFRAKOS”. Në vitin 2013 Infrastrukturën hekurudhore e ka përdorur vetëm një operator publik “TRAINKOS”. Pagesat e qasjes në infrastrukturë për operatorin kanë qenë në mesataren e 4.90 € për tren/km, mesatarja e përdorimit të rrjetit ka qenë 10 trena/ditë duke pasur parasysh që 50% e rrjetit hekurudhor nuk është përdorur për shkak të gjendjes teknike dhe situatës politike.

Skema e stacioneve



3.3. Tregu për transportin e udhëtareve

Një analizë e përgjithshme e këtij tregu dhe transporti tregon se pjesëmarrja në tregun e përgjithshëm të udhëtareve brenda vendit nuk arrin shifrën 1% kur krahasojmë me mjetet tjera të transportit.


Është vetëm një përqindje e udhëtareve që shfrytëzojnë llojin e transportit hekurudhor. Nga analizat e bëra kemi identifikuar tri kategori transportuese konkurrense si: transporti me autobusë, me minibus dhe transporti me taksì. Përparësia e këtyre konkurrenteve është se me autobus dhe minibus janë orare më të shpeshta, më të ri teknikisht, kostoja më e ultë e investimit, mundësia e ndalesës në më shumë vende-stacione. Ndërsa përparësitë e transportit me taksì janë: shërbimet të shpejta, shërbime nga dera në derë dhe janë më të lira. Sa i përket pronësisë se trenave ata janë në pronësi të kompanisë dhe nuk janë me qira apo aksionar me ndonjë kompani përkatësisht operatorë tjetër të udhëtareve. Përqindjet e kilometrave të udhëtareve për vitin raportues dhe krahasimin me vitet paraprake, rritjen apo zbritjen me përqindje, të hyrat e ndërmarrjeve nga transporti i udhëtareve për tren/kilometër për vitin 2013, burimin e të ardhurave të ndërmarrjes hekurudhore, janë të hyrat nga transporti i udhëtareve. Të hyrat nga transporti i udhëtareve, transporti i organizuar i udhëtareve, norma e shfrytëzimit të trenave është e mbuluar me 35% nga linja Prishtinë – Pejë.

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve


Përshkrimi - Të hyrat	01 Janar – 31 Dhjetor
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	987,593.79
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	500,000.00
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	243,131.16
Transporti i organizuar i udhëtarëve	7,321.51
Total të hyrat	1,738,046.46
Shpenzimet direkte në transportin e udhëtarëve	1,345,731.46
Shpenzimet indirekte në transportin e udhëtarëve	966,015.28
Total shpenzimet	2,311,746.74
Fitimi / humbja operative në valute	-573,700.28
Fitimi / humbja %	-33%

Tabela 2: Të hyrat e transportit të udhëtarëve për vitin 2013 shprehur në %

Të hyrat nga transporti i udhëtarëve-OSHP	56.82%
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve-MZHE	28.75%
Shitja nga biletat	14.00%
Transporti i organizuar	0.43%

**Tabela 3:** Kapaciteti hekurudhor i transportit të udhëtareve nga viti 2011-2013

Vitet	2011	2012	2013
Numri i udhëtarëve	358,000.00	367,000.00	369,000.00

Grafiku 1. Numri i udhëtarëve sipas viteve

3.4. Tregu për transportin e mallrave

Për ta kuptuar më mire analizën e tregut të mallrave në vendin tone të monitoruar, më poshtë do ta kuptojmë në bazë të dhënave kryesisht se a ka pasur ngritje të përgjithshme të tren/kilometrave të mallrave në mes të vitit 2012 dhe 2013. Megjithatë kjo ngritje bazohet edhe në realizimin e të hyrave ku posedojmë me të dhëna faktike se janë realizuar për sektorin e mallrave nga kompania që operon.

Kjo vlen për vitin 2013, që do të thotë se kjo është një analizë e përgjithshme e tregut të mallrave për gjendjen dhe zhvillimin e tregut.

Ndërsa sa i përket konkurrencës së këtij transporti me transportet tjera, nga analizat e bëra mbi konkurrencën në transportin e mallrave kemi identifikuar tri kategori të kompanive të cilat janë konkurrencte, kompanitë të cilat merren me biznesin e derivateve dhe të cilat kryejnë transportin e këtyre mallrave me mjetet e tyre transportuese, pastaj kompanitë të cilat merren me transportin e kontinjerëve dhe kompanitë të cilat posedojnë kamion të mëdhenj me kapacitete të mëdha ngarkuese dhe merren me transportin e sasive të mëdha. Ndërsa sa i përket ton kilometrat e realizuara, për vitin 2013, janë realizuar neto-ton-km për këtë vit, me peshën maksimal 1300t/tren dhe 800 t/tren neto për trenin e mallrave, sa i përket pronësisë së trenave ata janë në pronësi të kompanisë dhe nuk janë me qira apo aksionar me ndonjë kompani përkatësisht operator tjetër të mallrave

Të hyrat dhe shpenzimet nga biznesi i transportit të mallrave

Përshkrimi	01 Janar – 31 Dhjetor
Shitjet nga transporti i mallrave	3,034,457.72
Shitjet nga shërbimet tjera të transportit të mallrave	164,118.54
Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave	14,589.50
Total shitjet	3,213,165.76
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	1,650,022.10
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	520,162.07
Total shpenzimet	2,170,184.17
Fitimi/humbja operative	+1,042,981.59
Fitimi/humbja %	+48%

Tabela 4: Të hyrat e transportit të mallrave për vitin 2013 në %

Shitjet nga transporti i mallrave	94.44%
Shërbimet tjera të transportit të mallrave	5.11%
Dëmtimi i vagonëve	0.45%

Të hyrat nga transporti i mallrave

■ Shitja nga transporti i mallrave ■ Shërbimet tjera ■ Dëmtimi i vagonave






Tabela 5: Kapaciteti hekurudhor i transportit të mallrave, nga viti 2011-2013

Vitet	2011	2012	2013
Sasia e mallrave të transportuara në mijë ton	1,001	826	904
Sasia e mallrave të transportuara në milion ton - km	56	49	43

Grafiku 2: Sasia e mallrave të bartura në ton**Grafiku 3:** Sasia e mallrave të bartura ton-km

4. Shërbimet hekurudhore të ngjashme

Duke u bazuar në ER-2014 përgjatë Rrjetit Hekurudhor të Kosovës gjenden: 35-Vendqëndrime, nga këto 27 janë të hapura për udhëtar dhe 1 për dërgesa të mallrave 23-Stacione, nga këto 23 të hapura për udhëtar dhe 18 shfrytëzohen për dërgesa të mallrave 06-Stacione të mbyllura

4.1. Stacionet

INFRAKOS u ofron ndërmarrjeve hekurudhore shfrytëzimin e të gjitha stacioneve (vendeve zyrtare) për pranim dhe përcjellje të udhëtarëve, objekteve të stacioneve dhe objekteve tjera me kërkesë të tyre në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese. Të gjitha stacionet në linjën e 10 hekurudhore (Leshak – Hani i Elezit, me përjashtim të njëjës qendrore në Fushë Kosovë dhe Miradi) janë të siguruara me pajisjet sinjalo- siguruese elektro-elektrike. Për fat të keq të gjitha stacionet nëpër linjat tjera hekurudhore nuk janë të siguruara me pajisjet SS, me përjashtim të skambjeve të cilat janë të siguruara me brava mekanike. Gjatë vitit 2013, përkundër kushteve të vështira financiare, dëmtimeve të shpeshta të pajisjeve SS dhe mungesës së nevojshme të pjesëve rezervë, falë angazhimeve të mëdha të të gjithë punonjësve për intervenimet e menjëhershme në eliminimin e pengesave është arritur që këto pajisje të funksionojnë pa probleme të mëdha dhe të garantojnë sigurinë e lëvizjes së trenave.

